



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

RAPORTI TREMUJOR **I QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**



Prishtinë, shtator 2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

RAPORTI TREMUJOR I QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

(3 qershor – 10 shtator 2020)

Prishtinë, shtator 2020

Faqja është lënë qëllimisht zbrazët

Hyrje

Ky raport paraqet punën e Qeverisë së Kosovës, nga dita e votimit të saj në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më 3 qershor 2020, deri më 10 shtator 2020.

Raportit i paraprin fjala e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, **z. Avdullah Hoti**. Më tutje, paraqiten angazhimet kryesore sipas sektorëve të bazuar në prioritetet dhe Programin e Qeverisë.¹

1. Raporti është konsoliduar dhe si i tillë nuk përfshin të gjitha të arriturat gjatë kësaj periudhe kohore.

| | |
|---|----|
| Fjala e Kryeministrit | 6 |
| 1. Menaxhimi i pandemisë nga COVID-19 dhe rimëkëmbja ekonomike pas pandemisë | 12 |
| 1.1. Masat e reja për luftimin e pandemisë COVID-19 | 12 |
| 1.2. Zbatimi i programit për rimëkëmbje ekonomike | 18 |
| 2. Qeverisja, reforma institucionale dhe kohezioni shoqëror | 20 |
| 2.1. Qasja ndaj reformës institucionale të administratës publike | 24 |
| 2.2. Qeverisja lokale | 25 |
| 2.3. Partneriteti me shoqërinë civile dhe mediat | 25 |
| 2.4. Promovimi i barazisë shoqërore | 26 |
| 2.5. Kthimi dhe riintegrimi i komuniteteve | 27 |
| 2.6. Fuqizimi i pozitës së grave dhe vajzave në shoqëri | 29 |
| 3. Zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm | 31 |
| 3.1. Menaxhimi i financave publike | 31 |
| 3.2. Zhvillimi rajonal | 33 |
| 3.3. Industria dhe mbështetja për sektorin privat | 34 |
| 3.4. Politikat tregtare | 36 |
| 3.5. Turizmi | 36 |
| 3.6. Energjia | 37 |
| 3.7. Sektori i Teknologjisë Informative dhe Komunikuese (TIK) | 39 |
| 3.8. Menaxhimi i ndërmarrjeve publike | 40 |
| 3.9. Koordinimi i asistencës zhvillimore | 41 |
| 3.10. Përmirësimi i gjendjes së mjedisit | 41 |
| 3.11. Fuqizimi i planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe banimit | 42 |
| 4. Drejtësi e pavarur dhe efikase | 44 |
| 4.1. Avancimi dhe forcimi i institucioneve të drejtësisë | 45 |
| 4.2. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar | 47 |
| 5. Politika e jashtme, integrimi në BE dhe dialogu me Serbinë | 48 |
| 5.1. Politika e jashtme | 48 |

| | | |
|------------|---|-----------|
| 5.2. | Integrimi në BE | 49 |
| 5.3. | Dialogu me Serbinë | 50 |
| 6. | Arsimi dhe shkenca | 53 |
| 6.1. | Arsimi parauniversitar | 53 |
| 6.2. | Gjithëpërfshirja dhe barazia në arsim | 56 |
| 6.3. | Arsimi profesional | 57 |
| 6.4. | Arsimi i lartë | 57 |
| 7. | Shëndetësia | 60 |
| 8. | Bujqësia dhe zhvillimi rural | 64 |
| 8.1. | Sistemi i integruar informativ bujqësor (SIIB) | 66 |
| 8.2. | Vreshtaria dhe verëtaria | 66 |
| 8.3. | Promovimi i prodhimtarisë bujqësore | 67 |
| 8.4. | Siguria Ushqimore Veterinaria dhe Fitosanitaria | 67 |
| 9. | Infrastruktura rrugore dhe hekurudhore | 71 |
| 10. | Mbrojtja dhe siguria publike | 75 |
| 10.1. | Ministria e Mbrojtjes/Forca e Sigurisë së Kosovës | 75 |
| 10.2. | Sektori i sigurisë publike | 77 |
| 11. | Mbrojtja sociale dhe integrimi në punësim | 82 |
| 12. | Kultura, rinia dhe sporti | 84 |
| 12.1. | Kultura | 84 |
| 12.2. | Trashëgimia | 85 |
| 12.3. | Rinia | 86 |
| 12.4. | Sporti | 87 |

Fjala e Kryeministrit

Të nderuar qytetar të Republikës së Kosovës,

Gjatë këtyre njëqind ditëve, kemi ndarë fatin e gjithë botës në përballje me pandeminë e shkaktuar nga Covid-19. Prandaj, dëshiroj të filloj me një falënderim të veçantë për të gjithë stafin shëndetësorë për angazhimin e jashtëzakonshëm në përballje me këtë pandemi vdekjeprurëse. Dëshiroj të falënderoj zyrtarët policorë, zyrtarët e nivelit qendror dhe komunal, bizneset private, ndërmarrjet publike dhe shumë të tjerë që kanë bërë të pamundurën që sistemi ynë shoqëror të mbetet në këmbë. Me këtë rast, u shpreh ngushëllime familjeve të viktimave të kësaj pandemie dhe lutem që të prekurit të shërohen sa më parë.

Përtej shëndetit, ky virus ka prekur edhe ekonominë tonë. I gjithë sistemi jonë shëndetësor, por edhe ekonomik e shoqëror, është vënë në provë. Është vënë në provë edhe besimi që kemi në vlerat tona si solidariteti, sakrifica e dashuria për njëri-tjetrin.

Qeverisja jonë është bazuar në nevojën që kemi për: mbrojtjen e lirive qytetare, rendin demokratik dhe liritë e të shprehurit pa qenë të linçuar; avancimin e demokracisë tonë drejt demokracive perëndimore; nevojën që kanë qytetarët e Kosovës për normalitet e siguri në jetën e tyre; si dhe ruajtjen e miqësive tona të ndërtuara me dekada, pa të cilat vështirë të mendohet qëndrueshmëria, zhvillimi dhe avancimi i shtetit tonë drejt demokracive perëndimore dhe integritit euro-atlantik. Kjo Qeveri, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur, e as nuk do të ketë, asnjë fuqi tjetër, përveç asaj që buron nga Kushtetuta, prej të cilës frymëzohet dhe merr legalitet në veprimet e saj.

Nisur nga situata me të cilën jemi përballur, prioritetet tona kanë qenë: lufta kundër pandemisë Covid-19, rimëkëmbjen ekonomike pas kësaj pandemie, forcimin e shtetit, integritetit dhe sovranitetit të tij, avancimin e demokracisë, luftimin e dukurive negative, veçmas krimin dhe korrupsionit, marrjen e përgjegjësisë kushtetuese për të qarë përpara procesin e dialogut në bashkëpunim me BE dhe SHBA mbi parime të qarta, dhe avancimin e procesit të integritit evropian.

Luftimi i Pandemisë COVID- 19

Në betejën kundër pandemisë Covid-19, kemi bërë përpjekjet e duhura dhe kemi arritur të mbajmë të mobilizuar sistemin shëndetësorë dhe infrastrukturën mbështetëse për të parandaluar përhapjen e virusit dhe trajtuar rastet e prekura. Në këtë funksion të kësaj, në fillim të mandatit është themeluar Bordi Këshillëdhënës për Covid19, i cili më pas ka hartuar “Manualin për mbrojtjen nga përhapja e virusit”, në bazë të të cilit në vazhdimësi janë ndërmarrë masa për mbrojtje. Nëpërmjet riorganizimit dhe menaxhimit më të mirë të hapësirave aktuale të institucioneve shëndetësore, është rritur kapaciteti spitalor për trajtimin e të prekurve nga virusi, si dhe janë forcuar kapacitetet regjionale të mbikëqyrjes epidemiologjike përmes qendrave të monitorimit periferik, me shpërndarje në të gjithë territorin. Janë përmbyllur procedurat për nënshkrimin e nëntë marrëveshjeve në vlerë financimi prej rreth 250 milionë eurosh, prej të cilave 213 milionë euro janë financim për luftën ndaj pandemisë.

Nga programi farmaceutik për masat mbrojtëse për Covid-19, Ministria e Shëndetësisë ka shpenzuar mbi 5 milionë euro. Për ngritjen e kapaciteteve të luftimit të pandemisë kanë filluar

punën 200 specialistë shëndetësorë të rekrutuar nga MSh-ja, prej të cilëve 100 mjekë, 62 infermierë, 20 inspektorë sanitarë, 4 mikrobiologë, 8 laborantë dhe 6 anëtarë të stafit teknik e mbështetës. Po ashtu, janë licencuar institucione/laboratorë për testime molekulare dhe serologjike për COVID-19. E gjithë kjo është bërë në koordinim të ngushtë me vendet mike, nga të cilat kemi pranuar ndihmë të vazhdueshme si në pajisje mjekësore, ashtu edhe profesionale për luftim dhe parandalim të pandemisë.

Plani për Rimëkëmbje Ekonomike

Pandemia Covid-19 ka goditur rëndë edhe ekonominë e vendit, duke ndikuar kështu negativisht në prodhim, punësim, të ardhura dhe eksporte. Me qëllim të tejkalimit të këtyre pasojave, Qeveria ka aprovuar Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike Covid-19, si dhe ka zhvilluar masat për rimëkëmbje ekonomike që kapin vlerën prej 365 milionë euro.

Masat për rimëkëmbje ekonomike janë analizuar dhe ndërmarrë në bashkëpunim me: asociacionet e biznesit, komunitat, Bankën Qendrore të Kosovës për të siguruar qëndrueshmërinë e sektorit financiar, për të rritur potencialin kreditor dhe për të diversifikuar riskun nga kredidhënia, institucionet ndërkombëtare (si FMN, Banka Botërore, Komisioni Evropian, UNDP, USAID, GIZ etj.) me qëllim të krijimit të sinergjisë nga ky bashkëpunim dhe në absorbimin sa më efikas të asistencës teknike dhe financiare, Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, përfaqësuesit e vendeve të QUINT-it, si dhe përfaqësuesit e tjerë diplomatik në Kosovë, si dhe shoqërinë civile dhe mediet si partnerë shumë të rëndësishëm në ofrimin e ekspertizës së nevojshme dhe informimin e qytetarëve.

Masat për rimëkëmbje ekonomike përfshijnë: lehtësimin e qasjes në kredi për ndërmarrje private për të financuar projekte investive dhe vazhdimin e operimit, lehtësim të barrës tatimore për biznese për të përmirësuar likuiditetin e tyre afatshkurtër, masa për mbështetje të punësimit, masa për mbështetje në zhvillim të bujqësisë, stimulim të kërkesës agregate, mbështetje për ndërmarrje publike për operim të rregullt dhe investime kapitale të rëndësishme strategjike, rishikimi të buxhetit për 2020 dhe relaksim të kufizimeve fiskale dhe të kufirit të borxhit publik, masa mbështetëse për ekonomi nga sektori financiar si dhe mobilizim të fondeve për mbështetje ekonomike.

Qeverisja dhe reforma institucionale

Përmes Ligjit për Qeverinë, i cili tashme ka kaluar edhe konsultimin publik, si dhe ligjeve tjera përcjellëse të miratuara deri me tani, kemi arritur të ndërtojmë kornizën e duhur për një administratë optimale, të liruar nga struktura të dyfishuara dhe të panevojshme. Ashtu siç kemi premtuar, përfshirja e partnerëve ndërkombëtarë në përzgjedhjen e menaxhmenteve të agjencive dhe ndërmarrjeve publike është vetëm hapi i parë drejtë përmbushjes së parimit meritokratik. Gjatë gjithë kësaj periudhe, qeveria ka bashkëpunuar ngushtë me nivelin lokal në koordinimin e reformave institucionale dhe legjislative, në veçanti në përgatitjen e buxhetit, planeve investive, subvencionet për bujqësi dhe masat për rimëkëmbje ekonomike.

Zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm

Duke qenë të vetëdijshëm se pandemia ndryshoi të gjitha parashikimet buxhetore, me angazhimin e të gjithë institucioneve relevante, e veçmas të Ministrisë së Financave, në një afat rekord e kemi rishikuar buxhetin e vitit 2020, ku ju janë reflektuar kërkesat e domosdoshme për luftimin e pandemisë, ekzekutimi i pagesave nga pakoja emergjente, ku kanë përfituar mbi 259 mijë përfitues.

Përveç kësaj, ashtu siç kemi premtuar kemi filluar përgatitjen e domosdoshme të një orientimi të qartë strategjik afatgjatë të zhvillimit, ku do të vendosen prioritetet dhe kornizat e politikave ekonomike, fiskale e buxhetore dhe të borxhit publik. Në të gjitha këto politikat dhe masa për nxitje të zhvillimit ekonomik garantohet transparencë e plotë në zbatim, në mënyrë që të mos deformohet tregu i lirë.

Duke marr parasysh potencialin që ka bujqësia për rritjen e prodhimit vendor dhe punësimit të fuqisë punëtore në gjithë zinxhirin prodhues, përpunues dhe shërbyes, kemi filluar të sigurojmë mbështetje për prodhimtarinë primare, si dhe ruajtjen, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore. Kështu, prioritet i kemi dhënë subvencionimit të tre sektorëve kyç të bujqësisë: drithërave, hortikulturës dhe blegtorisë. Shpërndarja e granteve dhe subvencioneve është riorganizuar bazuar në kritere të qarta dhe transparencë të plotë, me rritje të pjesës së subvencioneve prej 100 për qind për shkak të pandemisë.

Për ne si qeveri, pavarësia energjetike është çështje e sigurisë kombëtare dhe e qëndrueshmërisë ekonomike. Në këtë drejtim, kemi filluar punën drejt ndërtimit të një sistemi energjetik që është komplementar me atë të Shqipërisë si dhe është intensifikuar puna me partneret tanë ndërkombëtar e strategjik për investimet në energjinë e ripërtërishme dhe në projektin për qasje në gazsjellësin TAP.

Drejtësi e pavarur dhe efikase

Qeveria e Republikës së Kosovës është e vendosur për sundimin e rendit dhe të ligjit, për shtetin e së drejtës sipas kritereve të Bashkimit Evropian. Në këtë kontekst, e ritheksoj se lufta kundër korrupsionit dhe të gjitha dukurive të tjera që e pengojnë ekonominë e lirë të tregut, mbetet prioritet.

Qeveria e Kosovës ka filluar reforma legislative nëpërmjet rishikimit dhe hartimit të projektligjeve, projekt-kodeve dhe koncept-dokumenteve në fusha të ndryshme të drejtësisë. Në përputhje të plotë me praktikat më të mira të BE-së dhe SHBA-së, Qeveria tashme ka filluar hartimin e modaliteteve dhe skenarëve të vetingut në sistemin e drejtësisë me të vetmin qëllim, që është rritja e llogaridhënies.

Lufta kundër krimit të organizuar do të jetë e pa kompromis. Kjo u dëshmuua edhe me operacionin e policisë së ndërmarrë ditë më parë në Karaçevë, dhe do të vazhdoj me operacione të tilla deri në çrrënjosjen e kësaj dukurie negative. Me qëllim të krijimit të kapaciteteve të nevojshme për luftim efikas të krimit, Qeveria ka filluar angazhimin për fuqizimin e policisë së Kosovës përmes rritjes së buxhetit, kapaciteteve njerëzore dhe investimeve kapitale.

Gjithashtu, Qeveria është e angazhuar plotësisht në rritjen e mbrojtjes dhe sigurisë publike. Në këtë drejtim, Ministria e Punëve të Brendshme ka nënshkruar Marrëveshjen e Punës me EUROPOL-in, e cila përbën një hap më afër integritit dhe bashkëpunimit të plotë të drejtpërdrejtë në mes të Policisë së Kosovës dhe EUROPOL-it, si dhe qasje në sistemin e shkëmbimit të të dhënave të EUROPOL-it.

Politika e jashtme, integrimi në BE dhe dialogu me Serbinë

Në politikën e jashtme, Qeveria ka arritur që brenda këtyre tre muajve t'i rivendosë marrëdhëniet e ngushta me vendet mike, në rend të parë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me vendet kryesore të Bashkimit Evropian, të cilat ishin lënduar. Me kënaqësi theksoj se Qeveria e Republikës së Kosovës, ka arritur që ta rifunksionalizojë bashkëpunimin e plotë me këto vende, të cilat i kemi pasur dhe do t'i kemi partnerë strategjik në rrugën tonë të integritit euro-atlantik.

Po kështu, gjatë kohe, kemi pasur komunikim të ngjeshur me NATO-n dhe me vetë Sekretarin e Përgjithshëm Jens Stolteberg, ndërkohë që në terren KFOR-i vazhdon të bëjë një punë të shkëlqyeshme për paqen dhe stabilitetin në vend. Kuptohet, synimi ynë final mbetet anëtarësimi në NATO, prandaj jemi të përkushtuar tërësisht që me të gjitha kapacitetet t'i mbështesim Forcat e Sigurisë të Kosovës për t'i arritur sa më parë të gjitha kriteret e nevojshme për të qenë pjesë kontributdhënëse e misioneve paqësore të kësaj aleance kudo në botë.

Kur e kemi marrë udhëheqjen e Qeverisë, bashkëpunimin me Republikën e Shqipërisë e kemi gjetur në një gjendje në të cilën nuk duhet të jenë asnjëherë marrëdhëniet tona të ndërsjella. Falë angazhimit dhe mirëkuptimit të dyanshëm tashmë jemi para një faze të re në marrëdhëniet tona, kur nga ceremonitë e nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale, do të kalojmë në realizimin konkret të projekteve me interes afatgjatë ekonomik jo vetëm për të dy vendet, por për mbarë rajonin.

Sa i përket dialogut me Serbinë, Qeveria e Kosovës ka pasur qasje shumë konstruktive. Kemi bashkëpunuar ngushtë me të dërguarin special të BE-së për dialogun Kosovë-Serbi, z. Miroslav Lajçak dhe me kryediplomatën e BE-së, Josep Borrel.

Ndërkohë, jam pritur nga Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, i cili ka pohuar përkushtimin e tij për arritjen e një marrëveshjeje finale gjithëpërfshirëse me Serbinë. Këtë përkushtim ai e ka theksuar edhe në Samitin virtual të Parisit, ku përveç tij, morën pjesë edhe kancelarja gjermane Angela Merkel, z. Borrel dhe z. Lajçak. Edhe në këtë takim, pjesëmarrësve dhe palës serbe ua paraqitëm vullnetin tonë të plotë për arritjen e një marrëveshjeje finale, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të obligueshme me Serbinë, e cila duhet të përfshijë njohjen reciproke dhe perspektivën e qartë euroatlantike të Kosovës.

Ndërsa takimet e koordinatorëve për dialog kanë vazhduar në Bruksel, ne kemi pasur takimin e 4 shtatorit 2020 në Shtëpinë e Bardhë, ku në prani të Presidentit Donald Trump, kemi nënshkruar marrëveshjen e normalizimit të marrëdhënieve ekonomike me Serbinë, e cila paraqet një hap shumë të rëndësishëm drejt marrëveshjes finale me Serbinë. Ndonëse reagimet ndaj kësaj marrëveshjeje brenda vendit kanë qenë shpeshherë të ashpra, ajo me të drejtë është cilësuar si një marrëveshje historike që mundëson ecjen përpara kah zgjidhja përfundimtare e kontestit

politik në mes të dy vendeve. Edhe me këtë rast, e falënderojmë Presidentin Trump dhe të gjithë administratën amerikane për rolin e jashtëzakonshëm në arritjen e kësaj marrëveshjeje, e cila është një akt i vullnetit tonë të mirë për arritjen e marrëveshjes përfundimtare në mes dy shteteve sovrane.

Më 4 shtator 2020, në Shtëpinë e Bardhë, vendi ynë mori një lajm të jashtëzakonshëm. Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanjahu, më njoftoi se Izraeli ka vendosur ta njohë Republikën e Kosovës, ndërsa unë, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës i pohova atij gatishmërinë tonë për vendosjen sa më të shpejtë të marrëdhënieve bilaterale dhe shkëmbimin e ambasadorëve.

Më 10 shtator 2020, kam qëndruar në Parlamentin Evropian në Bruksel, ku nga Kryetari David Sassoli dhe nga Komiteti për Punë të Jashtme i këtij parlamenti kam kërkuar që qytetarëve të Kosovës t'u mundësohet lëvizja e lirë, pasi që Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara nga Bashkimi Evropian për liberalizimin e vizave.

Republika e Kosovës është plotësisht e vendosur të përmbyllë me sukses procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, në NATO dhe në strukturat e tjera euroatlantike, duke përfshirë edhe OKB-në, si streha më e madhe e kombeve të lira.

Në këtë rrugëtim, gjithsesi, marrëdhëniet speciale dhe miqësia e përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të mbeten gjithmonë esenciale për ne.

Organizimi i mësimin në kohën e pandemisë

Pandemia COVID-19 e ka goditur sidomos sistemin arsimor. Ne jemi të vetëdijshëm se asnjë formë, sado e avancuar që të jetë, nuk mund ta zëvendësojë praninë e mësuesit dhe të nxënësit në klasën e mësimin. Sidoqoftë, duke e pasur parasysh gjendjen aktuale, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim të ngushtë me tërë sistemin arsimor të vendit, ka hartuar një plan të detajuar për fillimin e vitit shkollor 2020/2021, i cili parasheh tre skenarë për realizimin e procesit mësimor në të gjithat nivelet e arsimit parauniversitar.

Pavarësisht kësaj, Qeveria ka filluar angazhimin e menjëhershëm për një sistem modern të arsimit, që është gjithëpërfshirës, cilësor, autonom, i integruar publik dhe privat, që u ofron qytetarëve qasjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Të dashur qytetarë,

Marrja e përgjegjësisë për udhëheqjen e Qeverisë në momentet kur raportet me miqtë tanë ishin të lënduara rëndë, ishte tejet sfiduese dhe kërkonte përkushtim të madh. Qeveria e jonë ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë ndihmëse e institucioneve të pavarura drejt avancimit të pavarësisë së tyre funksionale dhe vendimmarrëse. Jemi përkushtuar në ndërtimin e konsensusin shoqëror e politik për sfidat që na presin, siç janë mposhtja e epidemisë nga Covid-19, rimëkëmbja ekonomike, forcimi i rendit dhe ligjit, si dhe dialogu për marrëveshjen me Serbinë.

Në fund, më lejoni të falënderoj edhe një herë ata që janë në vijën e parë të përballjes me Covid-19, punëtorët e administratës shtetërore në të gjitha nivelet që mundësuan funksionimin

e institucioneve në këtë kohë, nxënësit dhe profesorët që gjetën rrugën e re për të siguruar vazhdimësinë e mësimit, sipërmarrësit privat që nuk hoqën dorë nga puna duke gjetur forma për të mbijetuar, bujqit që sivjet u angazhuan si asnjëherë më parë.

Ju siguroj se ky është vetëm fillimi i vendosjes së normalitetit, si kusht elementar për një qeverisje demokratike, për zhvillim e punësim për të gjithë, për integritet euro-atlantike. Kjo Qeveri, me gjithë fuqinë që ka, do tu dalë në ndihmë të gjithëve pa dallim.

Avdullah Hoti



Kryeministër i Republikës së Kosovës

1. Menaxhimi i pandemisë nga COVID-19 dhe rimëkëmbja ekonomike pas pandemisë

Natyra evolutive dhe shpejtësia e zhvillimit të pandemisë COVID-19, e përcjellë me të panjohura në zhvillimin e sëmundjes që shkakton, kanë çuar në sfida të pashembullta për sistemet e kujdesit shëndetësor, si dhe në ndikime dramatike socio-ekonomike në gjithë botën. Prandaj, Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me të gjitha institucionet e tjera, i ka kushtuar një rëndësi dhe kujdes të veçantë marrjes së masave për mbrojtje dhe parandalim të përhapjes së virusit COVID-19.

Objektivat themelore të Qeverisë në programin qeverisës janë:

- *beteja për ta mposhtur pandeminë, dhe*
- *rimëkëmbja e ekonomisë pas pandemisë.*

Nga shpallja e emergjencës së shëndetit publik (COVID – 19), Qeveria e Republikës së Kosovës nëpërmjet Ministrisë së Pushtetit Lokal ka ndërmarrë veprimet e nevojshme, me qëllim të koordinimit ndërinstytucional dhe informimit të komunave, si dhe mbështetjes së ofruar, për parandalim dhe mbrojtje. Janë adresuar kërkesat e 38 komunave në Qendrat Operative përkatëse në nivel vendi. MPL-ja së fundmi ka publikuar raportin për aktivitetet e komunave gjatë kësaj periudhe lidhur me COVID-19.

Miratimi i Manualit për mbrojtje nga përhapja e virusit COVID-19

Më 15 qershor janë miratuar propozimet e MSh-së lidhur me COVID-19 së bashku me Manualin për mbrojtje nga përhapja e virusit COVID-19. Ky manual specifikon të gjitha detajet për mënyrën e organizimit të punës në të gjitha bizneset private, ndërmarrjet publike, në institucionet publike dhe çdo veprimtari tjetër. Si i tillë është hartuar duke shfrytëzuar udhëzimet e institucioneve të besueshme ndërkombëtare si OBSH, CDC dhe ECDC, të fokusuara për COVID-19.

Komiteti për Vlerësim dhe Koordinim rreth COVID-19

Me qëllim të institucionalizimit në përballje me COVID-19, Qeveria e Kosovës, nën udhëheqjen e kryeministrit Hoti, nëpërmjet Komitetit për Menaxhimin e COVID-19, ka diskutuar në baza të rregullta masat e ndërmarra në Kosovë për menaxhimin e pandemisë. Këto diskutime i kanë shërbyer qeverisë për marrjen e vendimeve bazuar në situatën epidemiologjike. Aktivitetet janë koordinuar nëpërmjet Komitetit për Vlerësim dhe Koordinim të situatës rreth COVID-19, një trup ky multisektorial, me përfaqësim të nivelit qendror dhe atij lokal, i themeluar me vendim të ministrit të Shëndetësisë.

1.1. Masat e reja për luftimin e pandemisë COVID-19

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, më 7 korrik 2020, ka miratuar vendimin për masat e luftimit të pandemisë COVID 19, me të cilin ka obliguar Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet kompetente shëndetësore që të rrisin kapacitetet me

shtretër dhe pajisje mjekësore, ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme dhe të menjëhershme për të realizuar testimet virologjike, duke përfshirë: shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve ekzistuese për testim, krijimin e kapaciteteve të reja testuese në regjione, licencimin e institucioneve private shëndetësore për të kryer teste për COVID-19, në përputhje me ligjet në fuqi dhe përcaktimin si prioritet të testimit të personave më në nevojë.

Pas analizës së situatës epidemiologjike në vend, Qeveria e Kosovës, me propozim të Ministrisë së Shëndetësisë, ka ndërmarrë masën e vendosjes së reciprocitetit ndaj vendeve të cilat kërkojnë që qytetarët të dëshmojnë se janë të shëndoshë nga COVID-19, me testin RT-PCR në Sars COV-2, si dhe masa të tjera administrative, ku përfshihen të gjithë sektorët, përfshirë edhe kufizimin e lëvizjes në disa komuna.

Ministria e Shëndetësisë ka themeluar mekanizmin për monitorimin e zbatimit të vendimit duke raportuar në baza javore rrjedhën e zbatimit të vendimit në Sekretariatit Koordinues të Qeverisë.

Lidhur me luftën kundër COVID-19 është formuar trupi koordinues për inspektime për zbatimin e masave të Qeverisë së Kosovës të përcaktuara me vendimin nr. 01/10, të datës 5. 7. 2020. Gjatë kësaj periudhe, Inspektorati i Punës ka realizuar inspektime në bazë të planit të punës, ndërsa mbi 1000 inspektime në bazë të ankesave të palëve dhe gjatë kësaj kohe kanë qenë të angazhuar në inspektime të përbashkëta me inspektoratin sanitar për implementimin e masave kundër COVID 19, si dhe kanë filluar përgatitjet për implementimin e masës së tretë të rimëkëmbjes ekonomike, për subvencionim në pagë për personat e papunësuar dhe masat e tjera në bazë të planit të rimëkëmbjes ekonomike.

Ngritja e kapaciteteve spitalore

Për të zbatuar vendimin e Qeverisë për rritjen e kapaciteteve për menaxhimin e rasteve me COVID-19, Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) ka caktuar Spitalin e Vushtrrisë si spital në funksion të pacientëve me COVID-19 për Mitrovicë, Vushtrri dhe zonat përreth me 60 shtretër spitalorë, ndërsa Spitalin e Mitrovicës e ka përcaktuar për të shërbyer për të gjitha patologjitë e tjera.

Në QKUK, krahas Klinikës Infektive, në funksion të menaxhimit të rasteve klinike me COVID-19 janë vënë në dispozicion edhe Klinika e Pulmologjisë, Klinika e Dermatovenerologjisë, një kat i Klinikës së Neurologjisë, një pjesë e Klinikës së Gjinekologjisë (30 shtretër), derisa pacientët nga Qendra e Mjekësisë Sportive janë transferuar në Mjekimin Intensiv Qendror, me qëllim që Qendra e Mjekësisë Sportive të krijojë hapësirë të re për pacientë. Në Klinikën e Pediatrisë është caktuar një repart për vendosjen e fëmijëve që janë të dyshuar apo të konfirmuar me COVID-19.

Në spitalet e përgjithshme janë funksionalizuar repartet infektive për pacientët me COVID-19, ambulancat qendrore specialistike janë shndërruar në ambulanca për pranim të rasteve të dyshuara dhe konfirmuara me COVID-19 dhe kështu kapaciteti spitalor për COVID-19 është rritur në rreth 700 shtretër, me mundësi të shtimit sipas nevojave dhe rekomandimeve që jepen nga IKSHPK, bazuar në ecurinë e pandemisë. Opsione të tjera janë marrë në konsideratë, duke përfshirë këtu edhe shfrytëzimin sipas nevojave të spitalit të FSK-së.

Shtimi i resurseve humane

Në funksion të zbatimit të Manualit dhe fuqizimit të kapaciteteve zbatuese dhe monitoruese kundër COVID-19, Ministria e Shëndetësisë ka shpallur konkurs publik dhe ka kryer procedurat e rekrutimit të 200 specialistëve shëndetësorë (100 mjekëve - në mesin e të cilëve edhe mikrobiologë, 62 infermierë, 20 inspektorë sanitarë, 4 specialistë të mikrobiologjisë, 8 laborantë dhe 6 të tjerë - staf teknik mbështetës). Ky është një nga hapat e parë drejt fuqizimit të kapaciteteve të menaxhimit të fazave të mëtejme të COVID-19, krahas mobilizimit edhe të kapaciteteve të tjera të nevojshme për të përballuar cilindo skenar të zhvillimit të pandemisë.

Është hapur edhe konkursi për rekrutimin e 1034 specialistëve (me pagesë dhe vullnetarë për sektorin publik dhe privat) me prioritet lëmitë e lidhura me menaxhimin e COVID-19. Ky konkurs është plotësuar edhe me 78 vende të tjera (përfshirë edhe 48 vende të ndara për mjekët në Luginën e Preshevës).

Nga riorganizimi i Projektit të Shëndetësisë Kosovare (Huamarrja e Bankës Botërore) është shpallur rekrutimi i 375 profesionistëve të tjerë shëndetësorë për të forcuar kapacitetet njerëzore për përballjen e COVID-19, në veçanti në zbatimin e Manualit dhe masave kundër COVID-19. Hapjes së procedurave të specializimit i ka paraprirë themelimi i Bordit Qendror për Shkollimin Specialistik (përbërje e re) dhe themelimi i 25 komiteteve specialiste.

Testimet

Në rrafshin e monitorimit të situatës epidemiologjike dhe mbajtjes nën kontroll të saj, MSh dhe IKSHPK kanë vazhduar forcimin e përgjigjes ndaj pandemisë nëpërmjet: gjurmimit aktiv të rasteve, testimeve, izolimit të rasteve pozitive dhe të kontaktit dhe trajtimit të të prekurve (qoftë në mënyrë spitalore, qoftë me tretman shtëpiak - vetizolimit dyjavor).

Sa u përket testimeve, është hartuar dhe miratuar Plani i Veprimit për procedurat e testimit për COVID-19, me objektiv strategjik: Rritjen e mbulueshmërisë së shkallës së testimeve në popullatë, duke siguruar pajisjet e reja për Qendrat Rajonale të Shëndetit Publik, Kujdesin Parësor dhe duke shtrirë testimet edhe në sektorin privat. Në funksion të zbatimit të këtij plani, MSh-ja ka hapur procesin e blerjes së 7 aparateve për RT-PCR (testime molekulare), të cilat do të vendosen në QRSHP në qytetet e mëdha për ta decentralizuar procesin e testimeve, derisa OBSH-ja do të sjellë në Kosovë edhe 3 aparate për RT-PCR, me çka IKSHPK-ja do të ketë mundësi të shtojë edhe ndërrimin e tretë të testimeve, duke i rritur kapacitetet diagnostikuese për SARS-Cov-2, përkatësisht për testime për COVID-19.

Nga Riorganizimi i Projektit të Shëndetësisë Kosovare (Granti i Bankës Botërore) janë hapur procedurat për blerjen e:

-
- *7 aparateve për RT-PCR,*
 - *100 000 testeve PCR,*
 - *30 000 teste rapide dhe*
 - *100 000 teste serologjike.*
-

Me qëllim që testimet të shtrihen edhe në sektorin privat dhe gjithashtu dhe në Kujdesin Parësor Shëndetësor janë miratuar tre udhëzime administrative:

- *Udhëzimi Administrativ (në Shëndetësi) nr.01/2020, për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrative 09/2014 -kushtet për punë sa i përket hapësirës, kuadrit profesional dhe pajisjeve mjekësore të institucioneve private shëndetësore jashtë spitalore.*
- *Udhëzimi Administrativ (në Shëndetësi) nr.02/2020 – Për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrative 06/2015 kushtet e përgjithshme dhe të veçanta spitalore.*
- *Udhëzimi Administrativ nr. 03/2020 për plotësim ndryshimin e UA 08/2017 –organizimi, struktura, përcaktimi i shërbimeve dhe veprimtaritë e institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor.*

Krahas kësaj, me qëllim të zbatimit të akteve nënligjore që i paraprijnë “Licencimit të institucioneve private shëndetësore për të kryer teste për COVID-19, ministri i Shëndetësisë ka themeluar: Bordin për licencimin e institucioneve private shëndetësore dhe Komisionin për shqyrtimin e ankesave të aplikuesve dhe institucioneve private shëndetësore.

Bordi për licencimin e institucioneve private shëndetësore ka filluar shqyrtimin e kërkesave të institucioneve private shëndetësore, të cilat kanë kërkuar leje për kryerjen e testeve për SARS CoV-2. Bordi ka aprovuar deri më 25 gusht 2020 kërkesat e 97 (nëntëdhjetë e shtatë) institucioneve private shëndetësore për kryerjen e testeve për SARS COV 2 (95 për teste serologjike dhe 2 për teste molekulare PCR). Shumica prej këtyre institucioneve kanë filluar veprimtarinë dhe raportimin në IKSHPK. Sa i përket testimit në sektorin publik, bazuar edhe në strategjinë e OBSH-së, prioritet për testim mbesin personat e hospitalizuar, personat me sëmundje kronike dhe të moshuarit, si dhe personat e sëmurë që trajtohen jashtë vendit.

Vaksinat kundër Gripit sezonal dhe vaksinat kundër COVID-19

Në zbatim të programit për vaksinim të grupeve të rrezikuara dhe në zbatim edhe të vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria e Shëndetësisë në përputhje edhe me kërkesat e IKSHPK-së, ka iniciuar procedurën e prokurimit të vaksinave kundër gripit sezonal mbështetur në marrëveshjen me UNICEF. Sasia e iniciuar në aktivitetin e prokurimit përmes UNICEF është 120,000 doza vakcina kundër gripit sezonal për të rritur dhe 500 doza për fëmijët. Gjithashtu do të blihen edhe 380 000 mijë vakcina të tjera nga Ministria e Shëndetësisë.

Sa i përket vaksinës potenciale kundër COVID-19, Ministria e Shëndetësisë ka komunikuar me COVAX dhe po mban kontaktet edhe me OBSH-në me qëllim të sigurimit të vaksinave për gjithë popullatën, përveç 20% që ofrohen falas sipas kriterit.

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe donacionet

Ministria e Shëndetësisë, me qëllim të përballimit të pandemisë COVID-19 dhe krijimit të kushteve për institucionet shëndetësore, është angazhuar maksimalisht që të sigurojë

mbështetjen e komunitetit të donatorëve si dhe të iniciojë projekte të mbështetjes financiare për shëndetësinë për sigurimin e mjeteve mbrojtëse personale për profesionistët shëndetësorë, pajisjeve dhe produkteve mjekësore. Për këtë qëllim ministri i Shëndetësisë ka realizuar takime me shumicën e ambasadorëve të akredituar në Kosovë, KFOR-in, Zyrën e Bashkimit Evropian, nga të cilët është kërkuar mbështetja dhe bashkëpunimi.

Më 5 qershor, SHSKUK, ka pranuar kontingjentin e tretë të pajisjeve mbrojtëse nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, në vlerë prej 5 milionë eurosh. Në donacion përfshihen 10 autoambulanca, 100 shtretër dhe pajisje të tjera.

Ministria e Shëndetësisë ka pranuar donacion me pajisje mbrojtëse profesionale për personelin shëndetësor (maska kirurgjikale, FFP2 – maska respirator, veshje mbrojtëse, mbrojtëse për fytyrë, dorëza të formateve të ndryshme, mbulesa për shtretër) nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, si reagim të menjëhershëm ndaj COVID-19, në muajin qershor ka pranuar 20 ventilatorët e parë mobilë për Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) të blera me fonde të qeverive të Norvegjisë, Zvicrës dhe Luksemburgut.

Donatorët nga diaspora, si kompanitë: “Ecolog”, “Euro-Koha” dhe “AWR Abbruch” e kanë ndihmuar IKShPK-në me 12 mijë kite për teste për COVID-19. Ministria e Shëndetësisë, po ashtu, ka pranuar 6500 testeve (RT-PCR) për diagnostikimin e COVID-19 dhe 6 respiratorë nga organizata “Qatar Charity” sipas një memorandumit të nënshkruar nga ministri i Shëndetësisë. Më 10 korrik ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë, Christian Heldt, i dorëzoi 6.000 teste RT-PCR COVID-19 Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike për përgjigje ndaj pandemisë COVID-19, të cilat u siguruan dhe u financuan nga Ministria e Shëndetësisë e Gjermanisë.

Më 23 korrik 2020, Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut nëpërmjet Lux-Dev S. A. dhe Qeveria e Austrisë, nëpërmjet Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim, në partneritet me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) i kanë dhuruar Institutit Kombëtar për Shëndetësi Publike të Kosovës (IKShPK) dhe Ministrisë së Shëndetësisë 41.000 komplete testimi për COVID-19.

Nga Jordania është pranuar kontingjenti 24 tonë pajisje mbrojtëse profesionale me 500 000 maska mbrojtëse dhe pajisje të tjera mbrojtëse.

Më 3 gusht një kontingjent që përmban 17 000 maska respiratorë FFP2 (EN 149)/N95 (NIOSH), 5500 pako me dorëza nitrile të madhësive të ndryshme dhe 3700 litrave me dezinfektues, është financuar nga autoritetet e shtetit të Gjermanisë.

Më 4 gusht BE-ja i dorëzon SHSKUK-së 30 ventilatorë, 200 pulsoksimetra, 20 makina elektrokardiografike dhe pajisje të tjera si pjesë e donacionit prej 5 milionë eurosh nga Bashkimi Evropian, për trajtimin e pacientëve të prekur me COVID-19. Pakoja e fundit e ndihmës kap vlerën e 900 mijë euro dhe është dorëzuar nga Zëvendësambasadori i BE-së në Kosovë.

Më 19 gusht, Zyra për Bashkëpunim dhe Mbrojtje e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, i ka dhuruar SHSKUK-së donacionin e radhës me kontejnerë për mbetje spitalore dhe pajisje të tjera

në funksion të menaxhimit të COVID-19 në vlerë 103,000 euro.

Më 24 gusht, MSh-ja ka pranuar donacionin e radhës me pajisje mjekësore nga UNICEF-i (në bashkëfinancim me Qeverinë e Japonisë) prej 7.4 tonelatave kryesisht në pajisje mbrojtëse. Me herët UNICEF-i ka ndarë edhe 50 oksigjeno-formues për KPSH në Kosovë.

Më 25 gusht, Ministria e Shëndetësisë ka pranuar donacion nga USAID-i 50 ventilatorë për nevojat e klinikave të QKUK-së dhe Spitaleve të përgjithshme sipas Marrëveshjes së nënshkruar me USAID-in.

Gjithashtu, më kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar ka filluar edhe: inicimi i procedurave për anëtarësimin e Kosovës në Rrjetin shëndetësor të Evropës Juglindore dhe Marrëveshja me Ambasadën Italiane për sjelljen e 4 profesionistëve shëndetësor për 2 muaj për të ndihmuar në përballjen me COVID 19.

Bordi Këshillues për COVID-19

Me qëllim të adresimit të nevojës për të pasur informacione dhe këshilla profesionale të bazuara në dëshmi shkencore rreth COVID-19 për një përgjigje sa më adekuate ndaj situatës me këtë sëmundje në Kosovë, Ministri i Shëndetësisë ka themeluar Bordin këshillëdhënës për COVID-19 i kryesuar nga mikrobiologu Lul Raka. Ky bord ka dhënë 68 rekomandime për ministrin e Shëndetësisë, rreth 80 për qind e të cilave janë zbatuar dhe janë bërë pjesë e vendimmarrjes lidhur me COVID-19.

Strategjia e komunikimit

Zyra e Komunikimit me Publikun e MSh, bashkë me Zyrën për Komunikim Publik të ZKM-së dhe IKSHPK-së kanë ndërtuar një Plan Strategjik të Komunikimit për COVID-19, i cili përfshin:

- *Komunikimin e rezultateve për COVID (IKSHPK, raportet e SHSKUK-së dhe aspekte të tjera);*
- *Rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjes në media;*
- *Prodhimi i videomesazheve, grafikave dhe materialeve të tjera informative për COVID-19;*
- *Storie të përditshme në media rreth COVID-19 dhe pasojave të tij;*
- *Takime me drejtuesit e mediave rreth angazhimeve të përbashkëta për COVID-19;*
- *Sigurimi i mjeteve mbrojtëse për gazetarët që të informojnë drejtpërdrejt nga klinikat dhe spitalet e përgjithshme.*

Për zbatimin e këtij plani, janë konsultuar dhe kanë dhënë mbështetje partnerët, si: OBSH, UNDP, UNICEF, AQH, USAID.

Vizita në Luginën e Preshevës

Ministri i Shëndetësisë ka realizuar vizitë pune më 8 gusht në Luginën e Preshevës, ku, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka ofruar përkrahje të drejtpërdrejtë për menaxhimin e pandemisë COVID-19. Në këtë kontekst, MSh-ja ka ndarë 48 vende për specializime të mjekëve nga Presheva (8 me financim të MSh-së dhe 40 vullnetarë), me kushtin që të njëjtit pas përfundimit të specializimit të kontribuojnë në komunat me shumicë shqiptare si Bujanoc e Preshevë. Një vizitë e shkurtër pune është realizuar në korrik edhe në Tiranë, ku me ministren e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu dhe drejtuesit e ISJP-së në Tiranë janë këmbyer ide rreth menaxhimit të COVID-19. Videokonferenca dhe biseda telefonike janë realizuar edhe me të gjithë ministrat e Shëndetësisë të rajonit, në disa raste me ndihmën e KFOR-it.

1.2. Zbatimi i programit për rimëkëmbje ekonomike

Ministria e Financave ka qenë e përkushtuar në zbatimin e disiplinës fiskale me qëllim të ruajtjes së stabilitetit makrofiskal të vendit dhe ruajtjen e mirëqenies së qytetareve. Në këtë kontekst:

- *Është publikuar Buletini Makroekonomik, i cili ka ofruar një pasqyrë ekonomike për tremujorin e parë të vitit 2020. Gjatë kësaj periudhe është mbajtur takimi konsultativ rreth procesit të përgatitjes së Programit të Reformave në Ekonomi 2021-2023, i cili në fokus do të ketë rimëkëmbjen ekonomike në Kosovë pas krizës të shkaktuar nga pandemia COVID-19;*
- *Është përfunduar Analiza lidhur me Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike COVID 19, Analiza për kalendarin e akcizës në duhan dhe Mbledhjen e të dhënave nga ATK-ja dhe Dogana, si dhe zhvillimi i modelit ekonometrik për Analizën e Kostove dhe Benefiteve lidhur me Lirimet e Prodhuesve;*
- *Është miratuar Udhëzuesi për zbatimin e masave të kujdesit të duhur ndaj klientit gjatë periudhës COVID-19 nga Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF-K) në konsultim me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.*

Sa i përket sigurimit të financave publike të shëndosha, nëpërmjet reformave në menaxhimin e financave publike dhe bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare, janë marrë një sërë veprimesh.

Janë përmbyllur procedurat për nënshkrimin e 9 marrëveshjeve në vlerë financimi prej rreth 250 milionë eurosh, ku 213 milionë euro janë financim për luftën ndaj pandemisë COVID-19. Në këto marrëveshjet përfshihen: Marrëveshja me Bankën Botërore në vlerë prej 46 milionë euro për “Projektin Emergjent COVID-19 për Kosovën”, Asistenca Marko-financiare me Bashkimin Evropian në vlerë prej 100 milionë eurosh; Marrëveshja me Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës për projektin “Reagimi Emergjent ndaj COVID-19” në vlerë prej 35 milionë eurosh; Marrëveshja me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për “Financimin Emergjent të Infrastrukturës Vitale” në vlerë prej 30 milionë eurosh, dhe marrëveshja të tjera të ndërlidhura. Po ashtu, janë ratifikuar marrëveshjet ndërmjet BE-së dhe Kosovës për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e BE-së “Dogana 2020” dhe marrëveshja ndërmjet BE-së dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e BE-së “Fiskalis 2020”.

Në kuadër të zhvillimit ekonomik dhe rimëkëmbjes ekonomike, Qeveria e Kosovës gjatë periudhës 100-ditore ka aprovuar Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike – COVID – 19, me qëllim të rimëkëmbjes së ekonomisë së Republikës së Kosovës pas efekteve negative të shkaktuara nga pandemia COVID-19. Në vazhdimësi të këtij procesi si dhe për t'iu ndihmuar qytetarëve të Republikës së Kosovës, si dhe bizneseve bazuar në Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike do të plotësohen dhe do të ndryshohen ligjet si në vijim:

- *Ligji për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore;*
- *Ligji për Fondet Pensionale të Kosovës;*
- *Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale;*
- *Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar;*
- *Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;*
- *Ligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave;*
- *Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat;*
- *Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit*

Gjithashtu, është miratuar edhe Plani i zbatimit të rimëkëmbjes ekonomike. Plani i aprovuar për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike kap vlerën prej treqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë eurosh (365,000,000.00 €).

Qeveria e Kosovës ka miratuar edhe Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me financimin e Projektit Emergjent COVID -19 për Kosovën. Marrëveshja i siguron Republikës së Kosovës një kredi prej 46 milionë eurosh, me normë të ulët interesi dhe me një periudhë të shlyerjes 20-vjeçare dhe një greis periudhë prej 5 vjetësh. Kredia do të përdoret për rritjen e kapaciteteve shëndetësore në menaxhimin e pandemisë COVID-19, si dhe në sanimin e pasojave të pandemisë.

2. Qeverisja, reforma institucionale dhe kohezioni shoqëror

Gjatë këtyre 100 ditëve, Qeveria e Kosovës ka mbajtur 29 mbledhje dhe ka marrë 158 vendime. Pas miratimit të Programit të Qeverisë 2020 -2023, SKQ-ja ka koordinuar punën me të gjitha ministratë për përgatitjen e Planit të Punës së Qeverisë në periudhë 3-vjeçare, i cili është miratuar më 15 qershor 2020. Njëkohësisht është punuar edhe për zbatimin e Koncept Dokumentit për Zvogëlimin e Barrës Administrative, ku është vendosur metodologjia e analizimit të ligjeve, si dhe ka përfunduar analiza bazë për 186 ligje.

Në aspektin e koordinimit, janë miratuar 3 koncept dokumente (7 që nga fillimi i vitit), ndërsa 59 koncept dokumente janë në proces. Përkundër gjendjes së shkaktuar nga pandemia, mbështetja e Ministrive për hartimin e Koncept Dokumenteve ka vazhduar me takime online. Me qëllim të përmirësimit të hartimit të koncept dokumenteve, për herë të parë është duke u hartuar analiza e testit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme sipas Udhëzuesit për hartimin e koncept dokumenteve.

Gjatë kësaj përudhe ka filluar dhe vlerësimi i performancës së projektit të Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), (projekt ky që ka mbështetur Sekretariatit Koordinues të Qeverisë), nga auditorë ndërkombëtarë, me qëllim të vlerësimit të përmbushjes së këtij projekti.

Ndër të tjera, në bashkëpunim me ministratë përgjegjëse është hartuar dhe raporti i zbatimit të marrëveshjeve të përbashkëta me Shqipërinë, si dhe është përgatitur propozimi për indikatorët në kuadër të përkrahjes buxhetore gjatë rishikimit të IPA II.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 7 seanca të rregullta të Kuvendit të Kosovës (dhe 5 vazhdime të seancave të rregullta), si dhe 1 seancë solemne dhe 1 seancë e jashtëzakonshme. Si rezultat i këtyre seancave, janë parashtruar nga deputetët 67 pyetje parlamentare për kryeministrin, zëvendëskryeministrat dhe ministrat. Po ashtu, janë parashtruar tri interpelanca të drejtuara ndaj kryeministrit, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe ministrit të Punëve të Brendshme. Njëkohësisht, gjatë kësaj periudhe janë proceduar në Kuvend 12 projektligje dhe 16 vendime të Qeverisë.

Në fushën e planifikimit strategjik, kanë filluar angazhimet në kuadër të Komisionit për Planifikim Strategjik, Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik, Kornizës Kombëtare për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, Programit për Reforma në Ekonomi, Specializimit të Mençur dhe Planit vjetor të dokumenteve strategjike. Këto angazhime janë nisur në bashkëpunim me Zyrën për Planifikim Strategjik (ZPS).

Si rrjedhojë e miratimit të vendimit për themelimin e strukturave për planifikim strategjik, më datë 22 korrik 2020 është mbajtur takimi i parë i Komisionit për Planifikim Strategjik (KPS), ku është shqyrtuar lista e projekteve parësore për të aplikuar për raundin e ardhshëm të Kornizës Investuese të Ballkanit Perëndimor. E njëjta çështje është shqyrtuar edhe në mbledhjen e Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik, ku u shqyrtua edhe Koncepti dhe udhërrëfyesi për hartimin e

Strategjisë së re Kombëtare për Zhvillim, koncept që është ende në zhvillim e sipër.

Në kuadër të finalizimit të Kornizës Kombëtare për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik dhe lidhur me procesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) janë mbajtur takime ndërmjet përfaqësuesve të Zyrave në kuadër të ZKM-së dhe MF-së, si dhe me përfaqësues nga projekti mbështetës në ZPS i Komisionit Evropian. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe është hartuar dhe është miratuar nga Qeveria Plani i Veprimit të Strategjisë për Përmirësimin e Planifikimit Strategjik 2020-2022.

Në kuadër të Programit për Reforma në Ekonomi është miratuar vendimi për fillimin e ciklit të ri të këtij programi për periudhën 2021-2030, si dhe për strukturat e tij. Me qëllim të avancimit të hartimit të PRE, është hartuar analiza mbi pengesat strukturore të fushave sipas Udhëzimit të Komisionit Evropian, si dhe është mbajtur takimi i parë konsultativ i nivelit të lartë.

Me qëllim të avancimit të Specializimit të Mençur është miratuar plotësim ndryshimi i Vendimit për Ekipin Nacional për Platformën e Specializimit të Mençur dhe është realizuar pjesëmarrja në seminarin virtual “Takimi i SCOPE (S3 Community of Practice in the EU Enlargement region) i Ekipeve Bazë për Specializimin e Mençur për të diskutuar për gjendjen e S3 dhe mbështetjen deri në mes të shtatorit 2020”, i organizuar nga JRC dhe EC.

Sa i përket fushës së hartimit të legjislacionit, Zyra Ligjore (ZL) e Zyrës së Kryeministrit (ZKM) duke u bazuar në Programin Legjislativ për vitin 2020, gjatë periudhës raportuese ka hartuar aktet ligjore nga fushëveprimi i ZKM-së, ka shqyrtuar konsistencën me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, ecurinë procedurale të projekt akteve dhe standardet e hartimit të legjislacionit, si dhe ia ka rekomanduar Qeverisë për aprovim dymbëdhjetë (12) projektligje dhe pesëmbëdhjetë (15) akte nënligjore.

Nga fushëveprimi i ZKM-së, Zyra Ligjore ka hartuar Projektligjin për Financimin e Subjekteve Publike, i cili i ka kaluar të gjitha procedurat e parapara me legjislacion. Vlen të përmendet se ky projektligj është dërguar në Komisionin e Venedikut. Të gjitha rekomandimet e Komisionit të Venedikut janë inkorporuar, janë mbajtur edhe takime me të angazhuarit në këtë proces dhe janë inkorporuar rekomandimet e tyre. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-174 për financimin e subjekteve politike është miratuar në mbledhjen e 26-të të Qeverisë. Është punuar intensivisht për hartimin dhe kryerjen e të gjitha procedurave të parapara me legjislacionin përkatës të pesë (5) projektligjeve:

1. Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës ka kaluar procesin e konsultimit publik. Të gjitha komentet e dërguara nga tetëmbëdhjetë (18) institucione dhe subjekte të ndryshme gjatë procesit të konsultimit publik janë shqyrtuar nga Zyra Ligjore, e cila ka përgatitur versionin final të Projektligjit për Qeverinë. Projektligji aktualisht është në konsultim të brendshëm në Kabinetin e Kryeministrit;

2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L -31 për Lirinë Fetare në Kosovë është përgatitur në pajtim me Opinionin e Komisionit të Venedikut. Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur takimet me bashkësitë fetare, Ambasadën e ShBA-ve, OSBE-në dhe subjektet e tjera të interesuara. Janë shqyrtuar të gjitha komentet e dërguara dhe projektligji është në fazën e finalizimit dhe pritet të miratohet në një nga mbledhjet e radhës së Qeverisë;

3. Projektligji për Aktet Juridike është dërguar në Komisionin e Venedikut për marrjen e Opinionit. Zyra Ligjore ka rihartuar projektligjin në linjë me rekomandimet e Komisionit të Venedikut dhe e ka ridërguar në konsultim publik. Aktualisht ndodhet në fazën e shqyrtimit dhe inkuorporimit të komenteve nga konsultimi publik;

4. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L – 178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë: gjatë periudhës raportuese janë mbajtur takimet me akterët përkatës përfshirë AKI-në, Sekretariatit e Këshillit të Sigurisë dhe akterët e tjerë të përfshirë. Projektligji është i gatshëm dhe pritet të miratohet në një nga mbledhjet e radhës së Qeverisë.

5. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/ L- 010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës - janë mbajtur takime me përfaqësues të AKKVP-së, OSBE-së, MD-së dhe institucioneve të tjera, me qëllim që të shqyrtohen komentet nga ana e tyre. Ky projektligj do t'i nënshtrohet një ndryshimi si rezultat i disa rekomandimeve të dërguara nga AKKVP.

Gjatë periudhës raportuese, Zyra Ligjore ka punuar edhe në tri (3) akte nënligjore: 1. Projekt Kodi i Mirësjelljes për të Emëruarit Politikë – është në fazën finale të tij dhe janë inkuorporuar komentet nga konsultimet paraprake dhe publike; 2. Projekt Udhëzimi administrativ për shpenzimet e telefonisë fikse dhe telefonisë mobile në Qeverinë e Republikës së Kosovës - është në fazën finale të tij dhe janë inkuorporuar komentet nga konsultimet paraprake dhe publike. 3. Projekt Udhëzimi Administrativ për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës – është në fazën e shqyrtimit të komenteve të pranura gjatë procesit të konsultimit paraprak dhe publik.

Sa i përket zvogëlimit të barrës administrative, Zyra Ligjore është duke punuar intensivisht në përmbushjen dhe zbatimin e indikatorit 5.3 të përkrahjes buxhetore sektoriale (SBS). Me miratimin e Koncept Dokumentit për Zvogëlimin e Barrës Administrative janë bashkëngjitur edhe tri raportet për thjeshtësimin e lejeve dhe licencave për tri ministritë e cekura më lart. Gjatë vitit 2020, janë duke u hartuar dhe është planifikuar të miratohen plotësim ndryshimet e 11 akteve ligjore dhe 24 akteve nënligjore, të identifikuara nga raportet për thjeshtësimin e lejeve dhe licencave për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe ish-Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (tani: Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit), të cilat pritet të kontribuojnë në zvogëlimin e barrës administrative. Tashmë, këto ministri kanë filluar krijimin e grupeve punuese dhe hartimin e teksteve fillestare të këtyre akteve juridike, të cilat janë pjesë e Programit Legjislativ dhe Planit Legjislativ për Aktet Nënligjore për vitin 2020.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe tremujore është ofruar ndihmë juridike nga ana e Zyrës Ligjore në çështje të ndryshme, si në vijim: përgatitja e kërkesës dhe dërgimi sipas procedurave i një Projektligjit për Tubimet Publike për opinion në Komisionin e Venedikut; ofrimi i komenteve gjatë procesit të konsultimit të akteve ligjore; ofrimi i opinionëve ligjore përfshirë edhe Koncept Dokumentet; ofrimi i shqyrtimi dhe dhënia e sqarimeve juridike; procedimi në avokaturën shtetërore i pesë (5) lëndëve që ndërlidhen me përfaqësim gjyqësor; dhe procedimi i kërkesës drejtuar MPJD-së për ratifikimin e një (1) Marrëveshjeje dypalëshe në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës.

Në fushën e Qeverisjes së Mirë ka pasur aktivitete të ndryshme të udhëhequra nga Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) si monitorimi dhe raportimi për dokumentet strategjike dhe legjislacion (Raporti i Monitorimit të Strategjisë për bashkëpunim mes Qeverisë dhe Shoqërisë civile; Raporti mbi Zbatimin e Marrëveshjes për Përkrahjen Direkte Buxhetore në kuadër të IPA 2 për indikatorin II “Komunikimi efektiv publik, konsultimi publik dhe pjesëmarrja e palëve të interesuara” për vitin 2019, është hartuar Programi për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës 2019-2021 Hartimi i Udhëzimeve Administrative që burojnë nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës.

Raporti i monitorimit të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të drejtat e fëmijëve për vitin 2019, në të cilin po ashtu është vlerësuar që kjo strategji dhe plan i veprimit ka shënuar një arritje të zbatueshmërisë së aktiviteteve të parapara prej 85%. Konform Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë monitoruar të gjitha institucionet e nivelit qendror mbi zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit duke rritur efikasitetin e respektimit të afateve ligjore në kthim të përgjigjeve, implementimin efektiv të rekomandimeve, rritjen llogaridhënies institucionale, si dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve duke vepruar me përgjegjshmëri ndaj rekomandimeve të adresuara. Gjithashtu Zyra për Qeverisje të Mirë bënë koordinimin e proceseve të ndryshme, hartimin e dokumenteve, themelimin e strukturave dhe aktivitete të tjera në fushën e qeverisjes së mirë si dhe mbrojtjes dhe promovimit të drejtave të njeriut

Aktivitete të ndërlidhura me këto fusha janë gjithashtu : 1. Zhvillimi i programit për trajnim mbi legjislacionin për mbrojtje nga diskriminimi; 2. Zhvillimi i hulumtimit “Promovimi i Diversitetit dhe Barazisë në Kosovë; 3. Zbatimi i projektit Instrumenti horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (2019-2022); 4. Publikimi i hulumtimeve “Perceptimet e shërbyesve civil lidhur me diskriminimin në vendin e punës ose në tregun e punës në Kosovë” dhe “Perceptimet e qytetarëve lidhur me diskriminimin në vendin e punës ose në tregun e punës në Kosovë”. 5. Organizimi i Trajnimeve për Ngritjen e kapaciteteve në nivel lokal për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021 në nivel lokal. 5. Përditësimi i Platformës për Konsultime me publikun; 6. Certifikimi i 11 nëpunësve civil për Trajner për Procesin e konsultimeve me Publikun, certifikimi i 10 nëpunësve civilë për trajnerë për kriteret, standardet dhe procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve si dhe janë ofruar shërbime të interpretëve në gjuhën e shenjave.

Përveç takimeve dhe kontakteve të vazhdueshme me Ministrinë dhe institucionet e linjës, Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA) është angazhuar në raportimin e aksidenteve/incidenteve Aeronautike dhe hekurudhore, si dhe ka vazhduar hetimin e rasteve të hapura të këtij lloji të aksidenteve/ incidenteve.

Sa u përket rasteve të hapura për hetim në këtë fushë KHAIA ka vazhduar të hetoj rastet e shpeshta të Sulmeve nga Zogjtë (Bird Strikes) në Aeroportin Ndërkombëtar Adem Jashari; me menaxhmentin e të cilit janë mbajtur disa takime në lidhje me këtë rast. Hetimet kanë vazhduar poashtu për incidentin hekurudhor të datës 20 Dhjetor 2019 që kishte ndodhur në binarët industrial Bardh – Marevc. Gjatë kësaj periudhe të raportimit është hapur dhe një rast i ri për aksidentin që ka ndodhur në Korishë më datë 19 korrik 2020.

Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore (AKMRRSB) ka arritur miratimin e Rregullores Nr. 08/2020 për “Kufijtë e Dozave dhe Mbrojtje nga Rrezatimi”.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe AKMRRSB ka marrë pjesë në Projektin e Komisionit Evropian për administrimin e programit JRODOS për emergjencat radiologjike, si dhe ka marrë pjesë në telekonferenca për Strategjinë kundër armëve të shkatërrimit në masë.

Po ashtu, është punuar për finalizimin e raportit mbi analizën e perceptimeve të pjesëmarrësve të kursit të gjuhës që është realizuar në fillim të vitit, si dhe është finalizuar drafti i raportit të vetëvlerësimit për themelimin e programit të studimit: Ballkanistika në Fakultetin e Filologjisë. Është nënshkruar marrëveshja dhe ka filluar implementimi i projektit që financohet nga Qeveria e Japonisë nëpërmjet Bankës Botërore “Komunat për të Rinjtë në Kosovë”, i cili ka për qëllim përkrahjen e të rinjve në 10 komuna. Gjithashtu, është finalizuar dizajni i projektit, i cili ka marrë aprovimin e brendshëm nga Banka Botërore për implementimin e projektit “Ndërlidhja e të Rinjve - Përfshirja e të rinjve dhe ndërmarrësia”, që do të mbështesë 38 komuna, në vlerën 20 milionë dollarë.

Janë mbajtur 5 takime virtuale me 38 komunat e Republikës së Kosovës. Po ashtu, është bërë publikimi i analizës për bashkëpunim ndër komunal. Procesi i nënshkrimit të marrëveshjeve të mirëkuptimit ndërmjet komunave, është shtyrë për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia COVID – 19.

2.1. Qasja ndaj reformës institucionale të administratës publike

Reforma institucionale dhe ajo e administratës publike vazhdojnë të kenë rëndësi të veçantë në agjendën e qeverisë. Gjatë kësaj periudhe është përfunduar edhe raporti vjetor i viti 2019 për zbatimin e Strategjisë për rregullim më të mirë si pjesë e Kornizës Strategjike të Reformës së Administratës Publike, ku 63.15% e të gjitha aktiviteteve të parapara janë zbatuar plotësisht, 15.78% janë zbatuar pjesërisht dhe 21.00% e aktiviteteve nuk kanë filluar të zbatohen.

Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave 2017-2021, ashtu siç kërkohet me UA 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike deri më tani është zbatuar nëpërmjet një Plani të Veprimit tre vjeçar që ka mbuluar periudhën 2017-2019.

Pas përfundimit të periudhës zbatuese, në fund të vitit të kaluar (2019), Zyra për Planifikim Strategjik ka ndërmarrë një rishikim të lehtë të Planit të Veprimit, për të identifikuar aktivitetet për periudhën 2020-2022, që do të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike dhe specifike të kësaj strategjie.

Si rezultat i këtij rishikimi, është hartuar Plani i Veprimit 2020-21, i cili është miratuar nga Qeveria e Kosovës më datë 22 korrik 2020.

Në fushën e reformës së administratës publike, Komisioni Evropian ka disbursuar 3.1 milionë euro direkt në buxhetin e Kosovës për arritjet e objektivave të reformave në administratën publike në vitin 2018 në kuadrin e Kontratës Sektoriale për Reformën në Administratën Publike ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Komisionit Evropian.

Në kuadër të zbatimit të pakos ligjore për reformën e administratës publike, janë miratuar 11 akte nënligjore që do të kontribuojnë në zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë në kuadër të Reformës së Administratës Publike.

2.2. Qeverisja lokale

Është miratuar faza e parë e raportit të studimit të fizibilitetit për qeverisje lokale në Kosovë, si dhe janë përcaktuar temat për fazën përfundimtare të studimit. Po ashtu, është hartuar raporti mbi vlerësimin “ex-post” i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, si dhe është hartuar plani gjithëpërfshirës për monitorimin e transparencës komunale.

Në funksion të zhvillimit të sistemit të menaxhimit të performancës komunale, MPL-ja ka ndërmarrë veprime: 1. Me rregulloren e re janë vendosur standardet e reja të matjes dhe vlerësimit të performancës komunale, qartësohen rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha strukturave shtetërore për këtë proces, integrohet skema e grantit të performancës komunale dhe parimet e ndarjes së fondeve në bashkëpunim me donatorë; normohet sistemi elektronik për matjen e performancës, si dhe saktësohet procesi për menaxhimin e cilësisë dhe verifikimit të të dhënave, dhe 2. Implementimin e sistemit të rishikuar për menaxhimin e performancës komunale.

Bazuar në Skemën e Grantit për Performancë të Komunave, 23 komunat me performancën më të mirë, kanë filluar implementimin e 45 projekteve kapitale, në vlerën prej 4.9 milionë eurosh, të cilat janë financuar nga buxheti i MPL-së dhe Qeveria e Zvicrës, Qeveria e Suedisë dhe e Norvegjisë. Nga fondet e MPL-së, nga granti i performancës, nga 19 projektet e financuara në vlerë prej 2,499,771.00€ janë nënshkruar 9 kontrata për implementimin e projekteve në 6 komuna, ndërsa 10 projekte të tjera janë në proces të zhvillimit të procedurave tenderuese. Në pajtim me skemën e re të treguesëve, është zhvilluar procesi i matjes së performancës komunale për vitin 2019. Lidhur me këtë, MPL ka rishikuar rregullat për ndarjen e grantit të performancës për vitin 2020 si dhe janë krijuar trupat përgjegjës për vlerësimin e grantit. Ka filluar procesi i vlerësimit për grant, i cili merr për bazë rezultatet e 30 indikatorëve të dalur nga Raporti i Performancës Komunale për vitin 2019. Granti i performancës ka vlerën prej 5,200,000.00 euro, prej të cilave: MPL 2,500,000 €, SDC 1,250,000 €, SIDA 540,000 €, Ambasada Norvegjeze 910,000€.

2.3. Partneriteti me shoqërinë civile dhe mediat

Është hartuar Raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile për vitin 2019. Po ashtu, është hartuar Plani vjetor për financimin publik të OJQ-ve për vitin 2020.

Qasja në akte juridike është mundësuar nëpërmjet Zyrës për Publikimin e Gazetës Zyrtare, në të cilën, gjatë kësaj periudhe raportuese, janë publikuar gjithsej 1673 akte juridike në gjuhët përkatëse (shqipe, angleze, serbe, turke dhe boshnjake).

Angazhimet e Qeverisë dhe kryeministrit i janë komunikuar publikut me ndihmën e Zyrës për Komunikim me Publikun. Gjatë kësaj periudhe janë përgatitur dhe publikuar 120 komunikata nga aktivitetet e Kryeministrit, 28 komunikata nga mbledhjet e Qeverisë, 20 mesazhe urimi nga personalitete dhe liderë të qeverive të ndryshme nga bota, si dhe 18 të tjera nga aktivitetet e zëvendëskryeministrave. Janë organizuar 11 konferenca dhe paraqitje para mediave për

kryeministrin dhe janë përgatitur dhe publikuar 8 deklarata dhe njoftime të ndryshme, si dhe dy (2) fjalime të kryeministrit nga ngjarje të ndryshme. Janë përgatitur 11 komunikata, si dhe është organizuar mbulimi medial i aktiviteteve të kryeministrit në terren (vizita nëpër komunitet e Kosovës).

Gjithashtu, duke vepruar në kuadër të mandatit dhe detyrave, Zyra për Komunikim Publik ka pranuar dhe ka trajtuar 21 kërkesa për qasje në dokumente publike. Kërkesat janë adresuar në sektorët përkatës dhe janë kthyer 20 përgjigje apo qasje të lejuara në dokumente publike. Aktualisht është një kërkesë në proces të shqyrtimit dhe përgatitjes për lejim të qasjes.

Ndërkohë ka vazhduar mirëmbajtja e ueb-faqes së Zyrës së Kryeministrit në internet duke publikuar në kohë reale të gjitha njoftimet për aktivitetet e Qeverisë, kryeministrit, zëvendëskryeministrave dhe strukturave të tjera, në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht.

Janë realizuar trajnime në 5 komuna, ku pjesëmarrës kanë qenë 80 zyrtarë komunal si dhe janë organizuar 5 takime të tjera virtuale për 38 koordinatorët komunalë për performancë komunale. Janë bërë përgatitjet për fillimin e procesit të vlerësimit të nevojave të trajnimeve, nëpërmjet dizajnit të pyetësorëve vetëvlerësues për zyrtarët komunalë për nevojat e trajnimeve për vitin 2021, si dhe shqyrtimit të obligimeve nga dokumentet strategjike, të cilat duhen adresuar nëpërmjet pushtetit lokal.

Është nënshkruar kontrata për implementimin e projektit (platformës online) "Rrija e kontrollit të brendshëm dhe transparenca buxhetore e shpenzimeve të fondeve publike të MPL-së", në vlerë prej 60 mijë euro bashkëfinancim me Ambasadën Britanike dhe UNDP-në. Deri më tani është arritur të finalizohet moduli i buxhetit, moduli i investimeve kapitale, si dhe në proces të zhvillimit gjendet moduli i përdorimit të veturave, moduli i takimeve dhe moduli i shpenzimeve pa prokurim.

2.4. Promovimi i barazisë shoqërore

Me qëllim të promovimit të barazisë shoqërore është punuar në Raportin për vlerësimin afatmesëm të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit për përfshirjen e komuniteteve romë dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2020, i cili është në fazën finale. ZQM-ja, po ashtu, ka raportuar për të arriturat në këto fusha para Nënkomitetit për drejtësi, liri dhe siguri.

Gjatë kësaj periudhe janë hartuar një numër dokumentesh, duke përfshirë: 1. Draft analizën kombëtare mbi politikën kyçe, që synojnë integrimin e romëve në Kosovë; 2. Programin për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës 2019-2021; 3. Strategjinë dhe Planin e Veprimit për të Drejtat e Njeriut (2020-2024); 4. Planin vjetor për financimin publik të OJQ-ve për vitin 2020; 5. Udhëzimet Administrative që burojnë nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës; dhe 6. Planin e Ri Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2021-2023. Në këtë periudhë është hartuar edhe draft-vendimi për formimin e Grupit Teknik të Punës për mbrojtjen nga diskriminimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Zhvillime ka pasur edhe në mbështetje të komuniteteve, në të cilat rol kyç ka luajtur Zyra për Çështje të Komuniteteve. Kështu, është miratuar "Programi për Komunitete", i cili ka përcaktuar

kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve apo transfereve nga buxheti i ZÇK-së në mbështetje dhe promovim të të gjitha komuniteteve.

Me qëllim të promovimit të komuniteteve dhe të drejtave të tyre është hapur dhe shpallja publike "Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe interesave të komuniteteve". Për implementimin e kësaj shpallje publike janë ndarë 700.000 euro nga buxheti i ZÇK-së, prej të cilave 600.000 euro do të ndahen për financimin e projekteve të organizatave joqeveritare ndërsa 100.000 euro do të ndahen për projektet e mediave të komuniteteve joshumicë. Me anë të këtij programi synohet që të adresohen boshllëqet rreth zbatimit të kornizës ligjore.

Më datë 21. 8. 2020, është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit në mes të Zyrës për Çështje të Komuniteteve, Manastirit të Graçanicës dhe Komunës së Graçanicës për realizimin e projektit "Ndërtimi i një ferme për mbarështimin e deleve" për nevojat e Manastirit të Graçanicës. Ky projekt është pjesë e donacionit të Ambasadës së Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë. Për realizimin e këtij projekti janë ndarë mjetet financiare në vlerë prej 147.965 euro. Gjithashtu, është hartuar raporti i respektimit të drejtave të njeriut në komuna.

2.5. Kthimi dhe riintegrimi i komuniteteve

Ministria për Komunitete dhe Kthim vazhdoi aktivitetet e saj të rregullta në zbatimin e fazës së pestë të programit "Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë (EU RRR-5)", i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian, i bashkëfinancuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, dhe zbatohet nga partneri Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në 11 komuna në Kosovë.

Gjatë periudhës raportuese, janë mbajtur takimet e nevojshme me zyrat komunale për kthim dhe komunitete dhe komisionet kompetente, është marrë dokumentacioni i nevojshëm dhe është vazhduar me sukses ndërtimi i 65 shtëpive të reja për të kthyerit dhe personat e zhvendosur në komunat e Gjakovës, Istog, Kamenicë, Klinë, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Prizren, Rahovec dhe Shtërpcë.

Po ashtu, përfundoi me sukses ndërtimi dhe pranimit teknik i 38 shtëpive të reja. Ndërtimi i 38 shtëpive të reja në vitin 2020 do ta zgjidhë çështjen e strehimit afatgjatë për 38 familje (ashkali 3 familje, boshnjakë 1, egjiptianë 3, romë 4 dhe serbë 27 familje) me gjithsej 214 anëtarë që jetojnë në komunat: Novobërdë, Gjakovë, Pejë, Istog, Shtërpcë, Rahovec dhe Fushë Kosovë. Shumë nga 38 familjet e përmendura, përfshirë fëmijë të vegjël, jetuan në kushte çnjerëzore. Në tremujorin tjetër, ndërtimi i të gjitha 65 shtëpive të aprovuara është planifikuar të përfundojë dhe është planifikuar ndërtimi i shtëpive të reja për të kthyerit, anëtarët e zhvendosur dhe të rrezikuar të komuniteteve jo-shumicë.

Gjatë periudhës së raportimit, MKK-ja ka përfunduar aktivitetet që synojnë sigurimin e një zgjidhje të përhershme strehimi për rreth 91 familje ose 199 banorë të pesë qendrave kolektive në komunën e Shtërpcës. Në tremujorin tjetër, ne presim që banorët e pesë qendrave kolektive nga komuna e Shtërpcës të transferohen në pesë ndërtesa të reja banimi. Në periudhën e ardhshme, MKK-ja pret nënshkrimin e marrëveshjes për mbylljen e të gjitha qendrave kolektive formale dhe joformale në territorin e Komunës së Graçanicës, Leposaviqit dhe Zveçanit.

Paralelisht me ndërtimin e shtëpive, vëmendja e shtuar u përqendrua në fuqizimin ekonomik të anëtarëve të komuniteteve të cënueshme me përzgjedhjen e 103 fondeve stimuluese individuale (grante) për gjenerimin e të ardhurave dhe 16 projekte të komunitetit, zbatimi i të cilave do të fillojë në 30 komuna në tremujorin e ardhshëm. Programi i fuqizimit ekonomik me stimuj individualë për gjenerimin e të ardhurave zbatohet nga MKK-ja me mbështetjen e Zyrës së BE-së në Kosovë.

MKK-ja ka vendosur të shlyejë borxhet e mbetura të qirave dhe shërbimeve për gjithsej 51 familje rome, ashkali dhe egjiptianë që u kthyen në Kosovë nga Maqedonia Veriore dhe Mali i Zi me ndihmën e UNHCR-it. 51 familje u strehuan përkohësisht në komunat e Prizrenit, Ferizajit, Obiliqit, Graçanicës, Dragashit, Pejës dhe Gjilanit. Midis tyre ka fëmijë që jetojnë në kushte çnjerëzore dhe janë të kërcënuar me dëbim.



Ndarja e pakove të harmonizuara të ndihmës me rastin e kthimit të personave të zhvendosur

Paralelisht me ndërtimin e shtëpive, 34 pako familjare të harmonizuara u janë dorëzuar të kthyerve dhe personave të zhvendosur (teknikë e bardhë dhe mobilje), nga të cilat gjithsej kanë përfituar 225 persona.

Vendosja e sistemit të menaxhimit të informacioneve për personat e zhvendosur

Ka filluar procedura e prokurimit publik për zhvillimin e një baze të të dhënave gjithëpërfshirëse për personat e zhvendosur.

„Procesi i Shkupit“

Si pjesë e Procesit të Shkupit, si një iniciativë rajonale për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur dhe kthimin e personave të zhvendosur, u organizuan video-konferenca me delegacione nga Beogradi, Shkupi dhe Podgorica, me partnerë nga OSBE-ja, UNHCR-i dhe shoqatat e personave të zhvendosur. Në bazë të angazhimeve të deritanishme për zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur është arritur të definohen poashtu edhe veprimet e nevojshme të Qeverisë për periudhën në vazhdim-, si në:

- *sigurinë e të kthyerve dhe pronën e tyre që ishte veçanërisht e ndjeshme gjatë masave të mbrojtjes së pandemisë;*
- *planin për zbatimin e aktiviteteve për zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur dhe të kthyerit;*
- *mundësimin e kthimit për të gjithë personat e zhvendosur që kanë shprehur gatishmërinë për t'u kthyer në Kosovë (6000 persona sipas UNHCR-it);*

- *përmirësimin e dialogut ndërmjet komuniteteve në fushat ku kthimi po vazhdon ose është në fazën e planifikimit;*
- *aplikimi i praktikave të mira nga programet rajonale të kthimit me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, mbi të gjitha të Bashkimit Evropian.*

Të pagjeturit dhe viktimat e dhunës seksuale të luftës

Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur raporton që gjatë kësaj periudhe janë kthyer mbetjet mortore për rivarrim të një personi të zhdukur e të identifikuar, ndërsa gjatë gërmimeve në tri lokacione të ndryshme janë gjetur dhe eshtrat e së paku dy personave, viktimat të luftës, përderisa gërmime të tilla në territorin e Serbisë nuk janë iniciuar përkundër kërkesave të vazhdueshme.

Është mbajtur dhe një takim mes Komisionit Qeveritar të Republikës së Kosovës për Persona të Zhdukur dhe Komisionit të Serbisë për Persona të Zhdukur, e gjithë kjo në kuadër të Planit Kornizë Rajonal, me qëllim të diskutimit të mundësisë së inicimit dhe pjesëmarrjes në gërmimet në lokacionet me interes të përbashkët. Në këtë takim janë diskutuar dhe rastet e paidentifikuara dhe çështja e bazës së të dhënave rajonale.

Edhe në këtë vit, në bashkëpunim me shoqatat e familjeve të personave të zhdukur, është shënuar 30 Gushti – Dita Ndërkombëtare për Persona të Zhdukur, me një sërë aktivitete, në përkujtim dhe nderim të të gjithë personave të zhdukur dhe dhimbjes së familjarëve, si dhe me qëllim të informimit të drejtë dhe sensibilizimit të opinionit vendas dhe ndërkombëtar për gjendjen aktuale të procesit të ndriçimit të fatit të personave të zhdukur.

2.6. Fuqizimi i pozitës së grave dhe vajzave në shoqëri

Me qëllim të avancimit të objektivit të Avancimit të realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi, garantues të arritjes së barazisë gjinore është financuar punëtorja dy ditore për Komisionin për Verifikimin e statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në vlerë prej 1,891.54 euro. Po ashtu, gjatë muajit korrik, ABGJ ka realizuar takim koordinues me përfaqësues nga strehimoret e Kosovës, ku dhe janë adresuar kërkesat e këtyre të fundit. Tutje, ABGJ ka udhëhequr takimin me Grupin për Siguri si dhe ka publikuar dhe prezantuar raportin: “Ndihma Zyrtare për Zhvillim për barazi gjinore – gjendja e përafrimit me prioritetet e Qeverisë së Kosovës 2015-2018” në takimin Teknik Koordinues me shtetet anëtare të BE-së dhe donatorët. Është realizuar hulumtimi për “Hendekun gjinorë në paga” sipas Ligjit për Barazi Gjinore dhe është formuar grupi punues për hartimin e “Koncept Dokumentit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje”. ABGJ ka aplikuar për zgjatjen e mbështetjes së SIDA, e cila e ka mbështetur ABGJ-në për 4 vite, që të vazhdojë dhe për 4 vite tjera si dhe ka aplikuar për përfitimin e mbështetjes për financim të programit IPA III me projektin “Mbështetje për Fuqizimin Ekonomik dhe Punësimin e Grave në Kosovë”.

Po ashtu është promovuar masa afirmative - Udhëzimi administrativ për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve pa pagesë me qëllim të promovimit të regjistrimit të pronës së përbashkët të të dy bashkëshortëve nëpërmjet një videospoti televiziv. Për më tutje, ABGJ ka mbajtur takime me drejtorët e departamenteve të Mirëqenies Sociale në disa

Komuna të Republikës së Kosovës me qëllim të përkujdesjes dhe shqyrtimit të aplikimeve për banim social nga të mbijetuarit/at e dhunës seksuale gjatë luftës. **Është përmbyllur raundi i selektimit të OJQ -ve e cilat punojnë në fushën e barazisë gjinore dhe fuqizimit ekonomik te grave & parandalim te dhunës ne familje te cilat kane aplikuar nëpërmjet thirrjes se hapur për subvencionim nga ABGJ online. Janë përzgjedhur 6 OJQ për mbështetje nëpërmjet subvencionimit –janë nënshkruar marrëveshjet e financimit bazuar në ligjin për menaxhimin e financave publike dhe rregulloren për subvencionim,** si dhe është shpallur raundi i ftesës për subvencione për persona fizik –fusha e barazisë gjinore –fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave.

Me qëllim të integritimit të parimeve të LGJB në aktet normative të Republikës së Kosovës janë ofruar komente në 20 draft akte normative dhe 1 draft politik publik.

3. Zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm

Në kuadër të zhvillimit ekonomik, Qeveria e Republikës së Kosovës duke u bazuar në programin e Qeverisë dhe situatës aktuale gjatë periudhës 100 ditore ka ndërmarrë një sërë veprimesh në fusha të ndryshme duke zbatuar legjislacionin në fuqi.

3.1. Menaxhimi i financave publike

Qeveria e përfshirë nga të gjitha institucionet respektivisht në obligim të Ministrisë së Financave në afat rekord ka rishikuar buxhetin e vitit 2020, duke konsultuar pothuajse secilën organizatë buxhetore. Pas aprovimit të rishikimit të Ligjit të Buxhetit, Ministria e Financave është angazhuar në ekzekutimin e masave të pakos së mëhershme dhe ka ndihmuar ministritë e linjës në përgatitjen për implementim të një sërë masash të programit për rimëkëmbje ekonomike.

Gjatë kësaj periudhe 100 ditore janë arritur një sërë marrëveshjeve me Institucionet Ndërkombëtare Financiare me qëllim të financimit të deficitit buxhetor. Qeveria respektivisht Ministria e Financave është angazhuar në përmbushjen e mandatit për ruajtjen e qëndrueshmërisë makro-fiskale në përputhje me nevojat për zhvillimin e vendit.

Sa i përket harmonizimit të Legjislacionit në fushën e Financave Publike në harmoni me obligimet e dala në MSA (Acquis) dhe standardet ndërkombëtare:

- *Janë hartuar projektligjet, të cilat brenda periudhës raportuese janë aprovuar në Qeveri. Nga gjithsej 28 të projektligje të parapara në strategjinë legjislative sipas afateve të dërgimit në Qeveri, deri më tani janë aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës 10 projektligje.*
- *Është fuqizuar koordinimi ndërinstitucional mes Departamentit të Ndhmës Shtetërore dhe Komisionit për Ndhmë Shtetërore në harmoni me legjislacionin e BE-së, duke përfunduar vlerësimin e 6 skemave të njoftuara të ndihmës shtetërore dhe krijimi i regjistrit të ndihmave të përgjithshme dhe regjistri i ndihmave de-minimis.*
- *Është përgatitur korniza makro-fiskale për Rishikimin e Buxhetit 2020, ku janë paraqitur të dhënat dhe parashikimet më të fundit. Gjatë kësaj periudhe është punuar në azhurnimin e kornizës makro-fiskale për Rishikimin e Kornizës Afat-Mesme të Shpenzimeve dhe në përgatitjen e draftit të parë të Programit për Reforma në Ekonomi 2021-2023.*

Gjatë periudhës raportuese, Dogana e Kosovës (DK) ka qenë aktive me pjesëmarrje në aktivitete të Organizatës Botërore të Doganave (OBD) duke thelluar tutje integrimin e plotë në proceset e rregullta të OBD-së. Në kuadër të marrëveshjeve bilaterale doganore me shtetet tjera, janë shkëmbyer informata që ndërlidhen me parandalimin dhe luftimin e kontrabandës, shpëlarjes

së parasë dhe evazionit fiskal, si dhe janë shkëmbyer praktikat e organizimit të proceseve biznesore në periudhë të pandemisë, me qëllim të kryerjes me sukses të të gjitha procedurave doganore. Bashkëpunimi me vendet CEFTA ka vazhduar. Sa i përket akcizës, janë inkasuar 28 milionë në duhan dhe 3,6 milion nga pijet. Rivlerësimet e mallit doganor kapin shumën 200 mijë euro. Antikontrabanda ka zbuluar raste me vlerë mbi 176 mijë euro. Kundërvajtjet që janë trajtuar janë 186.

Në fushën e tatimeve, gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjithsej 4,887 vizita nga të cilat ka rezultuar qarkullim shtesë në shumën prej 38.6 milionë euro. Gjithashtu janë përfunduar 197 kontrolle tatimore me total tatim shtesë 5.4 milionë euro. Shuma e rimbursimeve të aprovuara për të gjitha llojet e tatimit ishte mbi 10 milionë euro. Të hyrat tatimore tejkaluan 100 milion euro, apo 12.1% më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 ku të hyrat tatimore ishin 114 milion euro. Borxhet tatimore të inkasuara për periudhën e njëjtë ishin 16,6 milion euro ose 18.4% më pak kur e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2019, ku inkasimi i borxheve ishte 20,3 milion euro. Sikurse edhe me indikatorët tjerë në këtë periudhë, ka numër më të vogël të kërkesave për rimbursim për 275 kërkesa apo 42.11%. Po ashtu, edhe numri i aprovimeve është më i vogël për 20.82%.

| | 03.06-21.08/2020 | | 03.06-21.08/2019 | | dallimi në përqindje |
|----------------------|------------------|-----------------|------------------|-----------------|----------------------|
| | Numri | Vlera | Numri | Vlera | |
| Kërkesa rimbursimi | 378 | 8.568.466,66 € | 653 | 16.583.941,51 € | -42.11% |
| Kërkesa të aprovuara | 460 | 10.220.354.69 € | 581 | 16.839.795,38 € | -20.82% |

Qeveria përmes Thesarit ka realizuar financimin e deficitit sipas planit vjetor duke siguruar qëndrueshmëri në likuiditet me rreth 90 milion euro financim dhe me servisim të rregullt të borxhit me rreth 60 milion euro. Përveç raporteve të rregullta për ekzekutimin e Buxhetit të vitit 2020, është përmirësuar transparenca e financave publike duke pasuruar më tutje komunikimin me publikun për zbatimin e masave të Qeverisë. Rreth gjysmë milioni banorë kanë përfituar direkt nga transferet e realizuara nga Thesari, ku janë shpërndarë rreth 122,8 milion euro. Është duke vazhduar thjeshtimi i procedurave doganore duke krijuar module të reja softuerike për të përshpejtuar procedurën e eksportit në më pak se një orë për 93% të rasteve.

Janë iniciuar tri Marrëveshje Granti dhe një për Eliminim të Tatimit të Dyfishtë (METD) ku bëjnë pjesë: 1. Marrëveshja e Amandamentimit për Bashkëpunim me Qeverinë Zvicerane për Fazën Dalëse VI të Programit Mbështetës për Ujëra dhe Kanalizim në Zonat Rurale; 2. Marrëveshja e Grantit me BERZH për Rrugët Rajonale - Mbështetje për Njësinë Zbatuese të Projektit; 3. Marrëveshja e Grantit me BERZH për Rrugën Kijevë – Zahaq: Financimi i rrugës dhe studimi institucional; dhe 4. Marrëveshja për Amandamentimin e METD me Shqipërinë e cila është nënshkruar në Janar të vitit 2015 ndërsa janë në fazën finale dhe pritet të nënshkruhen së shpejti katër Marrëveshje për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë me Lituaninë, Letoninë, Portugalinë dhe Italinë.

Qeveria e Kosovës ka marrë përsipër mbulimin e plotë të primit të sigurimit kufitar për bashkatdhetarët dhe palët që janë subjekt i policës kufitare dhe vijnë në Kosovë gjatë vitit 2020 përmes marrëveshjes me BQK dhe BKS,

Për periudhën 100 ditore janë ekzekutuar pagesat e pakos emergjente në vlerë prej 17,605,489 euro me gjithsej 221,759 përfitues.

Janë realizuar tri ankande për letrat me vlerë dhe emetuar letra me vlerë për financimin e buxhetit në vlerë prej 65 milionë euro (duke përfshirë ri-financimin 30 milionë euro).



-Si rezultat i Strategjisë së Reformave të Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP), gjatë muajit Korrik 2020, Komisioni Evropian ka njoftuar se MF ka përfituar Mbështetjen Buxhetore Sektoriale në MFP. Në Korrik 2020 nga BE janë disbursuar në Thesarin e Kosovës në emër të progresit në zbatimin e Indikatorëve Variabil në MFP gjithsej 6,875,000.00 Euro. Gjithashtu është finalizuar Marrëveshja për Mbështetjen Buxhetore Sektoriale (SBS) nga fondet IPA 2019 – “EU4 Resilience – Kosovo”, për lehtësimin e pasojave të pandemisë së COVID-19. Marrëveshja kap shumën prej 26.5 milionë euro, ku shumica e këtyre mjeteve do të disbursohen në buxhet gjatë vitit 2020 (20.5 milion euro) si transhe fikse, ndërsa mjetet e tjera në 2021 (6 milionë euro), si transhe variabile. Marrëveshja është nënshkruar nga BE, së shpejti pritet aprovimi edhe nga ana e Kosovës.

Sa i përket ngritjes së efikasitetit operacional në menaxhimin e parasë publike, në harmoni me rregullat dhe standardet në fuqi, janë nënshkruar tetë kontrata nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, një marrëveshje kornizë me dhjetë operator ekonomik dhe janë publikuar tri njoftime paraprake.

Agjencia e Statistikave të Kosovës gjatë kësaj periudhe ka realizuar gjithsej 32 publikime sipas statistikave sektoriale, përfshirë 9 në sektorin social, Anketën e Fuqisë Punëtore, 16 nga statistikat ekonomike dhe të çmimeve, 3 nga statistikat e llogarive kombëtare, dhe 3 nga fusha bujqësisë dhe ambientit. Është publikuar edhe vjetari statistikor, dhe është dërguar në Qeveri Koncept Dokumenti për Regjistrimin e Popullsisë 2021, pas aprovimit të së cilit formohet grupi punues për hartim të Ligjit mbi Regjistrimin e Popullsisë 2021.

3.2. Zhvillimi rajonal

Sa u përket investimeve të nivelit qendror sipas rajoneve zhvillimore është funksionalizuar mekanizmi lidhur me mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në dy (2) kategori: investime kapitale dhe subvencione dhe grante për biznese, dhe si rezultat i kësaj janë hartuar dhe



Ministri Kervan dhe kryetari komunës së Rahovecit z.Smajl Latifi inauguruan fillimet e punimeve të këtij projekti të financuara nga MZHR (në vlerë prej 30.000 euro) dhe të bashkë - financuara nga Komuna e Rahovecit. Të njëjtit, e vlerësuan këtë projekt si të qëlluar për plotësimin e nevojave të qytetarëve të këtyre lokaliteteve, si dhe bënë thirrje ndaj implementimeve dhe organeve mbikëqyrëse, që punimet të realizohen në përpikëri sipas obligimeve të parapara, pa vonesa dhe me fikasitet të plotë.

aprovuar dy analiza: Analiza për investime kapitale në rajonet zhvillimore për vitin 2019 dhe analiza për zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar/përkrahja e sektorit privat me grante dhe subvencione.

Ministria e Zhvillimit Rajonal në muajin gusht në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2020 ka përkrahur 154 biznese mikro dhe të vogla me pajisje/makineri në vlerë prej rreth 2 mil. € për stimulim të punësimit dhe avancim të bizneseve ku parashihen të krijohen rreth 600 vende të reja të punës në v.2020.

MZHR në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal 2020 (investime kapitale) është në proces të implementimit të 30 projekteve me 26 komuna në vlerë prej 2.5 mil € me qëllim të avancimit të infrastrukturës publike për zhvillim të qëndrueshëm.

Është organizuar tryeza për Ditën Botërore të Akreditimit me temën “Akreditimi: Përmirësimi i Sigurisë Ushqimore.

3.3. Industria dhe mbështetja për sektorin privat

Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS), nëpërmjet komiteteve teknike ka trajtuar standardet për sektorët si në vijim: KT për Mjedis; KT për Energji; KT për Ndërtim; KT për Makineri; KT për Metrologji; KT për Shëndetësi; KT për Elektroteknikë; KT për Përpunim të Drurit; KT për Miniera dhe Minerale; KT për Derivate të Naftës dhe Gazit; KT për Tekstil dhe Lëkurë Këpucë; KT për Transport dhe Shërbime Postare. Janë proceduar 288 standarde evropiane (EN) dhe ndërkombëtare (ISO/IEC) si standarde kosovare (SK).

Nga komitetet e DAK, janë realizuar katër (4) vizita vlerësuese për akreditim për herë të parë të Trupave të Vlerësimit të Konfromitetit. Ndërsa janë realizuar nëntë (9) vizita mbikëqyrëse të Trupave të Akredituara të Vlerësimit të Konfromitetit.

Sa i përket fushës për mbrojtjen e konsumatorit gjatë kësaj periudhe janë pranuar 234 ankesa të konsumatorëve, të cilat tërësisht janë trajtuar, ndërsa janë zgjidhur 102 ankesa.

Në aspektin e Avancimit të Politikave Industriale në Kosovë, është përditësuar databaza IPIS me të dhënat e përpunuara nga ASK, BQK, ATK, Dogana e Kosovës dhe ARBK-së për vitin 2019, si dhe është punuar në hartimin e strukturës së raportit për vitin 2020. Është bërë përditësimi i databazës së industrisë me raporte studimore, raporte të monitorimit të projekteve, legjislacion,

analiza. Është finalizuar raporti për industrinë përpunuese “Ndikimi i pandemisë në Sektorin C dhe propozimi i masave”, për periudhën katër mujore, Janar – Prill 2019/2020, i njëjti i publikuar në ueb faqe të MTI-së.

Gjatë kësaj periudhe Qeveria e Kosovës i ka kushtuar një rëndësi edhe Mbështetjes së bizneseve dhe mjedisit të të bërit biznes. Është shpallur thirrje për përkrahje financiare të NVM-ve, për blerjen e makinerive prodhuese, ku kanë aplikuar mbi 350 kompani dhe ka përfunduar vlerësimi ku janë përzgjedhur 24 kompani kosovare, është nënshkruar marrëveshje me ADA-në austriake, ku parashihet mbështetja financiare për NVM në sektorin e digjitalizimit, është shpallur thirrja publike ku kanë aplikuar mbi 200 kompani dhe janë përzgjedhur 18 biznese përfituese, është themeluar komisioni ndërministror për investime strategjike. Janë formuar tri grupe operationale për vlerësim të tri subjekteve aplikuese për marrjen e statusit të investitorit strategjik, ku njëri ka kaluar në grup operacional dhe ka marrur vendimi nga komisioni ndër ministror dhe është përgatitur për Qeveri, derisa dy të tjera janë në fazën e vlerësimit nga grupet operationale. Janë duke u bërë investime në katër zona ekonomike (Suharekë, Vushtrri, Lipjan dhe Viti) ku planifikohen të përgatiten rreth 50 hapësira (parcela) për vendosje të bizneseve të huaja dhe vendore. Është hartuar draft thirrja publike për përkrahjen e bizneseve me pronësi të grave (gjinisë femërore) dhe se shpejti planifikohet të publikohet. Është miratuar Udhëzimi Administrativ për ruajtjen dhe shfrytëzimin e materialit arkivor në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve dhe Udhëzimi Administrativ për mënyrën dhe procedurën e regjistrimit dhe ndryshimit të dhënave të shoqërive tregtare në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë

Gjatë kësaj periudhe 100 ditore, në ARBK janë regjistruar 1941 biznese të reja, nga këto me pronarë të huaj janë 109, ndërsa janë shuar 232 biznese; është miratuar Udhëzimi Administrativ për procedurën e regjistrimit të emrit zyrtar dhe emrit tregtar të shoqërive tregtare. Më 2. 9. 2020, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit në mes Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve Kosovare të Republikës së Kosovës dhe Agjencisë për Regjistrat Ligjor, Publik dhe Shërbimet Përkatese të Republikës së Sllovenisë. Ky memorandum ka për qëllim bashkëpunimin në fushën e regjistrimit, ndryshimit dhe shuarjes së bizneseve duke konsistuar në fushën e teknologjisë më të re dhe më të avancuar për regjistrimin e bizneseve.

Janë aprovuar 125 licenca për subjektet afariste për tregti me pakicë me naftë dhe derivate të naftës dhe janë refuzuar 6 kërkesa për licencim.

Në fushën e importit dhe eksportit janë miratuar dhe lëshuar 14 licenca, 12 nga to licenca individuale importi dhe 2 licenca individuale re-eksporti te kategoria e mallrave me përdorim të dyfishtë konkretisht kategoria 5, dhe kategoria 2. Po ashtu, janë regjistruar në regjistër dhe pajisur me certifikata 3 kompani të reja që hyjnë në kategorinë e mallrave me përdorim të dyfishtë, pastaj janë realizuar 3 inspektime në teren tek kompanitë të cilat e kanë realizuar importin e mallrave komfor përshkrimeve në licenca.

Qeveria/MTI ka aprovuar në parim nismën për miratimin e “Protokollit numër 7 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për brenda CEFTA-së” dhe është caktuar ekipi negociues.

3.4. Politikat tregtare

Lidhur me politikat tregtare është themeluar Komiteti Nacional për Tregtinë në Shërbime, pastaj është publikuar për herë të parë vendimi për përfshirjen e Kosovës në listën e vendeve të treta me të drejtë eksporti për produktet ushqimore me origjinë shtazore në vendet e Bashkimit Evropian, është formuar grupi punues për trajtimin e kërkesa të bizneseve/shoqatave dhe pengesave biznese të krijuara nga pandemia COVID-19 si dhe është miratuar Rregullorja e punës për komisionin e ekspertëve për produktet bujqësore dhe artikujt ushqimorë.

Në kuadër të Pronësisë Industriale, në zbatim të legjislacionit gjatë kësaj periudhe janë pranuar:

- *328 aplikime për marka tregtare*
- *7 aplikime për patenta*
- *1 aplikim për dizajn industrial*

Ndërsa janë lëshuar:

- *90 vendime për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale*
- *592 ftesa për pagesën e regjistrimit*
- *334 ekzaminime absolute*
- *1,386 komunikime me palët, që përfshinë lëshimin e dokumenteve zyrtare*

Gjithashtu, janë publikuar 4 Buletine Zyrtare, të cilat përmbajnë të dhëna për 2,721 objekte të pronësisë industriale.

3.5. Turizmi

Sa i përket fushës së Turizmit, Qeveria ka hapur sezonin turistik veror Kosovë-Shqipëri, ndërsa në nëntor do të hapet sezoni vjeshtor në Kosovë. Qeveria ka marrë një sërë veprimesh, si: është themeluar grupi punues për bashkëpunimin në fushën e turizmit mes Kosovës dhe Shqipërisë, i cili ka për qëllim stimulimin e krijimit të ofertës së përbashkët turistike mes Kosovës dhe Shqipërisë si dhe janë prezantuar mundësitë për investime në fushën e turizmit në Kosovë në konferencën “Partneritet & Mundësi - Forcimi i partneritetit publik-privat midis Kosovës dhe Italisë veri-lindore përtej COVID-19”, organizuar nga Ambasada e Italisë në Prishtinë dhe Agjencia ICE, së bashku me Unioncamere Veneto - CCIAA Dhoma e Tregtisë Treviso – Belluno | Dolomiti.

Gjithashtu, është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në mes MTI-së dhe Unionit të Turizmit të Kosovës (UTK), e cila ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit në përmirësimin e gjendjes në sektorin e Turizmit në Republikën e Kosovës. Departamenti i Turizmit ka zhvilluar një ueb portal për turizmin e Kosovës, i cili pritet të publikohet shumë shpejt. Sa i takon parandalimit dhe luftimit të pandemisë COVID 19, MTI-ja ka lëshuar një urdhëresë për operatorët ekonomikë në sektorin e gastronomisë për aplikimin e masave higjienike dhe parandaluese.

3.6. Energjia

Qeveria një rëndësi të veçantë i ka kushtuar edhe sektorit të energjisë, ku është nënshkruar kontrata për vazhdimin e deponimit të produkteve agroushqimore për periudhën gjashtëmujore, si dhe për shërbimet e deponimit të ujit.

- Kanë filluar përgatitjet për rishikimin e Strategjisë së Energjisë. Është themeluar Ekipi Punues për rishikimin e këtij dokumenti. Po ashtu kanë vazhduar aktivitetet për hartimin e Planit të integruar për energji dhe klimë në bazë të rekomandimeve të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.
- Pas aprovimit të granit nëpërmjet platformës WBIF në vlerën prej 0.65 mil. euro është angazhuar konsulenca për hartimin e termave të referencës për realizimin e Studimit të përbashkët të fizibilitetit për gazsjellësin Maqedoni-Kosovë, një draft i termave të referencës është përgatitur nga konsulenca e angazhuar nëpërmjet platformës WBIF e të cilat ju kanë nënshtruar konsultimi me palët e interesit për komente dhe plotësime eventuale të tyre. Po ashtu, në kuadër të parapërgatitjeve të nevojshme për përgatitjen e Master Planit për shpërndarjen e gazit natyror në Kosovë (Studim), aktivitet që gjendet në fazën e përzgjedhjes së konsulencës nëpërmjet platformës WBIF rreth përgatitjes së termave të referencës dhe realizohet në vijimësi sipas kërkesave që adresohen prej tyre.
- Është nënshkruar kontrata me mes të KFW-së dhe GOPA infra & Albarchitect për Auditim energjetik, hartim dhe dizajnin të 15 ndërtesave (shkolla) proceduarat tenderuese parashihet të zhvillohen në tetor 2020 për zbatimin e masave të EE në 15 shkolla për komunat: Prishtinë, Gjilan, Ferizaj dhe Gjakovë projekti si total do të ketë vlerën 7.5 mil. euro.
- Është funksionalizuar Platforma për Monitorim dhe Verifikim (MVP) për fushën e EE, dhe janë mbajtur trajnime për 38 Komuna.
- Me hartimin e Planit Kombëtar për Eficiencë të Energjisë, ky dokument ka kaluar të gjitha proceduarat administrative dhe është në pritje të miratohet nga Qeveria.
- Është funksionalizuar Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë me nënshkrimin e dy marrëveshjeve në mes të AKEE-së dhe FKEE-së. Këto marrëveshje si pako kanë siguruar edhe 9.6 milionë. euro grant nga BE-ja, 5 milionë nga BB dhe 2 mil. euro nga Qeveria dhe tani FKEE-ja në dispozicion ka 17 milionë euro. Komunat do të përfitojnë për zbatimin e masave të EE-së në ndërtesat për Shëndetësi dhe Arsim.
- Me riaktivizimin e projektit të MCC janë përzgjedhur 900 shtëpi për fazën e parë, tani do të fillojë publikimi i tenderit dhe do të përfitojnë 2500 shtëpi dhe 25 ndërtesa shumëkatëshe (amvisëria) në zbatimin e masave të EE-së.
- Zbatimi i masave të Eficiencës së Energjisë në objektet publike - po vazhdojnë aktivitetet dhe janë duke u zbatuar masat e eficiencës së energjisë në 27 objekte shkollore në vlerë të kontraktuar rreth 1,670.167 euro nga BRK.

- Hartimi dhe kompletimi i kornizës nënligjore për Eficiencë të Energjisë (aktet nënligjore që rrjedhin nga Ligji Nr. 06/L-079 për EE):

1. *Rregullore (MEPTINIS) me Nr.05/2020 për Sistemin e Ofruesve të shërbimit energjetik dhe kriteret minimale për Auditimin Energjetik. Miratuar me 09.06.2020.*
 2. *Udhëzim administrativ (MEA) nr.04/2020 për potencialin e eficiencës së energjisë në ngrohje dhe ftohje. Miratuar me 14.08.2020.*
 3. *Udhëzim administrativ (MEA) nr. 03/2020 lidhur me kërkesat për eficiencën e energjisë për blerjen e produkteve shërbimeve dhe ndërtesave nga institucionet e nivelit qendror. Miratuar me 11.08.2020.*
- *Është nënshkruar marrëveshja në mes të AKEE-së dhe FKEE-së, e cila ka për qëllim administrimin e 5 milionë eurove nga FKEE-ja, në zbatim të Planeve të Veprimit Komunal për EE.*
 - *Është miratuar Planit vjetor për Menaxhimin e Resurseve Minerale, në kuadër të monitorimit të Progresit të Programit të Zbatimit të Strategjisë Minerare 2018-2020 për vitin 2020.*
 - *Është miratuar Udhëzimi Administrativ për Pullë Postare.*

Janë përgatitur kriteret për financim të projekteve nga Programi për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndërkomunal, si dhe është bërë lasimi i fondit për financim të projekteve në vlerë prej 573,347.00€. Bazuar në vendimin e Qeverisë për aprovimin e planit për zbatimin e programit të Rimëkëmbjes Ekonomike “Mbështetje për komunat e Kosovës për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia në vlerë prej 10,000,000.00 €” MPL ka përgatit kriteret për mbështetje financiare për komunat e Kosovës për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

- Në bashkëpunim me Zyrën e BE-së në Kosovë, MPL ka përgatit listën me 97 projekt-propozimeve lidhur me identifikimin e nevojave për mundësit e përkrahjes së komunave në përmirësimin e infrastrukturës komunale për “Qasjen për personat me aftësi të kufizuara dhe lëvizje të zvogëluar në objektet publike në nivelin lokal”. Gjithashtu, me kërkesë të ZKM-së janë përgatitur propozimet për projeksionet për investime në projekte infrastrukturore në nivelin lokal për periudhen 5 vjeçare 2021-2025 në vlerë 58,388,098.23€.

Ankandi për Energji të Ripërtërishme

Tregu i energjisë së ripërtërishme është karakterizuar nga jo-transparenca dhe konkurrenca joluajale si pasojë e procedurave të licencimit të kapaciteteve me procedura tashmë jo praktike për botën. Kjo ka shkakuar që të licencohen kompani që nuk i kanë pas kapacitetet e duhura ndërtuese dhe si pasojë këto kapacitete kanë qenë të bllokuara për një kohë të gjatë nga shfrytëzuesit e licencuar.

Duke pasur parasysh këtë problem dhe bazuar, gjithashtu, në nevojat e Kosovës për kapacitete të reja energjetike, kemi marrë vendim për rritje të prodhimit të energjisë elektrike të

ripërtërishme nga 25% në 35% të konsumit total. Ky vendim i mundëson Kosovës që të jetë më e pavarur në furnizim me energji pasi që ndërtimi i kapaciteteve termoenergjetike duke u bazuar kërkesat e BE-së dhe rrethanat e krijuara duhet të rishikohet.

Për të siguruar që ndërtimi i kapaciteteve të reja do të shkoj në dinamikën e planifikuar dhe ato do të hyjnë në funksion sa më shpejt, atëherë është më së e domosdoshme që të hartohen dhe vendosen procedura të cilat e mundësojnë një treg konkurrues, pasi që procedurat e deritashme kanë qenë sipas rregullit “Kush vjen i pari, shërbehet i pari”.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ka zhvilluar takime pune me agjensionet ndërkombëtare të cilat kanë përvoja në tregun e energjisë së ripërtërishme dhe mund të asistojnë në hartimin e procedurave të ankandit për energji të ripërtërishme. BERZH ka përkrahur autoritetet kosovare në zhvillimin e BRE-ve që nga viti 2016, ose me saktësisht që nga prezantimi i skemës mbështetëse dhe mekanizmit të tarifës nxitëse. Në këtë drejtim, të gjitha institucionet ndërkombëtare financiare që veprojnë në Kosovë kishin shqetësimet e tyre në lidhje me marrëveshjen për blerjen e BRE-ve sepse ajo nuk mund të konsiderohet e bankueshme.

Në vazhdim, tarifa nxitëse si skema kryesore mbështetëse e BRE-ve, mund të themi se i arriti qëllimet e veta në një masë të konsiderueshme dhe si rezultat priten të realizohen rreth 250MW BRE deri në fund të vitit 2021. Megjithatë, për zhvillim të mëtutjeshëm të BRE-ve autoritetet kosovare rekomandohet që të kalojnë në modelin e ankandit i cili njëkohësisht paraqet edhe mënyrën më transparente të alokimit të licencave dhe mund të sigurojnë çmimin më të ulët të mundshëm të energjisë për qytetarin.

Në këtë drejtim ekipi i BERZH-it ka pasur dialog të vazhdueshëm me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit. BERZH ka siguruar fondet për asistencën teknike dhe ka përzgjedhur kompaninë konsulente e cila do të kryej punën në bashkëpunim me autoritetet përkatëse si Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, ZRRE dhe KOSTT. Vlen të theksohet se si konsulent është përzgjedhur e njëjta kompani e cila ka zbatuar ankandin e lartpërmendur në Shqipëri. Në përmbledhje, konsulenti do të rishikojë legjislacionin përkatës dhe do të përgatisë të gjitha procedurat e nevojshme për organizmin e ankandit

3.7. Sektori i Teknologjisë Informative dhe Komunikuese (TIK)

Sa i përket krijimit të Qendrës për Ekselencë Dixhitale në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit (ITP) në Prizren, pas nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik (OE) për zbatimin e projektit për krijimin e QED në ITP në Prizren, OE ka realizuar në fund të qershorit dhe në fillim të korrikut dy fazat e para të liferimit të pajisjeve (2 x 3D Printerë dhe 1 x 3D Skaner dhe 2 x softuerëve përkatës).

Gjatë kësaj periudhe janë publikuar tri thirrje për aplikim sipas skemës së granteve për Financimin e Infrastrukturës Dixhitale. Deri më tani janë nënshkruar 16 Marrëveshje për Grante ku nga këto Thirrje do të mbulohen 47 fshatra me infrastrukturë fikse brezgjere dhe po ashtu do të lidhen institucionet publike (shkollat, ambulancat) në këto zona me internet falas për së paku 5 vjet.

Në fushën e ndërmarrësisë dhe inovacionit ka përfunduar pjesa e tretë e projektit “Renovimi i Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësi në UP”.

3.8. Menaxhimi i ndërmarrjeve publike

Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë veprime për përmirësimin e mbikëqyrjes së ushtrimit të së drejtës së Aksionarit në Ndërmarrjet Publike Qendrore, konkretisht nëpërmjet shkarkimeve dhe emërimeve të Bordeve të përkohshme të drejtorëve, si në vijim:

- *NP Hidroregjioni Jugor sh.a.;*
- *KRU Prishtina sh.a.;*
- *NPH Ibërlepenci sh.a.;*
- *NP KEK sh.a.;*
- *Emërimi i Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve në NP “Telekomi i Kosovës”sh.a., pas dorëheqjes së Bordit të Përkohshëm të mëparshëm).*

Gjithashtu me iniciativë të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka hapur konkurset për përzgjedhje të Bordeve të Përhershme, në 10 Ndërmarrjet Publike ku janë të emëruara Bordet e përkohshme të Drejtorëve. Ky proces zhvillohet nga Zyra e Kryeministrit, konkretisht nga Komisioni Rekomandues i emëruar nga Sekretari i Përhershëm i ZKM për Ndërmarrjet Publike Qendrore si më poshtë:

1. *NP “Telekomi i Kosovës” sh.a.;*
2. *NP “Posta e Kosovës” sh.a.;*
3. *NP “Trepça” sh.a.;*
4. *NP “KEK” sh.a.;*
5. *NPH “Ibër Lepenc” sh.a.;*
6. *NP “Infrakos” sh.a.;*
7. *NP “Hidroregjioni Jugor” sh.a.;*
8. *KRU “Prishtina” sh.a.;*
9. *KRU “Gjakova” sh.a.;*
10. *KRU “Mitrovica” sh.a..*

Janë përmbushur obligimet e dala nga Masa 4 e Pakos Emergjente në këtë 100-ditësh të raportimit, në vlerë prej rreth 13,799,700 euro, dhe priten që 1,200,300 euro të transferohen gjatë muajit shtator.

Sa i përket mbështetjes së ndërmarrjeve publike nga Buxheti i Republikës së Kosovës, NP Trepça sh. a për realizimin e projektit - Hapja e vendpunishteve të reja në horizontet X-XI Miniera “TREPÇA” Stanterg, i janë transferuar mjete financiare në bazë të kërkesës së NP Trepça sh.a. në vlerë prej 26.830 euro.

Ndërsa, për Programin Mbështetës për Ujësjetës & Kanalizime në Zonat Rurale - Faza VI-të (RËSSP-VI) e financuar nga Qeveria Zvicerane (SDC) dhe Qeveria e Kosovës (projekt në vazhdim) për vitin 2020 në ligjin e buxhetit janë alokuar mjete financiare në vlerë prej 3,000,000.00 euro. Për këtë periudhë raportuese CDI ka bërë kërkesë për transferim të mjeteve financiare në vlerë prej 1,500,000.00 euro, të cilat priten të transferohen gjatë muajit shtator.

3.9. Koordinimi i asistencës zhvillimore

Në kuadër të Programit IPA 2021 dhe 2022, në bashkëpunim me zyrën e BE-së janë shqyrtuar për trajtim të mëtutjeshëm projekt propozimet të cilat përfshin një vlerë prej rreth 112 mil.€.

IPA 2021:

- *Dekomisionimi i TC Kosova A (rreth 50 milionë euro).*
- *Ndërtimi i deponisë për mbetjet e rrezikshme (12 milionë euro, bartur nga IPA II);*
- *Impianti i trajtimit të ujërave të zeza në TC Kosova B (8 milionë euro).*
- *Mbështetja për Kompaninë e Menaxhimit të Deponive të Kosovës (2 mil euro).*
- *Dizajni - Mbështetja e BE për pastrimin e ajrit në Kosovë, Faza 3 (2 milionë euro).*

IPA 2022:

- *Ndërtimi i impiantit fotovoltaik (15 milionë euro).*
- *Sistemi i kanalizimit dhe ujërat e shiut në Prishtinë (20 milionë euro);*
- *Mbështetje për fondin e efijencës së energjisë në ndërtesat rezidenciale (3 mil euro).*

Është hartuar raporti gjashtëmuor për përmbushjen e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane, me ç'rast komunat kanë arritur t'i përmbushin 59% të obligimeve që bien nën përgjegjësinë e implementimit të qeverisjes lokale.

3.10. Përmirësimi i gjendjes së mjedisit

Për të rritur transparencën lidhur me këto çështje, është publikuar raporti vjetor për gjendjen e ajrit në Kosovë për vitin 2019, si dhe është përgatitur drafti i raportit për gjendjen e ujërave në Kosovë për periudhën kohore 2015-2020. Po ashtu, është finalizuar dhe do të procedohet për shqyrtim të mëtejme në Qeverinë e Kosovës drafti i Raportit vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2018-2019. Në kuadër të projektit që po zbatohet nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit - MCC (Millenium Challenge Cooperation), është përgatitur drafti i parë i inventarit të burimeve të emisioneve në ajër. Gjithashtu, është përgatitur specifikacioni teknik dhe është kontraktuar operatori ekonomik për realizimin e projektit “Avancimi dhe automatizimi i rrjetit ekzistues meteorologjik”, nëpërmjet të cilit do të instalohen 5 stacione meteorologjike për matje automatike dhe bartje të të dhënave në kohë reale.

Është finalizuar përgatitja e vjetarit hidrometeorologjik për vitin 2019, i cili është publikuar në ueb faqe te IHMK-së. IHMK ka krijuar draftin final për “Portali për cilësinë e ajrit në Kosovë” dhe draftin fillestar të aplikacionit për telefon te mençur (iOS dhe Android) nëpërmjet së cilëve bëhet vizualizimi i të dhënave dhe informimi i qytetarëve për cilësinë e ajrit në Kosovë. Në kuadër të programit të bashkëpunimit me Agjencinë e Mjedisit të Evropës është realizuar raportimi për zonat e mbrojtura, për emisionet në ajër, për inventarin e gazrave serrë dhe për impiantet me djegie në mëdha

Është finalizuar Raporti për vlerësimin paraprak të rrezikut nga vërshimet në pellgjet lumore të Kosovës. Për më shumë, është arritur marrëveshja edhe për financimin e projektit “Nxitja dhe shfrytëzimi i mundësive për programin e sigurisë së ujërave”, në mes të Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA).

Në funksion të përmirësimit të fushës së mbeturinave, drafti i strategjisë për menaxhimin e integruar të mbeturinave në Republikën e Kosovës 2020-2029, është dërguar për opinion financiar në Ministrinë e Financave. Vlerësimi dhe raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave komunale dhe deponive ilegale në të gjitha komunat e Kosovës për vitin 2019, është finalizuar. I finalizuar është edhe ndërtimi i impiantit për ndarjen dhe riciklimin e mbeturinave komunale në Komunën e Mitrovicës, një projekt me vlerë prej 3 milionë eurosh.

Në kuadër të zhvillimit të Sistemit Informativ Mjedisor, është finalizuar edhe përgatitja teknike e gjeodatabazës dhe janë plotësuar të dhënat për zonat e mbrojtura të natyrës, të dhënat për ujërat sipërfaqësore, të dhënat për hot-spotet mjedisore dhe të dhëna tjera mjedisore. Gjithashtu është përgatitur drafti i bazës së të dhënave për mbeturinat e rrezikshme industriale dhe kemikatet dhe janë mbledhur të dhëna për plotësimin e kësaj data bazë.

Në kuadër të aktiviteteve për monitorimin e gjendjes së zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit, ka vazhduar monitorimi i faunës më anën e kamerave kurth në dy parqet kombëtare, “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”, ku janë evidentuar një numër i konsiderueshëm i llojeve të rralla të shtazëve të egra. Është përgatitur edhe baza e të dhënave për biodiversitetin, si dhe ka përfunduar projekti për shenjëzimin e rezervateve strikte të natyrës (vendosja e tabelave informuese).

Sa i përket ndikimit të shfrytëzuesve të resurseve minerare (gurthyesve) në mjedis, është përgatitur vlerësimi i gjendjes, janë identifikuar problemet kryesore dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes.

3.11. Fuqizimi i planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe banimit

Ka vazhduar plotësimi i Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, bazuar në kërkesat e fundit të pranuar nga komunat pjesëmarrëse dhe komuniteti i fshatrave brenda parkut. Po ashtu, në proces është edhe konsolidimi përfundimtar i draftit të Hartës Zonale të Kosovës, si dhe inicimi i rifillimit të punës së Komisionit për vlerësimin e Raportit për VSM të dokumentit, i cili është veprimi përfundimtar për të përmbyllur procesin e hartimit të Hartës Zonale të Kosovës. Sa i përket Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”, është në proces vlerësimi i zbatueshmërisë së PH ekzistues, pas të cilit do të merret vendimi për hartimin ose revidimin e PHPK “Sharri”.

Sa i përket fushës së ndërtimit, është marrë vendimi i vazhdimit të afatit për aplikim për pranimin e aplikacioneve për trajtimin e ndërtimeve pa leje edhe për 12 muaj. Është finalizuar aplikacioni për regjistrimin e lëndëve për legalizim për nivelin komunal, si dhe është hartuar manuali i përdorimit të aplikacionit për regjistrimin e lëndëve për legalizim në nivelin komunal. Përmirësimi i gjendjes në fushën e kadastrit, administrimit të tokës dhe shpronësimi Gjatë kësaj periudhe, në kuadër të reformave të filluara me qëllim të unifikimit dhe qartësisimit të procedurave për regjistrimin e pronës në kadastër, janë publikuar dokumentet profesionale si:

- *Korniza e Punës Nr. AKK 2020/01 për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale; Doracaku për rindërtim të informacioneve kadastrale;*
- *Doracaku për kadastër të ndërtesave dhe Udhëzuesi për procedurat e regjistrimit të pronës së paluajtshme në Kadastër.*
- *Ka përfunduar rishikimi i aktiviteteve të projektit për regjistrim të pronës së paluajtshme dhe infrastrukturë gjeohapësinore (REGIP), pas ratifikimit nga Parlamenti i Republikës së Kosovës.*
- *Është zhvilluar moduli për regjistrimin automatik të hipotekave nëpërmjet Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK), për nevoja të institucioneve financiare.*
- *Është kapitalizuar bashkëpunimi mes AKK-së dhe Postës së Kosovës me vendosjen e zonave postare në sistem të adresave.*
- *Është zhvilluar Ueb-shërbimi i ndërtuar në sistemin e informacionit kadastral të AKK-së, i cili ofron të dhënat kadastrale për vlerësimin e tatimit në pronë.*
- *Është zhvilluar edhe shtresa COVID-19 në sistemin grafik të të dhënave dhe është përditësuar në baza ditore.*

Sa i përket fushës së shpronësimit, janë miratuar 4 vendime për shqyrtimin e kërkesës, si dhe 4 vendime preliminare për shpronësim. Gjatë kësaj periudhe janë proceduar për kompensim të pronës gjithsej 138 lëndë me 224 raporte në vlerë financiare prej 6,330,944.00 euro.

Në procesin e zhvendosjes jo vullnetare, është miratuar në parim Plani i Veprimt për Zhvendosje (PVZH) i një pjese të fshatrave Hade, Palaj, Sibovc, Shipitulle dhe Leshkoshiq, në sipërfaqe prej 129 ha.

Mbikëqyrja inspektive

Në kuadër të mbrojtjes së resurseve natyrore në Parqe Kombëtare, në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit janë përgatitur dhe janë dorëzuar në prokurori themelore 50 kallëzime penale.

4. Drejtësi e pavarur dhe efikase

Situata e krijuar për shkak të pandemisë COVID-19 ka ndikuar edhe në fushën e drejtësisë, pasi që një numër i aktiviteteve të parapara për këtë periudhë nuk kanë mundur të realizohen. Megjithatë, Ministria e Drejtësisë në përputhje edhe me Agjendën për Reforma Evropiane (ERA), ku janë identifikuar veprimet prioritare, të cilat duhet të ndërmerren për shfrytëzimin sa më të mirë dhe më të gjerë të mundësive që ofron Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit mes BE dhe Republikës së Kosovës (MSA), pas prioritizimit të veprimeve specifike për zbatimin e obligimeve të saj, ka përfunduar rishikimin e një numri të akteve ligjore, si dhe hartimin e akteve nënligjore dhe politikave të reja.

Legislacioni dhe zbatueshmëria



Nënshkrimi i Memorandum Bashkëpunimi në mes të ministrit të Drejtësisë Selim Selimi dhe Rrjetit të Grave të Kosovës dhe Shoqatës "Rrjeti i Shitësve me Pakicë" për punësimin e personave të strehuar në strehimoret e dhunës në familje dhe të mbijetuarat/it e dhunës seksuale gjatë luftës – 08.07.2020

Ka filluar reforma legislative nëpërmjet rishikimit dhe hartimit të Projektligjeve, Projekt-Kodeve dhe Koncept-Dokumenteve në fusha të ndryshme të drejtësisë.

Gjatë kësaj periudhe është miratuar Projekt Kodi Civil nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i cili mes tjerash, synon që të bëjë rregullimin dhe harmonizimin e dispozitave ligjore të së drejtës civile, përfshirë Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimeve (kontratave dhe detyrimeve tjera nga shkaktimi i dëmit, pasurimi i pabazë etj.), Ligjin e Pronësisë dhe të drejtave të tjera sendore, si dhe Ligjin për Familjen dhe Ligjin për Trashëgiminë.

Gjithashtu, rëndësi e posaçme i është kushtuar të drejtave pronësore, duke hartuar dhe miratuar nga Qeveria tri projektligje nga kjo fushë: Projektligji për Tokën Ndërtimore, Projektligji për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj, dhe Projektligji për Pronën Publike.

Më tutje, Ministria e Drejtësisë ka hartuar edhe Projektligjin për të Drejtën Ndërkombëtare Private. Ky Projektligj përmban rregulla për caktimin e të drejtës kompetente të marrëdhëniet juridiko – private me element ndërkombëtar, rregulla për kompetencën e gjykatave dhe organeve të tjera për shqyrtimin e atyre marrëdhënieve dhe rregulla për procedurën, si dhe rregulla për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe vendimeve të organeve të tjera të shteteve të huaja.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe është përfunduar edhe me vlerësimin ex-post të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, dhe i njëjti është përcjellë për procedura të mëtutjeshme në ZKM. Sa i përket akteve nën-ligjore është hartuar Udhëzimi Administrativ Nr. 02/20201 për Mbrojtjen

Juridike të personave të akuzuar potencial për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë dhomave të specializuara; Udhëzim Administrativ Nr.03/20201 për Mbështetjen e Nevojshme Financiare për anëtarët e ngushtë të familjes së personave të akuzuar potencial për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë dhomave të specializuara, për shpenzimet e ndërlidhura me udhëtimet e tyre kur procedurat gjyqësore zhvillohen jashtë Kosovës; si dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 04/20201 për Kompensimin e Personave të akuzuar për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë dhomave të specializuara, të shpallur të pafajshëm me vendim të plotfuqishëm. Gjithashtu, është miratuar Koncept Dokumenti për kompensimin e viktimave të krimit. Nëpërmjet këtij koncept dokumenti është bërë analizë e thukët mbi programin dhe kornizën legjislativë aktuale në Kosovë që rregullon këtë fushë. Janë miratuar dy rregullore (1. Rregullorja për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemës së Grantit për Performancë Komunal; 2. Rregullorja për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës), një udhëzim administrativ (U.A për Transparencë në Komuna). Në proces të hartimit janë edhe 3 udhëzime administrative, që kanë të bëjnë me: komitetet e përhershme në komuna, emërimin e nënkryetarëve në komuna dhe sekretaritë e kuvendeve të komunave.

4.1. Avancimi dhe forcimi i institucioneve të drejtësisë

Me qëllim të avancimit dhe forcimit të institucioneve të drejtësisë, gjatë kësaj periudhe ka filluar faza e tretë e Rishikimit Funksional të Sektorit të Sundimit të Ligjit (RFSSL), që parasheh hartimin e Projekt Strategjisë Sektoriale për Sundimin e Ligjit. Kjo projekt strategji, e cila kurorëzon procesin e RFSSL, mëton të përmirësojë strukturën institucionale dhe legjislativë në katër shtyllat bazë të sektorit të drejtësisë: gjyqësorit, drejtësisë penale, qasjes në drejtësi dhe anti-korrupsionit. Ministria e Drejtësisë është duke punuar për hartimin e katër kapitujve të Strategjisë dhe paralelisht ka filluar edhe hartimi i Planit të Veprimit.

Shumë me rëndësi është procesi i vetingut në sektorin e drejtësisë. Lidhur me këtë prioritet që rrjedh nga Rishikimi Funksional i Sektorit të Sundimit të Ligjit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim të themelojë Grupin punues për hartimin e modaliteteve dhe skenarëve për reformën e sistemit të drejtësisë, me qëllim të rritjes së llogaridhënies. Grupi ka përbërje gjithëpërfshirëse nga të gjithë hisedarët e drejtësisë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, mekanizmave të sigurisë, dhe partnerëve strategjikë.

Përveç këtyre, Qeveria ka ndërmarrë veprime edhe për fushat si më poshtë:

Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK): ka arritur të vërë në funksion Qendrën për Vlerësimin dhe Klasifikimin e të Burgosurve, Njësinë e Inteligjencës dhe Njësinë Ekonomike në kuadër të SHKK-së. Që të tria, janë funksionalizuar vetëm si pilot projekte, duke marrë parasysh që projektligjet, të cilat do të përbëjnë bazën për operimin e tyre, Projektligji për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe Projektligji për Shërbimin Korrektues, janë ende në proces të hartimit. Krahas kësaj, SHKK, gjatë kësaj periudhe, ka hartuar edhe planet vjetore të trajnimit për trajtimin e të burgosurve, që tashmë ka filluar të zbatohet në institucionet korrektuese. Përveç të tjerash, SHKK-ja ka filluar edhe zbatimin e programeve individuale të rehabilitimit për kategorinë specifike të të burgosurve luftëtarë të huaj të QK në Dubravë dhe në Burgun e Sigurisë së Lartë.

Inspektorati i MD-së për SHKK ka realizuar inspektime periodike sipas dinamikës së paraparë. Gjatë kësaj periudhe është bërë inspektimi i dy rasteve të vetëvrasjeve, duke u identifikuar shkeljet dhe njëkohësisht janë dhënë rekomandimet adekuate.

Shërbimi Sprovues i Kosovës ka hartuar Programin për Ekzekutimin e Masave të Diversitetit dhe Doracakun e Punës për zbatimin sa më të plotë të këtyre masave. Të dy dokumentet tanimë janë pjesë e punës së përditshme të Shërbimit Sprovues. Gjithashtu, me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve të SHSK-së për mbikëqyrjen e Masave dhe Dënimeve Alternative (MDA)-së, gjatë periudhës raportuese, janë hartuar materialet trajnuese për nevojat e zyrtarëve, të cilat mëtojnë zbatim sa më të mirë të masave së diversitetit dhe dënimeve.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar ka ekzekutuar gjithsej 52 vendime të dërguara nga Gjykatat Kompetente, për administrimin e pasurisë të sekuestruar ose të konfiskuar. Nga këto vendime, 38 vendime janë për sekuestrim (vlera e përafërt rreth 747,004.62 €); 6 vendime për konfiskim (vlera e përafërt rreth 6,425.11 €); 8 vendime për kthimin e pasurive (vlera e përafërt rreth 503,455.91 €). Gjithashtu, nga dy ankande janë realizuar të hyra me vlerë prej 16,182.00 euro.



Instituti i Mjekësisë Ligjore

Me qëllim të funksionalizimit të plotë të IML, është miratuar Rregullorja Nr. 01/20201 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore. Gjithashtu, me riaktivizimin e projektit IPA në muajin korrik 2020, ka filluar edhe hartimi i analizës së mangësive dhe vlerësimi i nevojave për trajnim të stafit.

Profesionet e lira ligjore

Gjatë kësaj periudhe është hartuar drafti i Udhëzimit Administrativ për tarifat për Noter, ku përcaktohen tarifat e punës së noterëve, si dhe Udhëzimi Administrativ për tarifat për ndërmjetësues, të cilët pritet të nënshkruhen së shpejti.

Avokatura shtetërore

Gjatë kësaj periudhe Ministria e Drejtësisë ka hartuar draft-Projektligjin për Avokaturën Shtetërore, i cili ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e funksionimit të Avokaturës Shtetërore të Republikës së Kosovës, me qëllim të përfaqësimit sa më efikas dhe transparent në procedurat gjyqësore, administrative dhe të arbitrazhit.

4.2. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar

Me qëllim të rritjes dhe avancimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar gjithashtu edhe tre projektligjet e tjera të sponsorizuara nga Ministria e Drejtësisë, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-213 për Bashkëpunim

Juridik Ndërkombëtar në çështjet penale, me qëllim të eliminimit të mangësive që çojnë në probleme substanciale dhe të jofikasitetit lidhur me procedurat e ekstradimit, transferimit të personave të dënuar dhe ndihmës juridike të ndërsjellë, si rezultat i dispozitave që shkaktajnë ngarkesa të panevojshme dhe dispozitave jo të plota, Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për transferimin e personave të dënuar, i cili ka për qëllim eliminimin e të gjitha mangësive, zbrazëtirave të evidentuara nga ana e institucioneve përgjegjëse në fushën e transferimit të personave të dënuar, dhe Projektligjin për të Drejtën Ndërkombëtare Private, i cili përmban rregulla për caktimin e të drejtës kompetente të marrëdhëniet juridiko – private me element ndërkombëtar, rregulla për kompetencën e gjykatave dhe organeve tjera për shqyrtimin e atyre marrëdhënieve dhe rregulla për procedurën, si dhe rregulla për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe vendimeve të organeve të tjera të shteteve të huaja. Po ashtu, Projektligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në çështjet civile është në finalizim e sipër dhe së shpejti pritet të dërgohet për miratim në Qeveri.

5. Politika e jashtme, integrimi në BE dhe dialogu me Serbinë

Politika e jashtme e Kosovës ka qenë në funksion të ndërtimit, ruajtjes e thellimit të marrëdhënieve me partnerët strategjikë dhe me shtete të tjera.

5.1. Politika e jashtme



Pristinë, 5 gusht 2020 - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e drejtuar nga Ministria Meliza Haradinaj Stublla, për herë të parë pas 12 vitesh të funksionimit të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës, e filloi ndryshimin e madh - rotacionin sipas konceptit "Një në Shërbim, Një në Ministri".

Prioritetet politike

Pasi që thellimi i marrëdhënieve dypalëshe është prioritet qeveritar, janë zhvilluar takime, telefonata, si dhe video konferenca kurtuazie me një numër të madh të homologëve dhe ambasadorëve rezidentë e jorezidentë në Republikën e Kosovës, ku janë trajtuar marrëdhëniet dypalëshe dhe mundësitë e thellimit të marrëdhënieve. Gjatë kësaj periudhe, Kosova ka kryesuar takimin e ministrave të Punëve të Jashtme të SEECP, si dhe ka marrë pjesë në aktivitetin përmbyllës të kryesimit të Republikës së Kosovës të Presidencën së MARRI. Gjithashtu, ka marrë pjesë në Sesionin e 110-të të Këshillit Permanent të Frankofonisë.

Me qëllim të thellimit të raporteve mes Republikës së Kosovës dhe NATO-s janë mbajtur takime me Zëvendëssekretarin Gjeneral të NATO-s, z. Mircea Geoana, me Përfaqësuesen e Përhershme të Mbretërisë së Bashkuar në NATO, z. Sarah MacIntosh, me Përfaqësuesen e Përhershme të ShBA-ve në NATO, znj.Kay Bailey Hutchinson si dhe me Përfaqësuesen e Përhershme të ShBA-ve në Nato, znj.Kay Bailey Hutchinson.

Me qëllim të avancimit të Republikës së Kosovës, në arenën ndërkombëtare, deri me datë 26.09.2020, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka zhvilluar 68 (gjashtëdhjetë e tetë) takime fizike; 23 (njëzet e tre) biseda telefonike dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) video konferenca. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe zhvillimit të marrëdhënieve me ShBA-të nëpërmjet takimeve si me bartës të titujve shtetëror ashtu dhe me përfaqësues së komunitetit Kosovar në ShBA. Këto takime përfshijnë: Takim me anëtarin e Këshillit të Bashkësisë së Nju Jorkut z. Mark Gjonaj; Takim me zv. Presidentin e "Heritage Foundation" z. James Carafano në Uashington; Takim me zv. Ndihmës Sekretarin Amerikan z. Matthew Palmer në Uashington; Takim me Drejtorin e Lartë në Këshillin e Sigurisë Kombëtare dhe znj. Amanda B.Ahlers -Drejtoreshë për Çështje Evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të SHBA-ve; dhe Takim me Ndihmës Sekretaren për Çështje të Arsimit dhe Kulturës në Departamentin e Shtetit znj. Marie Royce.

Zhvillime të shumta gjatë kësaj periudhe ka pas edhe në inicimin e procedurave për lidhjen e Marrëveshjeve Ndërkombëtare. Disa që vlejné të cekën janë: Pëlqimi për nënshkrimin e Memorandumit RKS -Dukati i Madh i Luksemburgut; Pëlqimi për nënshkrimin e Memorandumit në mes të MSH dhe QATAR Charity; Autorizim për delegim të kompetencës tek z. Ilir Dugolli, Ambasador i Republikës së Kosovës në Ankara, për nënshkrimin e Marrëveshjes për “Donacion në fushën e shëndetësisë” në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë; Draft-Autorizim për nënshkrimin e Marrëveshjes për “Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë sa i përket tatimit në të ardhura dhe parandalimin e evazionit fiskal dhe shmangies” në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve dhe Mbretërisë së Holandës; Pëlqim për nënshkrimin e Marrëveshjes lidhur me projektin Shëndetësia e qasshme dhe cilësore (ShQC) Faza II, ndërmjet Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Konfederatës Zvicerane përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, si marrëveshje ndër-institucionale; Autorizim për Ambasadorin e Republikës së Kosovës në Portugali, për nënshkrimin e Marrëveshjes për “Eliminim të Tatimit të Dyfishtë në mes të Kosovës dhe Portugalisë”; ndër të tjera.

Prioritetet funksionale

Me qëllim të riorganizimit të MPJD dhe shërbimit diplomatik e të jashtëm janë ndërmarrë disa veprime. Së pari është vendosur për kthimin e diplomatëve dhe ambasadorëve që e kanë përfunduar mandatin e tyre. Për herë të parë në kuadër të këtij procesi të rotacionit, është zbatuar procedura sipas parimit “një në shërbim një në Ministri”. Me qëllim të reformimit funksional dhe ri funksionalizimit të Ministrisë, është finalizuar Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Në kuadër të prioriteteve funksionale, Ministrja ka krijuar grupin punues për konstatimin e gjendjes aktuale dhe vlerësimin e nevojave në shërbimin e jashtëm, në aspektin e burimeve njerëzore, kapaciteteve profesionale dhe funksionale. Ky grup punues shumë shpejt pritet të dorëzojë një raport me të gjeturat dhe rekomandimet, por edhe masat që duhet të ndërmerren. Në kuadër të prioriteteve funksionale, duhet të përmendet fakti se është krijuar grupi punues për hartimin e projekt ligjit të ri për Shërbimin e Jashtëm si dhe është gati për miratim në Qeveri, projektligji për Zbatimin e Sanksioneve Financiare Ndërkombëtare, të Shënjestruara, i cili është obligim që del nga MSA. Në kuadër të prioriteteve funksionale dhe ri organizimit, një grup punues i krijuar nga Ministrja, ka analizuar legjisllacionin primar dhe sekondar dhe ka hartuar një plan, të rishikimit dhe hartimit të akteve të reja juridike, të cilat do të mundësonin ri funksionalizimin e Ministrisë.

Në anën tjetër, me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe ngritjes së kapaciteteve të shërbimit të jashtëm, do të hapen misione të reja diplomatike dhe konsullore si dhe është hapur konkursi për nëpunës të Misioneve Konsullore dhe është marrë vendimi për caktim-emërimin e Zyrtarëve të MPJD-së për të shërbyer në Misionit Diplommatike dhe Konsullore.

5.2 Integrimi në BE

Sa i përket dialogut të reformave me BE-në nëpërmjet strukturave të përbashkëta të stabilizim-asociimit BE – Kosovë për zbatimin e MSA-së, gjatë periudhës raportuese janë mbajtur

mbledhjet e raundit të katërt të tri nënkomiteteve dhe ka vazhduar monitorimi i zbatimit të konkluzioneve të mbledhjeve të raundit të tretë të. Gjithashtu është dakorduar me Komisionin Evropian kalendari i raundit të pestë të këtyre strukturave.

Sa i përket kornizës së politikave për zbatimin e MSA-së, Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA), 2020-2024 është miratuar nga Qeveria më 17 korrik 2020 dhe është dërguar në Kuvend për miratim përfundimtar.

Në fund të qershorit, është përgatitur dhe dorëzuar një përditësim shtesë i kontributit të institucioneve të Republikës së Kosovës, (me zhvillimet gjatë periudhës 1 prill – 15 qershor 2020), për Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën – 2020.

Lidhur me përafrimin e legjislacionit vendës me acquis të BE-së, është punuar drejt digjitalizimit të këtij procesi. Njësitë përkatëse të shërbimit ligjor qeveritar, kanë hartuar specifikat e platformës digjitale. Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar 61 opinione të përputhshmërisë me acquis të BE-së: për 39 projektligje dhe 22 projekt-akte nënligjore. Sa i përket koordinimit të përkthimit të acquis-së së BE-së në gjuhët zyrtare të Kosovës, DDBE/ZKM, në bashkëpunim me Drejtorinë e BE-së në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë kanë hartuar kalendarin vjetor për 2020 për përkthim dhe certifikim të acquis së BE-së në gjuhët shqipe.

Sa i përket liberalizimit të vizave, Komisionit Evropian në baza mujore i janë dorëzuar raporte të të përditësuara mbi zbatimin e kriterit të fundit për zgjidhjen e rasteve të shënjestruara (track record) të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar.

Lidhur me asistencën e BE-së, gjatë periudhës raportuese janë finalizuar marrëveshjet financiare për programin IPA 2019, pjesa e dytë, dhe IPA 2020, ku totali i fondeve të përfituara nga BE-ja do të jetë 138 milionë euro, që do të zbatohen si projekte dhe në formë granti për buxhetin e vendit.

Më tej, janë kryer pagesat e përkrahjes buxhetore sektoriale në kuadër të IPA 2016 dhe IPA 2017, ku Kosova ka përfitur, si shpërblime për arritjen e treguesve të përkrahjes buxhetore sektoriale për reformën e administratës publike dhe menaxhimin e financave publike, pagesa në vlerë prej 10 milionë eurosh, si kontribut i drejtpërdrejt në buxhetin e shtetit.

5.3 Dialogu me Serbinë

Në përputhje me mandatin kushtetues, si dhe me zotimet për transparencë të plotë për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, Kryeministri i Kosovës ka raportuar rregullisht në Kuvendin e Kosovës lidhur me procesin e dialogut, si dhe për marrëveshjen e arritur në Uashington më 4 shtator 2020.

Si vend demokratik, me orientim të qartë, dhe të natyrshëm, euro-atlantik, Kosova ka obligim për të përparuar drejt këtyre integriteteve. Kjo nënkupton nevojën dhe obligimin për të normalizuar marrëdhëniet tona me vendet fqinje.

Qeveria e Republikës së Kosovës, udhërrëfyes për procesin e dialogut, për arritjen e marrëveshjes përfundimtare, që duhet të kulmojë me njohje reciproke mes dy vendeve, e ka platformën e parimeve dhe objektivave. Parimet, mbi të cilat do të qëndrojë marrëveshja, burimin e kanë në

Kushtetutën e Kosovës. Këto parime garantojnë se:

1. *Integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pa negociueshëm, dhe për pasojë i pa cenueshëm nga çfarëdo përpjekje që mund të burojë nga çfarëdo faktorësh në procesin dialogues.*
2. *Organizimi kushtetues i Republikës së Kosovës dhe sistemi unitar i saj nuk mund të preket, pasi si i tillë garanton funksionimin demokratik të pushteteve, barazinë në përfaqësim dhe mbron parimin e shtetit qytetar, e jo atij etnik.*
3. *Marrëveshja me Serbinë do të jetë plotësisht në frymën e Kushtetutës, sepse Kushtetuta e Republikës së Kosovës është instrumenti i vetëm që i jep legalitet një marrëveshje të tillë.*

Respektimi i këtyre parime na siguron proces dialogues me objektiva të qarta, që janë:

1. *Marrëveshja për paqe në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të rezultojë me njohje reciproke,*
2. *Marrëveshja duhet të përmbajë detyrimin e BE-së për të përmbyllur njohjen e Kosovës nga pesë vendet që deri më tani nuk na kanë njohur,*
3. *Shfuqizimi i Rezolutës 1244 si dhe anëtarësimi i Kosovës në OKB,*
4. *Anëtarësimi në organizatat e tjera ndërkombëtare,*
5. *Hapja e qartë e perspektivës evropiane për Kosovën,*
6. *Adresimi i të gjitha çështjeve të hapura në mes të dy vendeve, pasi asnjë normalizim nuk mund të ndodhë pa u vendosur drejtësia.*

Mbi bazën e këtyre parimeve dhe objektivave, Qeveria e Republikës së Kosovës, pas gati dy vitesh, ka rifilluar procesin e dialogut me Serbinë. Ky nuk është dialog teknik, por dialog për marrëveshje finale për njohje reciproke dhe normalizim të raporteve në mes të dy vendeve.

Ky proces i dialogut për marrëveshje për njohje reciproke ka nisur më datë 10 korrik, kur nën organizimin e Presidentit të Francës, Emanuel Macron, dhe Kancelares së Gjermanisë, Angela Merkel, është mbajtur Samiti i Parisit. Të dy palët kemi prezantuar qëndrimet tona. Ndërkaq, nga organizatorët e samitit janë dhënë mesazhet e qarta se dialogu është i kufizuar në kohë dhe është për marrëveshje përfundimtare për normalizim të plotë, që nënkupton njohje reciproke. Bazuar në këto qëndrimet të qarta, u mbajt video konferenca e parë në mes të dy palëve më 12 korrik 2020. Ndërkaq, më 16 korrik dhe 7 shtator janë mbajtur takimet e nivelit të lartë në Bruksel. Në mes të këtyre datave janë mbajtur disa takime të koordinatorëve të dialogut.

Qasja serioze e Qeverisë së Kosovës në këtë proces ka ndikuar që SHBA-të të angazhohen fuqishëm dhe të marrin rol aktiv. Në këtë funksion, më 3 dhe 4 shtator, u ftuam në Shtëpinë e Bardhë për të dialoguar për normalizim të marrëdhënieve ekonomike. Këto biseda kulmuan më 4 shtator, ku në prani të Presidentit Trump, nënshkruam marrëveshje zotimi për normalizimin ekonomik në mes të dy shteteve.

Kjo marrëveshje në përmbajtjen e saj i ka 16 pika, të cilat përfshinë: projekte të mëdha infrastrukturore, funksionalizimi i pikës kufitare në Merdar, gatishmëria për hyrje në zonën

minishengen, njohja e diplomave dhe certifikatave, studimi i fizibilitetit nga Departamenti për Energji i SHBA-së për përdorimin e ujit të liqenit të Ujmanit, njohja reciproke me shtetin e Izraelit, si dhe pika të tjera.

Tani është një momentum i ri ndërkombëtar i marrëdhënieve BE-SHBA, i cili ka për qëllim të prodhojë një projekt përfundimtar normalizimi dhe paqëje, përmes njohjes mes Kosovës dhe Serbisë. Por, vetvetiu ky momentum nuk do të kishte prodhuar këtë marrëveshje pa rolin aktiv të Qeverisë së Kosovës, duke treguar seriozitet dhe pragmatizëm, bazuar në parime të qarta. Kjo mbështetje e partnerëve për Kosovën nuk ka qenë e lehtë të arrihet, pas lëndimit shumë rëndë të raporteve me ta për vite me radhë.

Me këto projekte, Kosova kthehet në qendër të aktivitetit ekonomik në regjion dhe më gjerë sa i përket komunikacionit rrugor dhe hekurudhor. Këtë rol të rëndësishëm Kosovës po ia sigurojnë miqtë e saj, të cilët po e mbështesin këtë Qeveri me vizion të qartë, me qeverisje qytetare e normale, që promovon ekonominë e tregut dhe vlerat evropiane.

Njohja nga shteti i Izraelit paraqet një fitore të madhe diplomatike të Kosovës. Kjo njohje e ka thyer bllokadën disa vjeçare të mungesës së njohjeve të reja për Kosovën. Kjo njohje e ka ndërruar trajektoren për fuqizimin e subjektivitetit tonë ndërkombëtarë.

6. Arsimi dhe shkenca

Edhe pse kohë pandemie, MASH-i ka arritur ta përmbyllë me sukses vitin shkollor/akademik 2019/2020, si dhe ka bërë përgatitjet për fillimin e vitit 2020/2021, konform rrethanave aktuale.

6.1 Arsimi parauniversitar

Gjatë kësaj kohe, është hartuar plani për fillimin e vitit shkollor 2020/2021 në rrethanat e krijuara nga COVID-19, me ç'rast janë përgatitur tre skenarë për realizimin e procesit mësimor në të gjitha nivelet e arsimit para universitar (duke përfshirë edhe arsimin dhe aftësimin profesional dhe arsimin e fëmijëve/ nxënësve me nevoja të veçanta), sipas kushteve/rrethanave që ekzistojnë në shkollat përkatëse.

Është hartuar Planin për e-Mësimin për përgatitjen dhe ofrimin e mësimin në distancë për vitin shkollor 2020-2021 për të gjithë nxënësit e arsimit të detyruar në Kosovë (klasat 1-9, për rreth 230 mijë nxënës). Ky plan përfshin aspektet e rëndësishme, si: aktivitetet e menjëhershme përgatitore që ka ndërmarrë MASH; strukturat, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira në këtë proces; fushat kurrikulare, lëndët dhe fondin e orëve; fillimin e vitit shkollor, kohëzgjatjen, volumin e përgjithshëm dhe orarin ditor e javor të e-Mësimin; protokollin e detajuar për përgatitjen, kontrollimin, xhirimin, konfirmimin dhe transmetimin/publikimin e video-ligjëratave dhe materialeve të tjera mësimore; udhëzime për komunikimin e rregullt mes mësimdhënësve dhe nxënësve. MASH ka caktuar palët që do të përfshihen në e-Mësim, duke filluar nga koordinatori i përgjithshëm që është personi kryesor përgjegjës për organizimin, menaxhimin, koordinimin dhe mbarëvajtjen e përgjithshme të projektit të e-Mësimin për klasat 1-9. Është bashkëpunuar me Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA), nga të cilat janë siguruar shumica e burimeve njerëzore e profesionale që janë përfshirë në projektin e-Mësimin. Divizioni përkatës për kurrikula i MASH-it në bashkëpunim me trajnerët e fushave kurrikulare dhe me mësimdhënës klasorë e lëndorë me përvojë kanë hartuar planet mësimore, ditore e javore për të gjitha lëndët e përfshira në e-Mësimin për klasat 1-9 për tërë vitin shkollor 2020-2021, sipas orarit të paraparë javor në përputhje me kornizën kurrikulare, kurrikulat bërthamë, plan-programet lëndore dhe planin mësimor. Planet e detajuara mësimore u janë shpërndarë me kohë të gjithë mësimdhënësve të Kosovës të klasave 1-9. Po ashtu është bërë përzgjedhja e mësimdhënësve për realizimin e video materialeve. MASH në bashkëpunim me DKA-të kanë riangazhuar mësimdhënësit të cilët janë dëshmuar si të suksesshëm gjatë periudhës mars – qeshor 2020, dhe me 29.07.2020 MASH është publikuar thirrja publike për interesim për realizimin e video materialeve (numri i mësimdhënësve të paraparë për t'u përfshirë në e-Mësimin është 104 mësimdhënës për të gjitha klasat/lëndët 1-9). Në bashkëpunim me DKA-të janë përzgjedhur 54 redaktorë për klasat 1-9 që përfshihen në e-Mësim, detyrë e të cilëve është kontrollimi dhe korigjimi i materialeve mësimore (prezantimeve) që përgatiten nga mësimdhënësit, para se ato të xhirohen. MASH ka zgjedhur edhe formën e ofertës publike për përzgjedhjen e entitetit, kompanisë, organizatës që do të merret me përgatitjen e orarit (orari për xhirim, orari për transmetim në televizionin publik, orari për publikimin e video-ligjëratave në platformën e ministrisë) dhe me organizimin e videove e koordinimin e transmetimit/publikimit të video-ligjëratave, sipas specifikave të paraqitura në planin e e-Mësimin me dizajnim të thjeshtë dhe lehtë të përdorshëm për nxënësit dhe mësimdhënësit.

Ndërsa, sa i përket zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve MASH ka realizuar disa trajnime, si: trajnimi i mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës për klasën përgatitore, për klasat 1, 6 dhe klasën 10 për gjimnaze; trajnimi për Udhëheqje Arsimore me 4 grupe në nivel të Kosovës dhe janë mbajtur testet për modulet e kryera më herët; në kuadër të projektit të BE-së ka përfunduar trajnime dhe janë certifikuar 1000 mësimdhënës për nivelet parafillor dhe fillor (klasat 1-5); janë licencuar 60 mësimdhënës; janë trajnuar 420 mësimdhënës për fushat: gjuhë dhe komunikim, matematikë dhe për programin parafillor; janë certifikuar 300 mësimdhënës në programin Udhëheqje Arsimore (gjithsej 21 ditë nga 147 orë trajnimi dhe mbulohet nga buxheti i MASH); janë trajnuar 80 mësimdhënës për e-Mësimin (trajnim online nga IPK); GIZ ka realizuar trajnime të fushave të ndryshme me 711 pjesëmarrës (mësimdhënës, drejtorë shkollash, psikologë, pedagogë, inspektorë arsimor, trajnerë programesh të ndryshme). Është hartuar udhëzuesi i përgjithshëm i MASH për organizimin e vitit shkollor 2020-2021, i cili parasheh 3 skenarë (A, B, C) dhe kalimin prej një skenari në tjetrin me rekomandime strikte sipas ISHPK-së, të cilët do të vihen në funksion varësisht nga situata pandemike. Udhëzuesi parasheh: 1. Kornizën e planifikimit që përfshin politikën, veprimtarinë e sigurt të shkollave, qasjen në grupet e marginalizuara dhe mirëqenien, dhe financimin; 2. Masat higjienike dhe mbrojtëse - rregullat e sjelljes dhe pasojat për organizimin e mësimin; 3. Organizimin e vitit shkollor dhe shkollës, përkrahjen e nxënësve sipas skenarëve A, B dhe C për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar; 4. Zbatimin e kurrikulës dhe udhëzimet metodologjike sipas ipas Kornizës së Kurrikulës të Kosovës (KKK), dhe kurrikulave bërthamë për tre nivelet të arsimit parauniversitar.

MASH ka definuar listën me trajnimet bazë të domosdoshme për të zbatuar cilindo nga skenarët e mundshëm të propozuar nga udhëzuesi i përgjithshëm për vitin e shkollor në kushte pandemie COVID-19, si: masat COVID-19 për Mësimdhënës, drejtorë dhe prindër; mbështetja e nxënësve në shtëpi gjatë izolimit- mësimi në distancë; mirëpritja e nxënësve përsëri në shkollë; krijimi i menyrave /formave të të nxënësve të bazuara në nevojat individuale të nxënësve/ve; masat COVID 19 për shkollat- Ruajtja e shëndetit publik, drejtorët dhe inspektorët, DKA; mbajtja e higjienës dhe produktet higjienike për kompanitë e pastrimit, pastruesit dhe personelin teknik; masat COVID 19 në Shkollë për nxënës, mësimdhënës dhe prindër. Shpjegimet për skenarët, masat, mënyrën e raportimit.

Është hartuar protokoli i masave higjienike dhe mbrojtëse dhe udhëzuesi që përmbledh të gjitha masat higjienike që duhet të zbatohen për mbrojtje nga COVID 19 bazuar në rekomandimet e MSH, IKSHPK, OBSH, CDC, WHO dhe praktikën më të njohura evropiane dhe botërore për mbrojtje nga virusi. Po ashtu është hartuar edhe protokoli i reagimit ndaj pandemisë (algoritmi i veprimit ndaj covid 19) që përcakton mënyrën e reagimit të menaxhmentit të personelit të shkollave dhe të DKA-ve në rast të paraqitjes së rasteve të infektimit individual ose grupor të nxënësve ose të personelit të shkollave. Janë hartuar edhe 4 deklaratat të përkushtimit për zbatim të udhëzimeve për punë në kushte pandemie në shkollat dhe në distancë.

Është hartuar dhe aprovuar nga qeveria Master plani për fillimin e vitit të ri shkollor i cili përfshin planin e veprimit dhe koston e projektuar të përgatitjes, zbatimit dhe monitorimit të e-mësimin. Fushëveprimi i këtij projekti është shumë i gjerë pasi që parasheh aspektet kryesore të fillimit të mësimin në objekte shkollore dhe zbatimin e e-Mësimin në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar (edukimin në fëmijërinë e hershme, klasat 1-5, 6-9, dhe 10-12), arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta (ANV), dhe mësimin në gjuhët e komuniteteve (serbë, boshnjakë, turq, romë) në shkollat e Kosovës.

Me datën 11.09.2020 në pajtueshmëri të plotë të MSH, IKSHPK, SBASHK, Kolegjiumi i DKA, Këshilli prindërvë është marrë vendimi për fillimin e vitit të ri shkollor në kushte pandemie, i organizuar në 2 faza.

Janë dezinfektuar shkollat dhe janë vendosur udhëzimet se si të sillemi në shkollë në kushte pandemie.

Secili institucion arsimor e ka krijuar task forcën e vet dhe në varësi të kushteve fizike, përgatitjeve që i ka bërë, por edhe numrit të nxënësve, në harmonizim me task forcën në nivel të DKA mund të organizojë mësimin sipas cilitdo skenar për të gjitha klasat. Komunikimi i task forcave shkollë-DKA-MASH do të jetë i përditshëm dhe në fund të çdo dite do të ketë një raport për ecurinë e procesit mësimor. Vlerësimi i situatës epidemiologjike do të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në këtë mënyrë do analizohen me kujdes rrethanat dhe mundësitë e vazhdimit të mësimin sipas skenarëve të paraparë.

Në kuadër të përgatitjeve për fillimin e vitit shkollor, poashtu është publikuar kalendari për vitin e ri shkollor; janë shpërndarë tekstet shkollor në të gjithë shkollat e Republikës së Kosovës; si dhe është bërë planifikimi për reduktim të orarit.

Inspektorati i Arsimit ka realizuar inspektime sistematike në të gjitha rajonet e Kosovës. Po ashtu edhe gjatë vikendeve i gjithë stafi i MASH dhe i komunave kanë vizituar shkollat. Inspektorati i Arsimit bashkë me atë sanitar do të jetë çdo ditë në terren për të vlerësuar vazhdimisht gjendjen në shkolla.

Duke ditur rëndësinë që ka ngritja e vetëdijes së individëve për respektimin e masave parandaluese ndaj COVID- 19, ora e parë e mësimin iu ka kushtuar pandemisë dhe një orë në javë në vazhdimësi do t'i kushtohet të rejave rreth pandemisë. Poashtu DKA-të do të ri-organizojnë personelin ekzistues sipas nevojës, dhe do të angazhojnë personel shtesë arsimor me qëllim të plotësimit të kërkesave për mësimdhënës pas ndarjes së paraleleve në grupe të vogla dhe për zëvendësimin e personelit që mund të infektohet në vendin e punës.

Është bërë një testim pilot i mësimdhënësve për virusin Covid -19, por në vazhdimësi do t'u mundësohet testimi edhe mësimdhënësve tjerë në bazë të nevojave.

Janë përgatitur materiale të ndryshme vetëdijësuese, si posterët për tre skenarët dhe masat mbrojtëse me qëllim të përcjelljes së mesazhit për ruajtjen e shëndetit tek nxënësit, mësimdhënësit dhe gjithë pjesëmarrësit në sistemin arsimor.

Janë shpërndarë 500 000 maska në të gjitha shkollat në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. MASH kemi qenë vazhdimisht në terren, dhe në kontakt të ngushtë me kryetarët e komunave dhe drejtorët e DKA-ve dhe janë vizituar 30 komuna, nga të cilat vizita është konstatuar gatishmëri e lartë nga ana e shkollave dhe DKA-ve për organizim të shkollave për mbajtjen e mësimin.

Në fazën fillestare të organizimit të mësimin në distancë (fillimi i pandemisë - përfundimi i vitit shkollor 2019/2020) një numër i nxënësve nuk kanë pasur mundësi kyçjeje. Kështu, në bazë të vlerësimeve dhe të dhënave statistikore nga MASH, numri i fëmijëve /nxënësve

që nuk kanë ndjekur mësimin nga distanca për vitin shkollor 2019/20 është 9070. MASH në bashkëpunim me DKA-të kanë evidentuar të gjithë nxënësit që nuk kanë pasur qasje në mësimin dhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë kanë siguruar pajisjet teknologjike në mënyrë që asnjë nxënës të mos mbetet jashtë procesit, si: pajisje në vlerë prej rreth 450,000 euro janë ofruar nga GIZ (këtu përfshihen laptop, projektorë, chromebooks dhe serverstations për shkollat kampion); pajisje në vlerë prej 426,000 euro janë siguruar nga BB për blerje të tabletëve; pajisje (tabletë) në vlerë prej rreth 1,139,000 euro janë siguruar nga MASH.

6.2 Gjithëpërfshirja dhe barazia në arsim

Edukimi i hershëm i fëmijëve mbetet në fokus edhe gjatë kësaj periudhe kohore. Platforma online “Edukimi në distancë - Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç, (e lansuar në prill 2020 në bashkëpunim me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë dhe Save the Children), vazhdon të jetë aktive. Gjithashtu, janë trajnuar 1543 edukatorë/e që punojnë në institucionet parashkollore dhe klasën parafillore për këtë platformë. Në bashkëpunim me komunitetin shëndetësor e edukativ është hartuar “Protokolli përmasat lehtësuese për fillimin e punës së institucioneve parashkollore në Kosovë”.

Ndërkohë, ka vazhduar krijimi i kushteve për arsim cilësor për të gjitha komunitetet në gjuhën e tyre amtare:

- *Janë përgatitur programet e lëndëve të përgjithshme të përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhë turke dhe boshnjake për publikim në ueb faqe të MASH për klasat 0, 1, 2, 3, 6, 7, 8, 10, 11 dhe 12;*
- *Janë hartuar programet mësimore për lëndët nacionale për komunitetet turq dhe boshnjak për klasat 4, 5 dhe 9, të cilat edhe do të publikohen në uebfaqe të MASH,*
- *Janë në proces të përkthimit edhe programet lëndore për lëndët e përgjithshme për klasat 4 dhe 9.*
- *Është proceduar për pagesë kësti i fundit i bursave nga Roma Education Fund (REF) për nxënësit e shkollave të mesme të larta për komunitetet RAE.*
- *Është publikuar njoftimi dhe platforma online për aplikim lidhur me regjistrimin e qendrave mësimore, ku aktualisht janë 11 aplikime.*
- *Është dhënë pëlqimi nga MASH për platformën Busulla.com që të bëhet shtrirja e platformës për edukim në këshillim dhe orientim në karrierë edhe te nxënësit e komunitetit serb.*

Në përkrahje të fëmijëve me nevoja të veçanta ka vazhduar popullimi i platformës: arsimigjithëpërfshirës.net me aktiviteteve mësimore dhe materiale didaktike, si dhe është finalizuar pakoja me dokumentet për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta. Poashtu janë mbajtur testet për avancimin e nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente.

Për realizimin sa më efikas të mësimin në kohë pandemie, janë përgatitur profesionalisht mësimdhënësit nëpërmjet trajnimeve që kanë të bëjnë me aspektet metodologjike për

përgatitjen dhe realizimin e e-mësimit (xhirimet), zbatimin e kurrikulës së re dhe platformat e zbatimit të mësimit në distancë (mësimdhënësit e arsimit special) Për më shumë, ka përfunduar trajnimi i drejtorëve komunalë, inspektorëve sanitarë, inspektorëve të arsimit dhe drejtorëve të shkollave për masat anti-COVID dhe ato higjienike nga IKSHPK-ja.

6.3 Arsimi profesional

Si pasojë e pandemisë ka pasur vështirësi të shumta në këtë fushë, për arsye të natyrës specifike të arsimit dhe aftësimit profesional (puna në laboratorë, punëtori, praktikat e ndryshme). Gjatë kësaj periudhe është formuar Këshilli për Arsim Profesional, është përgatitur UA për bursa për profile deficitare dhe vajzat në drejtime teknike (i cili ndodhet në diskutim publik) dhe është nënshkruar vendimi për bursa për vajzat në këto drejtime; ka filluar procesi i hartimit të materialeve mësimore për 4 profile teknike; është formuar grupi punues gjithëpërfshirës për qeverisjen e AAP dhe për rishikimin e strukturës, legjislacionit dhe politikave me qëllim të harmonizimit me tregun e punës; janë përkrahur Qendrat e Karrierës për të organizuar sesione informuese në internet për promovimin e AAP me 4.525 nxënës (45% femra) të klasës së 9-të, dhe 548 prindër; ka filluar puna në rishikimin e UA- Normativi për mësimdhënësit e AAP, është emëruar Këshilli për AAP, janë dorëzuar në shkolla planprogramet për 4 profilet (Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit, Metalpunues, Instalues Elektrik dhe Teknik i izolimit të ndërtesave), meqë ka pasur disa ndryshime, si dhe në vazhdimësi janë duke u shqyrtuar kërkesat për profile tjera. Në bashkëpunim me GIZ mësimdhënësit e AAP kanë zhvilluar kurse të përziera të mësimit për profilet ndërtimtari dhe mekatronikë, si dhe është prezantuar projekti i ri i GIZ “Fit for Jobs”. Ndërsa, Lux – Dev në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës kanë filluar projektin për ndërtimin e Qendrës së Kompetencës për ICT.

6.4 Arsimi i lartë

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar në arsimin e lartë dhe shkencë është punuar për finalizimin e procesit të bursave të Hungarisë, përfshirë informimin e aplikantëve për rezultatit dhe për procedurat e mëtejme për studime. Për bursat japoneze të studimit, është në proces të përgatitjes testi dhe intervista. Lidhur me bursat nga Ambasada e Francës, si dhe për bursat me Universitetin e Camerinos në Itali janë njoftuar studentët fitues Mobilitetet e programit CEEPUS janë të anuluar si pasojë e pandemisë. Kurse, në kuadër të bashkëpunimit me Universitetin e Sheffilldit janë proceduar pagesat për studentët.

MASH-i ka ndarë bursa për 1516 studentë elitarë për të gjitha fushat e studimeve të universiteteve publike për vitin akademik 2019/2020.

Nxënësit që kanë konkuruar për studime jashtë vendit u është mundësuar hyrja në Testin e Maturës (në sesion të veçantë) dhe janë shpallë rezultatet.

MASH ka iniciuar lidhjen e Marrëveshjes së bashkëpunimit dhe financimit të projektit HERAS + (arsimi i lartë, hulumtimi dhe shkencat aplikative në Kosovë) me Agjencinë Austriake për Zhvillim. Projekti do të përkrahë MASH dhe AKA në nivel të politikave dhe institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë. Në kuadër të programit ERASMUS +, në komponentin për ngritje të kapaciteteve të arsimit të lartë, institucionet e arsimit të lartë kanë përfutuar me tetë (8) projekte të reja, tri (3) prej të cilave do të koordinohen nga këto institucione të arsimit të lartë.

Janë shqyrtuar 4 statutet e 4 universiteteve publike (Universitetit të Mitrovicës, Universitetit të Gjilanit, Universitetit të Gjakovës dhe Universitetit të Ferizajit), të cilat do të procedohen në Qeveri për miratim.

Procesi i akreditimit institucional

Sipas rekomandimeve të ENQA, gjatë këtij viti vlerësimi i programeve akademike është bërë në distancë. Janë miratuar raportet e ekspertëve ndërkombëtarë, të angazhuar në këtë proces. Agjencioni i Kosovës për Akreditim ka pranuar 17 aplikacione për akreditim institucional, 5 universitete publike dhe 12 kolegje private. Prej këtij numri, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) ka refuzuar që të përfshijë në proces tri kolegje private për shkak të shkeljeve të afateve ligjore për akreditim. KSHC poashtu ka miratuar 52 standardet e reja të PhD-së: 36 standarde thelbësore dhe 16 plotësuese. Agjencioni është duke punuar edhe në hartimin e Udhëzuesit për Monitorim.

Infrastruktura arsimore

Me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për zbatimin e reformave në arsim janë në proces të ndërtimit 37 shkolla (3 prej tyre pritet të përfundojnë në shtator), 4 çerdhe (2 pritet të përfundojnë në shtator), 16 salla sportive (2 pritet të përfundojnë në shtator), 5 renovime të objekteve shkollore (4 pritet të përfundojnë në shtator), 3 projekte të furnizimit me inventar shkollor, pajisje të pakove sportive, si dhe pajisje për mirëmbajtje dhe fusha lëndore.

Po ashtu, është përgatitur dokumentacioni teknik për ndërtimin e 4 objekteve të reja shkollore, 4 çerdheve, 3 sallave sportive, 1 aneksi të shkollës, si dhe për renovime e funksionalizime të vazhdueshme të objekteve shkollore, kopshteve për fëmijë.

Në kuadër të projektit të Bankës Botërore për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit në Kosovë ka përzgjedhur ekspertin vendor për formulën e financimit dhe është dërguar te BB për aprovim; janë publikuar, janë hapur ofertat dhe është formuar komisioni për vlerësimi për: Modulin për nxënës në SMIA, Kartën e raportimit të shkollave, Regjistrin e nxënësve dhe Regjistrin e shkollave. Gjithashtu, grupi punues ka hartuar draft-UA për funksionalizimin, zyrtarizimin dhe shfrytëzimin e regjistrave, i cili do të finalizohet krahas zhvillimit të softuerit SMIA. Ndërsa, sa i përket Grantëve shkollore gjatë muajit qershor janë përgatitur dhe publikuar 80 shprehje të interesit për pakot e mallrave që kanë të bëjnë me blerjen e pajisjeve të ndryshme të IT, 109 shprehje të interesit për blerjen e mjeteve të ndryshme didaktike, si dhe është filluar me përgatitjen e 69 pakove me vlerë nën 1000 euro. Deri në fund të muajit korrik numri i pakove të dorëzuara në NJKP ka arritur në 278, prej të cilave 277 janë pako të mallrave dhe 1 pako për shërbime. Në mbështetje të UNICEF janë përkrahur me pako higjienike 600 shkolla, 2000 mësimdhënës dhe 7000 nxënës të klasave të para.

Në bashkëpunim me ASK është botuar (në tri gjuhë) dhe publikuar në ueb faqen e MASH-it “Statistikat e arsimit në Kosovë” për vitin shkollor 2019/2020. Në kuadër të projektit të Bankës Botërore për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit në Kosovë janë në fazën e vlerësimit ofertat për zhvillimin e moduleve: Moduli për nxënës në SMIA, Karta e raportimit të shkollave, Regjistri i nxënësve dhe Regjistri i shkollave.

Në fushën legislative MASH është në proces të hartimit të 6 projektligjeve: Projektligji për Tekstet dhe Mjetet Shkollore, Lektyrën Shkollore dhe Dokumentacionin Pedagogjik në Republikën e Kosovës; Projektligji për Edukimin Parashkollor – Edukimin në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç në Republikën e Kosovës; Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes me Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA); Projektligji për Ratifikimin e Plotësimit dhe Ndryshimit të Marrëveshjes së Programit Fulbright; Projektligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës; Projektligji për Agjencionin Kosovare të Akreditimit. Gjithashtu, MASH është duke bërë rishikimin e Rregullores për organizimin e brendshëm.

7. Shëndetësia

Pothuajse i gjithë angazhimi në këtë sektor është fokusuar në luftimin e Pandemisë COVID-19. Në këtë drejtim, janë ndërmarrë një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve me qëllim të përmirësimit të shërbimeve shëndetësore për qytetarët dhe përmirësimin e gjendjes në institucionet shëndetësore në përgjithësi.

Ministria e Shëndetësisë ka përgatitur dhe ka publikuar Manualin për mbrojtje nga përhapja e COVID-19, ka miratuar Planin e Veprimit për procedurat e testimit për COVID-19, është hartuar dhe miratuar Udhërrëfytyesi klinik për trajtimin e COVID-19 nga Ministria e Shëndetësisë dhe ekspertët shëndetësorë.

Nga programi farmaceutik për masat mbrojtëse për COVID-19 MSh ka shpenzuar 5,375,598.24 euro.

Aktivitete të realizuara në fushën e shëndetësisë janë:

- *Është siguruar furnizimi i qëndrueshëm për Kujdesin Parësor Shëndetësor me barna dhe material shpenzues nga Lista e Barnave Esenciale.*
- *Sigurimi i terapisë (përmes Project Hope) për pacientët me fibrozë cistike.*
- *Është themeluar Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike*
- *Është krijuar Bordi për Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike*
- *Është themeluar Komisioni për adaptimin e hapësirave të veçanta për menaxhimin klinik të rasteve me COVID-19.*
- *Është themeluar Ekipi Mbështetës i Zyrtarit Përgjegjës për hartimin e projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit Nr. 04/L125, për shëndetësi.*
- *Është marrë vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e statusit të Odës së Infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësor.*
- *Është formuar Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për provim të licencës së Psikologëve klinik dhe Psikologëve të profileve tjera.*

Në vazhdim janë përmbledhur masat dhe vendimet e MSh-së gjatë periudhës Qershor-Shtator 2020, ku vlejné të veçohen:

Me qëllim të lehtësimit të vendimmarrjes për çështje nga fushëveprimtaria e Ministrisë së Shëndetësisë janë krijuar trupa institucionale si në vijim:

- *Komiteti për koordinimin dhe vlerësimin e situatës emergjente me COVID -19 (përbërja e re);*
- *Komiteti i menaxhimit të lartë të Projektit të Shëndetësisë Kosovare (përbërja e re);*
- *Bordi Qendror për Shkollimin Specialistik;*
- *Bordi për Licencimin e Institucioneve Private Shëndetësore;*

- *Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave;*
- *Themelimi i Komitetit Drejtues për mbikëqyrjen e Zbatimit të projektit “Ndërtimi i Spitalit Pediatrik Kirurgjik” në QKUK dhe njësia zbatuese e saj;*
- *25 Komitete Specialistike të bazuara në Udhëzimin administrative 05/2017;*
- *Bordi Këshillues dhe për vlerësimin dhe propozimin e masave për menaxhimin dhe kontrollin e përhapjes së infeksionit COVID-19;*
- *Themelimi i Komisionit dhe Bordit për Programin e Trajtimit Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike;*
- *Është themeluar Bordi drejtues i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.*

Me qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore në fushën e shëndetësisë janë hartuar, plotësuar dhe ndryshuar disa akte nënligjore si:

- *Është miratuar Plani legjislativ për aktet nën ligjore për vitin 2020 në fushën e shëndetësisë;*
- *Udhëzimi Administrativ (në Shëndetësi) nr.01/2020, për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrative 09/2014 -kushtet për punë sa i përket hapësirës, kuadrit profesional dhe pajisjeve medicinale të institucioneve private shëndetësore jashtë spitalore;*
- *Është hartuar Udhëzimi Administrativ nr.02/2020 – Për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrative 06/2015 kushtet e përgjithshme dhe të veçanta spitalore;*
- *Është plotësuar/ndryshuar Udhëzimi Administrativ për Shkollimin Specialistik;*
- *Është miratuar Udhëzimi Administrativ (03/2020) për organizimin e Kujdesit Parësor Shëndetësor për mundësimin e testeve serologjike edhe në Komuna.*

Për ngritjen e kapaciteteve për luftimin e Pandemisë COVID-19 dhe në përgjithësi ofrimin e shërbimeve shëndetësore, janë ndër marrë këto aktivitete:

- *Kanë filluar punën 200 specialistë shëndetësorë të rekrutuar nga MSh: 100 mjekë, 62 infermierë, 20 inspektorë sanitarë, 4 mikrobiologë, 8 laborantë dhe 6 të tjerë-staf teknik e mbështetës;*
- *Është bërë shpallja publike e konkursit për 1034 specializime në mjekësi;*
- *Është bërë shpallja e konkursit plotësues për mjekët nga Lugina e Preshëvës dhe shërbimet e transfuzionit të gjakut (78 vende gjithsej);*
- *Është bërë shpallja e interesit për rekrutimin e 375 profesionistëve shëndetësor përmes rishikimit të Projektit të Shëndetësisë kosovare (punësim i përkohshëm), financuar nga huamarrja nga Banka Botërore;*
- *Është bërë porosia e 120 000 vaksinave të Gripit sezonal + 380 000 vaksinave kundër Gripit sezonal.*

Janë pranuar dhe koordinuar donacionet e renditura më poshtë:

- *Pranimi i donacioneve - Kontingjenti i katërt i mjeteve mbrojtëse profesionale dhe pajisjeve mjekësore nga asistenca prej 5 milionë eurove.*
- *10 autoambulanca, 100 shtretër spitalorë dhe pajisje të tjera mjekësore si dhe 50 respiratorë (20+30) të siguruar nga fondet e Qeverisë së Norvegjisë, Zvicrës dhe Luksemburgut.*
- *Ambasada Amerikane ka ndihmuar me pajisje mbrojtëse profesionale për personelin shëndetësor nga Programi i Ndihmës Humanitare i Komandës Evropiane të SHBA.*
- *Donatorë nga diaspora si kompanitë Ecolog, Euro-Kohadhe AWR Abbruchm e kanë ndihmuar IKSHPK-në me 12 mijë kite për teste për COVID-19.*
- *“Qatar Qarity” ka ndihmuar me 6500 teste dhe 6 respiratorë*
- *UNDP ka sjellë 6000 komplete teste në IKSHPK.*
- *Nga Jordania është pranuar kontingjenti 24 tonë pajisje mbrojtëse profesionale me 500 000 maska mbrojtëse dhe pajisje të tjera mbrojtëse.*
- *Janë pranuar 6000 teste RT-PCR nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës Federale të Gjermanisë.*
- *Më 24 gusht është pranuar kontingjenti i ndihmave nga UNICEF në vëllim prej 7.4 ton PPE, ndërsa në shtator vjen kontingjenti i radhës së ndihmave me pajisje mbrojtëse profesionale me mbi 37.4 tonë nga UNICEF*
- *Është nënshkruar marrëveshja me USAID-in për sjelljen dhe pranimin e 50 respiratorëve në Kosovë*
- *Janë siguruar 41 000 teste PCR donacion nga marrëveshja me Qeverinë e Dukatës së Madhe të Luksemburgut përmes Lux-Development S.A dhe marrëveshjes me Qeverinë e Austrisë përmes Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim në vlerë të përgjithshme prej 250.000 Euro.*
- *Janë përkrahur Personat me aftësi të kufizuara nga MSh me mjete mbrojtëse për luftimin e Pandemisë COVID-19*
- *Bashkëpunimi me partnerët si OBSH, UNDP, UNICEF, AQH, etj.*

Janë riorganizuar shërbimet shëndetësore, si:

- *Rikthimi në mobilizim të plotë i kapaciteteve të Klinikës së Pulmologjisë, të Klinikës së Dermatovenerologjisë dhe të Mjekësisë Sportive si asistencë për Klinikën Infektive për të përballuar fluksin më të lartë të pacientëve.*
- *Aktivizim i klinikave të tjera e reparteve infektive të spitaleve rajonale si në Gjilan, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj-Mobilizimi i rreth 700 shtretërve spitalor për COVID-19.*
- *Është bërë organizimi i Spitalit “Sheik Zayed” në Vushtrri për nevoja të COVID-19*
- *Ka filluar licencimi i ISHP-ve për testime molekulare dhe serologjike për COVID-19*
- *Është bërë dhurimi i Autoambulancave për Spitalet Regjionale nga donacionet e BE-së*

Në fushën e bashkëpunimit me organizata të ndryshme vendore e ndërkombëtare me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve në luftën kundër pandemisë COVID 19 janë ndërmarrë këto aktivitete:

- *Kontaktet me ministrat e rajonit rreth menaxhimit të pandemisë COVID-19;*
- *Koordinimi me BIK-un dhe Ipshekinë e Kosovës rreth masave anti COVID-19!*
- *Sigurimi i përkrahjes nga FSK (Spitali ushtarak i saj me rreth 100 shtretër).*
- *Është koordinuar puna me Komunitetet e Kosovës, për masat e ndërmarra për luftimin e COVID-19;*
- *Bashkëpunimi me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës për zbatim të Udhëzimit Administrativ 02/2019 për rregullimin e çmimit të barnave në Kosovë.*
- *Është hartuar Manualit në Alfabetin e Brajdit për Shoqatën e të verbërve dhe dhurimi i mjeteve mbrojtëse;*
- *Është realizuar takimi bashkëpunimi me ministren e Shqipërisë Ogerta Manastirliu me qëllim të shkëmbimit të përvojave të dy vendeve në luftën kundër pandemisë COVID-19;*
- *Janë takuar drejtuesit e mediave për bashkëpunim rreth zbatimit të Planit Strategjik të Komunikimit;*
- *Është realizuar vizita e punës në Luginë të Preshevës me qëllim të diskutimit të situatës me COVID 19 dhe specializimet e kuadrit nga Presheva (takime me kryetarët e këtyre komunave: Nagip Arifi e Shqiprim Arifi; me kryetarin e Këshillit Kombëtar Shqiptar, Ragmi Mustafa dhe kryetarët e PVD, Ardita Sinani e Ragmi Mustafa);*
- *Është realizuar vizitë punë në Komunën e Parteshit për diskutimin e situatës me COVID 19;*
- *Janë mbajtur kontakte me KE, OBSH e UNICEF lidhur me futjen në radhë për sigurimin e vaksinës kundër COVID-19 (në rast se e njëjta zhvillohet dhe aprovohet për përdorim).*

8. Bujqësia dhe zhvillimi rural

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkundër gjendjes së rënduar me pandeminë COVID-19, ka zhvilluar aktivitetet e saj në pajtim me Planin Vjetor të Punës për vitin 2020, si dhe dokumenteve tjera strategjike dhe sektoriale.

Legjislacioni në kuadër të bujqësisë

Është përgatitur Projektligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, dhe Projektligji për Pyjet. Gjatë periudhës raportuese MBPZHR ka aprovuar tri akte nënligjore:

- *Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) – NR. 01/2020 të datës 11.06.2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2010 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, të dt.41/2006;*
- *Udhëzimin Administrativ (MBPZHR)-NR.02/2020 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për Vitin 2020-2021, të datës 17.07.2020; dhe*
- *Udhëzimin Administrativ (MBPZHR)-NR.03/2020 për pagesa direkte në bujqësi për vitin 2020, të datës 17.07.2020.*

Të arriturat kryesore në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural

Është përgatitur dhe publikuar Programi për Zhvillim Rural 2020-21 si program vjetor i mbështetjes së fermerëve dhe agro përpunuesve në vend. MBPZHR, gjegjësisht DPZHR/AM, ka filluar përgatitjen e Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021-21. Programi BZHR 2021-27 është dokument kryesor që do të përcaktojë objektivat, prioritet dhe masat për zhvillimin e këtij sektori për periudhën e ardhshme shtatëvjeçare (2021-27).

Për më tepër, është publikuar thirrja e aplikimit për fermerët, agro-përpunuesit dhe bizneset rurale për këto masa të Programit të Zhvillimit Rural 2020/21:

MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore: a) Sektori 101 - Pemë drufutrore, b) Sektori 101.1.1 - Pemë arnore, c) Sektori 101.2 – Serra;

MASA 103: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore: a) Sektori 103.1- Përpunimi i qumështit b) Sektori 103.2- Përpunimi i mishit c) Sektori 103.3- Përpunimi i pemëve dhe primeve d) Sektori 103.4- Prodhimi i verës;

MASA 302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve: a) Nën-masa 302.1 – Bletaria prodhimi promovimi i mjaltit, b) Nën-masa 302.3 – Përpunimi i prodhimeve në fermë, c) Nën-masa 302.4 – Zhvillimi i aktiviteteve artizanale, d) Nën-masa 302.7 – Rritja e shpezëve për vezë dhe për mish; dhe

MASA: Ujitja e tokave bujqësore.

Aplikimi është bërë përmes platformës online për të gjitha masat dhe nënmasat e PZHR 2020-21. Aplikimi ka filluar nga data 20.07.2020 dhe është zgjatur deri me datën 28.08.2020. Aplikimet deri më datë 24.08.2020 janë paraqitur në tabelën mëposhtë.

Tabela 2

| | Nën-Masa | Nr. i Aplikacioneve | Vlera e Aplikuar |
|----|--|---------------------|----------------------|
| 1 | 101.1 Pemë drufrutore | 215 | 14,923,435.00 |
| 2 | 101.1.1 Pemë arvore (arra, lajthia) | 117 | 6,402,340.25 |
| 3 | 101.2.1- Sektorin e perimeve dhe serrave | 311 | 14,204,336.54 |
| 4 | 103.1 Përpunimi i qumështit | 7 | 1,892,489.05 |
| 5 | 103.2 Përpunimi i mishit | 13 | 4,653,440.10 |
| 6 | 103.3 Përpunimi i pemëve dhe perimeve | 23 | 8,471,814.77 |
| 7 | 103.4 Prodhimi i verës | 3 | 1,195,753.40 |
| 8 | 302.1. – Prodhimi i mjaltit | 181 | 3,550,740.84 |
| 9 | 302.3. – Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare | 42 | 838,550.41 |
| 10 | 302.4. – Zhvillimi i aktiviteteve artizanale | 54 | 1,611,000.73 |
| 11 | 302.7. - Rritja e shpezëve për vezë dhe për mish | 91 | 1,781,687.49 |
| 12 | Masa për ujitjen e tokave bujqësore | 5 | 970,969.62 |
| | Totali: | 1,062.00 | 60,496,558.20 |

Është përgatitur dhe publikuar edhe Programi i Pagesave Direkte 2020, nëpërmjet të cilit prioritet në subvencionim iu është dhënë 3 sektorëve të bujqësisë: drithërave, hortikulturës dhe blegtorisë me gjithsej 26 nënsektorë të tyre. Gjithashtu, është publikuar thirrja për aplikim për Pagesa Direkte 2020. Procesi i aplikimit ka filluar në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës dhe është monitoruar procesi i aplikimit në vazhdimësi. Deri më datë 24.08.2020 kanë aplikuar rreth 27000 fermerë. Tutje, ka filluar shqyrtimi administrativ i aplikacioneve për Pagesa Direkte. Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar rreth 1000 aplikacione dhe është vazhduar për kontroll në vend-ngjarje. MBPZR/AZHB ka vazhduar kontrollin e dytë në terren të përfutuesve nga viti 2019, si dhe aktivitete të tjera në vazhden planifikimeve për kontroll në vend-ngjarje të aplikacioneve për PD nga viti 2020.

Është realizuar edhe monitorimi i procesit të korrje-shirjeve të drithërave të bardha. Këtë vit janë korrur rreth 6300 ha me drithëra të bardha dhe rendimenti ka qenë më i larti në 10 vjetët e fundit me 4650 kg/ha.

Për më tepër, ka përfunduar zbatimi i Projektit 3-vjeçar “Dezinsektimi i hapësirave të ekspozuara për ethe hemorragjike për fshatrat e Komunës së Malishevës”, ku, për tre vjet sa ka zgjatur projekti, janë spërkatur mbi 1200 ha, me qëllim të desinsektimit.

Ndërkohë, ka filluar implementimi i projektit “Zbatimi i punimeve rehabilituese në sistemin e ujitjes në kuadër të kompanisë Radoniqi-Dukagjini”, projekt i financuar nga Banka Botërore. Gjithashtu, janë regjistruar 32 Produkte për Mbrojtjen e Bimëve (PMB), për të cilat janë nxjerrë vendimet, janë lëshuar certifikatat e regjistrimit dhe janë futur në regjistrin e PMB-ve, ku lejohen të importohen, tregtohen dhe përdoren në Republikën e Kosovës.

Është finalizuar edhe raporti për vitin 2019 i FADN-së, gjithashtu është përmbyllur projekti 3-vjeçar 2017-2020 për mbledhjen e të dhënave të FADN-së dhe ndërtimin e sistemit

8.1. Sistemi i integruar informativ bujqësor (SIIB)

Janë sistemuar skemat e çmimeve të tregut, pagesave direkte dhe skema e vreshtave, si dhe skema për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, e cila raportohet nga AUV.

Gjatë kësaj periudhe janë bartur edhe të dhënat e eksportit dhe importit të marra nga ASK, në bazën e të dhënave për periudhën janar-qershor 2020. Gjithashtu, janë gjeneruar raportet për vitin 2019 për eksportin dhe importin e përgjithshëm (1-98), eksportin dhe importin për produktet bujqësore (1-24) dhe eksportin dhe importin e produkteve bujqësore sipas grupeve të shteteve të BE-së, CEFTA-as dhe vendeve të tjera. Që të gjitha këto raporte janë pagatitur për vlerë dhe sasi.

Janë përgatitur të dhënat statistikore për vitin 2019, për sipërfaqet, prodhimtarinë dhe rendimentin e kulturave bujqësore për pemë, perime dhe drithëra. Ndërsa sa i përket sektorit të blegtorisë janë përgatitur të dhënat për fondin dhe strukturën e gjedheve, numrin i dhenve dhe dhive, numrin e derrave dhe kafshëve të tjera të fermës, numrin e shpezëve dhe vezëve dhe numrin e koshereve të bletëve.

Gjithashtu, janë përgatitur bilancet e furnizimit për kulturat, si: molla, kumbulla, dredhëza, rrushi, patate, domate, spec dhe bilancet e furnizimit për mish të gjedhit, për qumështin dhe produktet e qumështit të lopës, për mishin e dhenve dhe dhive.

Është përgatitur analiza e sektorit dhe pengesave strukturore për vitin 2019, për sektorin e bujqësisë, që do të jetë pjesë e Programit të Reformës Ekonomike PRE 2021-2023.

8.2. Vreshtaria dhe verëtaria

Në këtë sektor kanë vazhduar aktivitetet sipas protokollit II të MSA-së duke asistuar dhe ofruar bashkëpunim profesional me SHVK “Enologjia” në aplikimin për Emërtimin e Origjinës së Mbrojtur dhe Treguesve Gjeografikë “Rahoveci”.

Në regjistrin e Vreshtave janë regjistruar edhe 112 ha me vreshta të rinj me gjithsej 170 raste të kërkuara nga fermerët vreshtarë, pastaj është realizuar certifikimi zyrtar i verës nga vjelja e vitit 2019. Janë certifikuar 99 lloje të verës prej tyre 48 verëra cilësore, 46 kulminante, 4 tipe të verës janë vlerësuar sipas skemës po/jo dhe një tip verë tryeze. Janë lëshuar njëqind e dy (102) dokumente VI – 1 për eksportin e verës në vendet e BE-së. Janë realizuar pesëdhjetë e dy (52) analiza fiziko – kimike në verë dhe janë realizuar tetë (8) analiza fiziko – kimike në pije alkoolike.

Gjithashtu, është hartuar Drafti për Strategjinë e Vreshtarisë, Verëtarisë dhe rrushit të tryezës 2021 – 2025 së bashku me planin e veprimit.

8.3. Promovimi i prodhimit të bujqësore

Është përgatitur kampanja informative dhe publiciteti, përgatitja e thirrjes për aplikim, posterëve, banerëve, spoteve informuese, fletëpalosjeve dhe udhëzuesve për fermerë.

Është përgatitur publikimi “Kultivimi i grurit dhe misrit në Kosovë, 1939-2019” dhe publikimi “Bujqësia në shifra 2019”. Gjithashtu, është publikuar në ueb-faqe publikimi për “Çmimet e produkteve bujqësore në Kosovë 2017-2018”.

8.4. Siguria Ushqimore Veterinaria dhe Fitosanitaria

Sa i përket Drejtorisë së Inspektoratit, në veçanti Inspektoratit Sanitar, i tërë kontrolli ka qenë i fokusuar në monitorimin e zbatimit të masave kundër COVID-19.

Spektori Sanitar ka qenë së bashku me Policinë e Kosovës dhe inspektorët e IKSHP-së në vijën e parë të frontit me ballafaqimin, kontrollimin dhe monitorimin e situatës në terren sa i përket respektimit të zbatimit të masave për mbrojtje nga COVID-19. Gjatë kësaj periudhe në numra janë kryer:

1. *Numri inspektimeve: 14,095*
2. *Shqiptimi i gjobave për persona fizik: 2,037*
3. *Shqiptimi i gjobave për persona juridik: 519*
4. *Vendimet për izolim: 2,289*
5. *Vendimet për dalje nga izolimi: 968*
6. *Mbikëqyrja e procedurave të varrimit: 274*
7. *Asgjësimit në kg: 127,242*

Inspektorati Veterinar Kufitar ka kryer aktivitetet e kontrollit kufitar sa i përket mallrave me origjinë shtazore:

1. *Lejet e importit: 48*
2. *Verifikimi i Kontejnerëve: 88*
3. *Bashkëndimi i punëve në PIK*
4. *Inspektime: 941*

5. *Kafshe për therrje: 2597 krerë*
6. *Analiza: 25 në total, pozitive nuk ka*
7. *Asgjësime, nuk ka.*
8. *Refuzime, sipas vendimit 01/37 datës 30.05.2020: 1 nga Serbia*

Nga ana e inspektoratit të brendshëm Veterinar gjatë periudhës Qershor-Gusht, kemi pasur gjithsej:

1. *680 inspektime*
2. *Janë asgjësuar 60,945 kg produkte ushqimore me origjinë shtazore, si dhe*
3. *Janë iniciuar 36 raste për kundërvajtje në gjykatën kompetente*

Poashtu, kemi pasur asgjësime të kafshëve si:

1. *95 dele dhe dhi të rezultuara pozitive ne brucelozë dhe TBC si dhe*
2. *111 shoqëri të bletëve në sëmundjen infektive Pesta Amerikane*

Spektori Fitosanitar i brendshëm ka realizuar këto aktivitete:

1. *Inspektimi i barnatoreve bujqësore: 58*
2. *Inspektimi i tregtuesve me material fidanor: 28*
3. *Inspektimi i mullinjve dhe depove të drithërave: 5*
4. *Inspektimi i prodhimit me material fidanor-pemor: 18*
5. *Inspektimi fushor i prodhimit të farës: 177*
6. *Inspektimi i prodhuesve Tregtuesve të pijeve alkoolike: 1*
7. *Inspektimi i prodhuesve të pijeve jo alkoolike: 9*
8. *Inspektimi i Depove -Barnatoreve të pesticideve: 18*
9. *Inspektimi i depove të plehrave artificiale dhe farëra: 54*
10. *Inspektimi i tregtuesve ushqimor: 42*
11. *Asgjësime: 7*
12. *Debllobimet: 19*
13. *Pëlqimi për Licencim: 63*
14. *Inspektimi i jashtëzakonshëm: 3*
15. *Inspektime të tjera: 50*
16. *Nr. Procesverbaleve të inspektimit: 370*
17. *Nr. Procesverbaleve të mostrimit: 298*
18. *Nr. Mostrave për Analizë: 320*
19. *Vendime të lëshuara: 5*
20. *Nr. Fletparaqitjeve të lëshuara: 7*
21. *Lëshimi i fitocertifikatave për eksport: 476*
22. *Lëshimi i fitocertifikatave për ri-eksport: 92*
23. *Lëshimi i fitocertifikatave të brendshme: 1*
24. *Çertifikatat: 971*
25. *Asgjësimi i produkteve me prejardhje bimore: 53,795.00 kg.*

Sektori i kontrolleve Fitosanitare Kufitare ka kryer aktivitetet si vijon:

1. *Inspektime fitosanitare kufitare: 10892*
2. *Sasia e mallit të kontrolluar: 239288 Ton*
3. *Mostra në produkte të ndryshme dhe për parametra te ndryshëm: 197*
4. *Leje importi për cigare dhe produkte të duhanit: 5*

Në Sektorin e higjienës se ushqimeve me prejardhje jo-shtazore për periudhën Qershor-Gusht 2020 janë lëshuar 20 vendime të regjistrimit:

1. *Grumbullues dhe përpunues te pemëve dhe perimeve: 13*
2. *Furra buke: 2*
3. *Prodhues te pijeve alkoolike-vere, raki, birre: 4*
4. *Prodhues te pijeve jo alkoolike: 1*

Sa i përket aprovimit të operatorëve të biznesit me ushqim me prejardhje shtazore si në vijim :

1. *Objekte për grumbullim dhe përpunim te qumështit – QUMËSHTORE: 1 leje e përkohshme 3 muaj dhe 1 aprovim*
2. *Objektet për përpunim të mishit – FPM: 1 aprovime të përkohshme (3 muaj) dhe 2 aprovime*
3. *Objekte për ruajtjen e ushqimit ne kushte të temperaturave te kontrolluara – DEPO FTOHËSE: 1 aprovim*

Gjatë periudhës raportuese ne Laboratorin e Ushqimit dhe Veterinarisë, numri i mostrave të pranuar dhe analizuara nëpër sektorë është si vijon:

1. *Kimia Ushqimore dhe mbetjet e Barnave Veterinare: 96*
2. *Mikrobiologjia Ushqimore: 86*
3. *Analizat e qumështit: 4746*
4. *Serologjia dhe diagnostika molekulare: 4504*
5. *Bakteriologjia dhe Mykologjia: 41*
6. *Patologjia: 13*

Nga Drejtoria e Shëndetit Publik dhe Mirëqenies së Kafshëve

Është përcjellë situata epizootologjike lidhur me prezencën e sëmundjeve të kafshëve për gripin e shpezëve AI dhe Mortajën Afrikane të Derrit ASF dhe sëmundjet e tjera të kafshëve duke u bazuar në informatat dhe raportet e OIE-së dhe nga SANTE –ADNS. Përgatitja e ndalesës së importit nga shteti i Maqedonisë së Veriut, për shkak të prezencës së sëmundjes “gjuha e kaltër”, Bluetongue.

SSHK-ja ka proceduar 50 lëndë për pagesë për vaksinim, ekzaminimin e gjakut, kompensimin e fermerëve dhe asgjësimin e kafshëve pozitive. Shpërndarja e materialit shpenzues, fillimi i hipersenzibilizimit të gjedheve për sëmundjen e TBC-së.

SSHK-ja ka shpërndarë materialin shpenzues për praktika veterinare të kontraktuara për fillimin e hipersenzibilizimit të gjedheve për sëmundjen e TBC. Gjithsej janë të shpërndara 20,000 doza tuberkulin Avium dhe tuberkulin Bovine për kryerjen e këtij aktiviteti në terren. Gjithashtu, është bërë licencimi dhe vazhdimi për tri (3) ambulancave veterinare, lëshimi i 47 lejeve të importit për kafshë të gjalla, ushqim për kafshë dhe material gjenetik, si dhe marrja e 7751 mostrave sipas planit të mostrimit, kufomave të kafshëve të ngordhura, gjak etj., nga terreni kur kemi prezent apo dyshimet për prezencën e ndonjë sëmundjeje të kafshëve dhe dërgimi i mostrave në LVK ose Laboratorët Referente për analiza laboratorike; asgjësimi i 176 kafshëve të cilat kanë reaguar pozitiv në sëmundjet infektive. Në terren ka patur aktivitete për përcjelljen e situatës për monitorimin e sëmundjes Gjuha e kaltër (BTV), takimi me veterinarët dhe fermerët, marrja e mostrave nga kafshët e dyshimta, dërgimi në LUVK për analiza laboratorike. Gjithsej janë dërguar 87 mostra, prej tyre 69 mostra kanë dalë pozitive.

Sektori i Produkteve Medicinale Veterinare

1. *Revidimi i certifikatave për Autorizim Marketing*
 2. *Është përpiluar lista e PMV dhe publikimi në ueb faqen e AUV-së*
 3. *Gjurmueshmëria e aplikimit dhe distribuimit të PMV nga distributori deri tek vendi i aplikimit.*
-

Sektori i Mirëqenies së kafshëve

1. *Përgatitja e draft udhëzimit për Pet Shope, mbarshtrimin (kultivimin) dhe shitjen e kafshëveshtëpiake- shoqëruese si pjesë e grupit punues.*
 2. *Fillimi i projektit menaxhimi dhe kontrolli i qenve endacak, monitorimi i projektit.*
 3. *Janë bërë inspektimet për licencimin e subjekteve me shërbime veterinare në mbarë territorin e Kosovës si pjesë e komisionit të formuar nga Drejtori Ekzekutivi AUV-së.*
-

9. Infrastruktura rrugore dhe hekurudhore

Në kuadër të masave lehtësuese ndaj pandemisë COVID-19, Qeveria ka marrë vendim për t'i liruar nga pagesa-tarifa administrative operatorët e transportit rrugorë të udhëtarëve me autobus. Ky vendim përfshin periudhën 3-vjeçare, 2020-2023, që operatorët i liron nga pagesa e rrendeve të udhëtimit, duke ua lehtësuar problemet financiare që u janë shkaktuar nga pandemia.

Qeveria, bazuar në rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditorit, ka marrë vendim për shkarkimin e “Njësive Zbatuese të Projekteve”, për shkak se gjatë themelimit të tyre ishin anashkaluar kërkesat ligjore. Bazuar në rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditorit është



Ministria e Infrastrukturës, bashkë me Infrakos-in, kanë vendosur një laurë për sinjalizimin e kalimit të trenit në fshatin Grabovc të Fushë Kosovës. Abrashi bëri të ditur se për ta rritur sigurinë në komunikacion, Ministria e Infrastrukturës bashkë me institucionet tjera kanë themeluar edhe një Task-Forcë që ka për qëllim sigurinë në rrugë dhe evidentimin e akseve të rrezikshme.

themeluar Njësi Zbatues i Projekteve, pasi që është aprovuar nga Ministria e Financave dhe sipas kërkesave ligjore.

Është marrë vendimi për themelimin e Trupit drejtues ndërministror për zhvillimin e projekteve madhore infrastrukturore, i cili është miratuar në Qeveri.

Është punuar në hartimin e projekteve si në vijim: Zgjerimi i rrugës R101(Mitrovicë - Pejë), segmenti Mitrovicë - Skenderaj; Projekti për zgjidhjen e pjesës së rrugës dhe murit mbrojtës në Veternik; Hartimi i projektit për zgjerimin e rrugës N25 - segmenti Prishtinë - Rrethrotullimi Besi; Hartimi i projektit për zgjerimin e rrugës N2 –QMI deri në hyrje të Lipjanit; Hartimi i projektit të rrugës ‘A’- K. Prishtinës; Punimi i detyrës projektuese për Hartimin e projektit zbatues për zgjerimin me katër shirita të rrugës nacionale Mitrovicë - Laposaviq- Kufiri me Serbinë. Gjithashtu, kanë përfunduar përgatitjet dhe janë iniciuar kërkesat për fillim të procedurave të prokurimit për projektet Ndërtimi i urës në rrugën nacionale N9, segmenti Pejë - Kuqishtë, lokacioni Drelaj dhe projekti Rregullimi i ndriçimit në autostradën Morinë - Merdar R7.

Më datë 4. 8. 2020 është publikuar shprehja e interesit në (OJEU) Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe në ueb-faqen e INFRAKOS-it për përzgjedhjen e kompanisë mbikëqyrëse, e cila do të mbikëqyrë punët gjatë rehabilitimit të fazës së dytë për linjën hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë).

Është në përfundim e sipër projekt dizajni preliminar për linjën e 7-të hekurudhore (Fushë Kosovë – Podujevë – Kufiri me Serbinë). Studimi i fizibilitetit për linjën hekurudhore për Shqipëri (Prizren – Durrës) është njëri ndër projektet me interes të veçantë për Kosovën, Shqipërinë dhe rajonin. Studimi i fizibilitetit është duke u realizuar edhe për linjën hekurudhore (Prishtinë - Aeroporti i Prishtinës).

Në sektorin e aviacionit civil, është emëruar Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil. Gjithashtu, hapur Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, pas lehtësimit të masave si pasojë e COVID-19, si dhe janë ndërmarrë veprime për masat mbrojtëse në aeroport në funksion të parandalimit të përhapjes së COVID-19.

Në periudhën qershor – gusht 2020 janë pranuar pesë (5) ankesa të avioudhëtarëve të cilat kanë marrë përgjigje, legjislacionit për të drejtat e avioudhëtarëve. Gjatë kësaj kohe janë aprovuar këto kërkesa për operime ajrore për/ nga ANP:

-
- *Aprovime për operime ajrore të rregullta → 01*
 - *Aprovime për operime ajrore Ad Hoc → 43*
-

Gjatë kësaj periudhe ka pasur operime ajrore në Aeroportin Ndërkombëtarë të Prishtinës “Adem Jashari” si në vijim:

-
- *Kanë operuar → 18 Avio Kompani*
 - *Kanë operuar → 37 Destinacione /krahasuar me vitin 2019 24 % ↓ ulje*
 - *Janë zhvilluar → 1.686 Operime Ajrore/krahasuar me vitin 2019 67 % ↓ ulje*
 - *Frekuentimi i Avio Udhëtarëve → 690.135/krahasuar me vitin 2019 73 % ↓ ulje*
-

Në sektorin e automjeteve është punuar kryesisht në kompletimin e infrastrukturës ligjore e cila është në funksion të sigurisë në komunikacion rrugor. Pas vlerësimit ex-post të Ligjit për Patentë Shofer ka filluar iniciativa për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimeve administrative. Sa i përket infrastrukturës ligjore janë caktuar 27 grupe punuese për hartimin e ligjeve dhe udhëzimeve administrative sipas planit legjislativ 2020.

Sa i përket infrastrukturës ligjore gjatë kësaj periudhe është Miratuar Planin Legjislativ për aktet nënligjore për vitin 2020, i Ministrisë së Infrastrukturës, janë caktuar zyrtarët përgjegjës dhe janë formuar 27 grupe punuese për hartimin e ligjeve sipas Programit Legjislativ të QRK-së dhe akteve nënligjore sipas Planit Legjislativ 2020 të MI-së.

Është Hartuar Draft Udhëzimi Administrativ për Vendorsjen e Panove Reklamuese në Autoudhë, Rrugë Nacionale dhe Rajonale, ka përfunduar procedura e konsultimit paraprak ,tani pritet të dërgohet në konsultim publik.

Sa i përket Programit për Vlerësim Ex-Post të Legjislacionit në fuqi të MI ,është emëruar Grupi Punues për Vlerësim Ex-Post të Ligjit Nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor.

Në lëminë e automjeteve gjatë periudhës raportuese janë licencuar dhe kanë përtrirë licencat 54 auto shkolla. Njëherit pas publikimit të njoftimeve lidhur me aplikimet e kandidatëve për ligjerues profesional, shoferë instruktorë dhe pyetës, janë pranuar përmes postës elektronike 345 aplikacione për shoferë instruktorë, 174 aplikacione për licencim dhe rilicencim për ligjerues profesional, si dhe jemi në proces e sipër të pranimit dhe kontrollimit të aplikimeve të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për pyetës. Gjithashtu është bërë përtëritja e licencave të 3 Qendrave të Kontrollave Teknike të Automjeteve.

Sa i përket patentë shoferit gjatë kësaj periudhe janë testuar gjithsej 8662 kandidat në pjesën teorike, ku provimin e kanë kaluar 6090 e konvertuar në përqindje 70%, ndërsa në pjesën praktike janë testuar gjithsej 3073 ku provimin e kanë kaluar 2606 që i bie 84%. Është nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me MPB, për mbikëqyrjen profesionale dhe pjesëmarrje në provimet për shofer. Gjithashtu, kanë filluar edhe përgatitjet për testimin elektronik të testeve për shofer.

Në fushën e menaxhimit të rrugëve nacionale dhe regionale është duke u punuar në rrugët e kategorisë nacionale, rajonale dhe lokale. Është punuar në 21 projekte të rrugëve nacionale me një gjatësi prej 54.33km në total. Në rrugët rajonale është punuar në 11 projekte rrugore gjithsej 96.10km, ndërsa është punuar në 77 projekte të rrugëve lokale me një gjatësi të përgjithshme prej 77km. Në kuadër të menaxhimit të rrugëve nacionale dhe regionale, gjatë kësaj periudhe është punuar edhe në vendosjen e sinjalizimit vertikal në shtatë (7) rajone respektivisht katërbëdhjetë (14) nën-rajone të Kosovës. Përveç sinjalizimit vertikal, nga fillimi i muajit qershor kanë filluar edhe aktivitetet në sinjalizimin horizontal. Punët në sinjalizim vertikal dhe horizontal dhe pajisje rrugore janë kryer në pesë (5) Lote apo 912 (km) rrugë Nacionale dhe Rajonale. Ndërsa në rrugët tjera nuk ka pas aktivitet (progres) për shkak që dy (2) Lote ende nuk kanë kontrata. Poashtu është bërë mirëmbajtja e Autoudhëve R6 dhe R7 në një gjatësi prej 148km.

Në lëmin e inspektimit, që ka për qëllim mbikëqyrjen e implementimit të legjislacionit në fuqi në fushat që janë kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës, gjatë periudhës raportuese në fushën e transportit rrugor janë realizuar inspektime të operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, stacionet e autobusëve, inspektimet e operatorëve ekonomik për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve nacionale dhe regionale dhe gjendja e rrugëve tona në përgjithësi, si dhe inspektimet e qendrave të kontrollimit teknik të automjeteve dhe autoshkollave. Inspektimi gjatë kësaj kohe më tepër ka qenë i fokusuar në zbatim të Vendimit të Qeverisë me nr. 01/10 të dt. 05.07.2020 përkatësisht pika 10 dhe 12, lidhur me masat anti COVID - 19 në lëmin e transportit rrugor të udhëtarëve. Gjatë kësaj kohe kemi inspektuar në bashkëpunim edhe me Inspektoratin Sanitar, gjithashtu çdo javë raportojmë për masat anti-COVID - 19 në Ministrinë e Shëndetësisë në lëmin e transportit rrugor të udhëtarëve. Gjatë kësaj kohe kemi inspektuar transportin vendor dhe ndërkombëtar të udhëtarëve në bashkëpunim edhe me Inspektoratin Sanitar dhe Policinë e Kosovës. Çdo javë raportojmë për masat anti-COVID - 19 në Ministrinë e Shëndetësisë në lëmin e transportit rrugor të udhëtarëve. Inspektimet kanë rezultuar edhe me masat e ndërmarra administrative dhe kundërvajtëse si në vijim:

Në total në transportin rrugor janë ndërmarrë 881 inspektime me procesverbale. Inspektimet kanë rezultuar edhe me masat e ndërmarra administrative dhe kundërvajtëse si në vijim:

- *Inicime në gjykata për kundërvajtje 21;*
- *Sanksione kundërvajtës (gjyba mandatorë) 28;*
- *Vendime për eliminimin e parregullsive 63,*
- *Vendime për ndërprerjen e punës 17.*

Në lëmin e sigurisë rrugore, nga ana e sektorit kompetent të Ministrisë është bërë finalizimi i raportit të Dekadës për siguri rrugore i cili raport përfshin periudhën 10 vjeçare të aksidenteve

në Republikën e Kosovës. Po ashtu, është bërë finalizimi i vendimit lidhur me identifikimin e akteve rrugore më të rrezikshme, sidomos atyre me fatalitet dhe lëndime serioze.

Së bashku me Policinë e Kosovës, është krijuar grupi i cili ka identifikuar pikat e zeza dhe Ministria ka filluar intervenimin në këto akte rrugore me qëllim të parandalimit, si ndërtimi dhe rehabilitimi i rreth-rrotullimeve, nënkalimeve, sinjalizimit e ndriçimit sipas kërkesave. Është punuar dhe zbatuar fushata “Ditët e sigurisë rrugore” në bashkëpunim me organizata evropiane. Janë nënshkruar memorandume përmes së cilave, Komunave të Kosovës iu janë projektuar të ndryshme për implementim.

Gjithashtu, është filluar dhe janë bërë përgatitjet për shpalljen e tenderit për ndërtimin e autostradës nga Gjilani deri në Dheu i Bardhe, projekt ky që tejkalon shumë prej 100 mil euro. Në kuadër të ekzekutimit të huamarrjes nga BERZH-i, ka filluar ekzekutimi i punimeve në hyrje të qytetit të Gjilanit. Gjithashtu, në kuadër të ekzekutimit të huamarrjes nga Fondi Saudit dhe Banka Islamike, janë hapur punimet në segmentin Gojbulë – Lumë i Bardhë, si pjesë e aksit Prishtinë – Mitrovicë.

Gjatë kësaj periudhe janë ideuar dhe paraqitur projektet të cilat janë paraqitur gjatë dialogut në Uashington, me c’rast janë nënshkruar edhe zotimet e Qeverisë së Kosovës, për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike mes Kosovës dhe Serbisë, sipas kësaj projektet të cilat janë paraqitur, në takime të ndara për financim janë:

-
- *Autostrada Besi – Merdare*
 - *Hekurudha Prishtinë – Merdare*
 - *Hekurudha Prishtinë – Porti i thelle në Adriatik*
 - *Stacioni Multimodal në Prishtinë*
 - *Autostrada Lipjan – Qafa Duhljes*
 - *Projekti i Brezovicës-*
-

10. Mbrojtja dhe siguria publike

Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës në bashkëpunim me institucionet e tjera për mbrojtjen dhe sigurinë publike të qytetarëve ka zhvilluar dhe realizuar aktivitete të ndryshme, duke pasur parasysh edhe luftën kundër COVID 19.

10.1 Ministria e Mbrojtjes/Forca e Sigurisë së Kosovës

Qeveria e Republikës së Kosovës është angazhuar që edhe gjatë kësaj periudhe të trajtojë me prioritet sektorin e mbrojtjes dhe sigurinë. Në bashkëpunim me institucionet e tjera, ka vazhduar hartimi i strategjive dhe politikave kryesore, me qëllim të përfundimit të dokumenteve strategjike dhe atyre planifikuese. Në këtë drejtim, janë hartuar draftet e Strategjisë së mbrojtjes dhe Strategjisë së burimeve njerëzore, ndërsa është formuar grupi punues ndërinstitucional për hartimin e Strategjisë shtetërore për siguri kibernetike.



Gjithashtu, ka vazhduar hartimi i politikave sipas planit vjetor, si në vijim: Politika e Zhvillimit të Inteligjencës, Politika për Planifikim, Programim, Buxhetim dhe Ekzekutim, Politika për Standardizim në FSK, e Modernizimit në FSK, Politika e Vlerësimit dhe Menaxhimit të Rrezikut për sistemet e TI-së etj.

Me qëllim të kompletimit të paketës ligjore për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, ka vazhduar plotësimi i ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Deminim Humanitar, është proceduar për miratim në qeveri më datë 21. 8. 2020. Gjithashtu, janë draftuar Koncept dokumenti për dërgimin e FSK-së jashtë vendit dhe Koncept Dokumenti për Policinë Ushtarake, ndërsa për fushën e komponentit rezervë të FSK-së dhe fushën e shërbimit obligativ ushtarak janë nxjerrë vendimet dhe janë krijuar ekipet punuese për hartimin e koncept dokumenteve.

Edhe në këtë fazë ka vazhduar Plani Gjithëpërfshirës i Tranzicionit (PGJT), janë mbajtur kapacitetet ekzistuese në njësitë e caktuara, si dhe ka vazhduar ngritja e njërive, aftësive dhe kapaciteteve sipas prioriteteve në PGJT pa ndonjë ngecje të theksuar.

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe përfaqësimi diplomatik

Gjatë kësaj periudhe është realizuar takimi i Drejtorëve të Politikave nga MPJ dhe MM në kuadër të iniciativës A5 SHBA – Karta e Adriatikut (Video-konferencë). MM ka marrë ftesën nga Ministria e Mbrojtjes e Sllovenisë për pjesëmarrje në Central European Defence Cooperation (CEDC). Gjatë

kësaj periudhe, përkundër ndikimit të pandemisë Covid-19, ka vazhduar bashkëpunimi me intensitet të lartë me shtetet partnere.

Gjithashtu, është bërë iniciimi i rishikimit të Marrëveshjes në Fushën e Mbrojtjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, e cila pritet të nënshkruhet në takimin e përbashkët ndërmjet dy qeverive. Është iniciuar Marrëveshja Teknike për Kadetë me Kroacinë, gjithashtu është përgatitur drafti final për marrëveshjen me Turqinë (për shkëmbim personeli). Nga MPJ-ja janë nxjerrë vendimet për vazhdimin e mandatit të Atasheve të Mbrojtjes së Republikës së Kosovës të akredituar në Berlin, Ankara, Uashington dhe Bruksel deri më 16. 7. 2021.

Sa i përket bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, janë ndërmarrë veprime për iniciativa të reja për bashkëpunim dhe arritje të marrëveshjeve ndërmjet komunës së Ferizajt me qytetin e Cedar Falls të shtetit të IOWA-s, si dhe komunës së Podujevës me qytetin e Ames të shtetit të IOWA-s.

Projektet dhe infrastruktura dhe mirëmbajtja

Gjatë kësaj periudhe kohore Qeveria, respektivisht Ministria e Mbrojtjes në kuadër të projekteve kapitale dhe infrastrukturës ka realizuar:

- *Furnizime – 46 projekte në proces në vlerë financiare prej 5,337,999.00€;*
- *Projekte të veçanta – 7 projekte në faza të prokurimit, 1 projekt ka kaluar fazën e hulumtimit të tregut;*
- *Shërbime – 17 projekte në proces në vlerë financiare prej 3,442,949.00€.*
- *7 projekte për infrastrukturë në proces në vlerë financiare 3,300,000€;*
- *11 kontratat që vazhdojnë nga viti 2019 dhe përfundojnë në vitin 2020 në vlerë 3,491,703.26€.*

Edukimi dhe trajnimi

Në kuadër të planeve të aktiviteteve, planeve bilaterale dhe memorandumëve të bashkëpunimit, gjatë kësaj periudhe janë realizuar këto aktivitete:

Ushtrimet Fushore - Janë realizuar 02 Ushtrime Fushore, në kuadër të njëjësive të FSK-së, kanë qenë të përfshirë 139 pjesëtarë.

Trajnimet dhe kurset jashtë vendit

- *SHBA 10 pjesëtarë;*
- *Gjermani 01 pjesëtarë;*
- *Britani e Madhe 02 pjesëtarë;*
- *Turqi 02 pjesëtarë;*
- *Shqipëri 08 pjesëtarë*

Shkollimet Jashtë Vendit

- SHBA 06 pjesëtarë
- Gjermani 07 pjesëtarë
- Turqi 14 pjesëtarë (vijnë nga vitet e kaluara);
- Kroaci 03 pjesëtarë (vijnë nga vitet e kaluara)
- Maqedoni e Veriut 04 pjesëtarë (vijnë nga vitet e kaluara)

Rekrutimi

- Gjatë kësaj periudhe janë hapur dy konkurse për rekrutimin e kadetëve për QSU/vendet partnere (SHBA, Turqi, Gjermani, Kroaci, Maqedoni), si dhe konkursi për rekrut të rinj në FSK.

Plani i Integritetit 2019-2022, i cili paraqet një ndër kornizat bazë të ngritjes së integritetit, është në zbatim të plotë nga strukturat e MM dhe FSK-së.

Forca e Sigurisë së Kosovës ka mbështetur institucionet e Republikës së Kosovës/ Mbështetje Ushtarake Autoriteteve Civile (MUAC) për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 me personel, transport dhe pajisje logjistike me mbi 20 aktivitete (vendosje e tendave në pika kufitare dhe QKMF, mbështetje spitalit në Vushtri me transport të bombolave të oksigjenit, si dhe me mbështetje me teknike mjekësore për institucionet shëndetësore).

Gjithashtu, FSK-ja ka kryer operacionet të MUAC në fushat e Kërkim-Shpëtimit, Mjekësi, Deminimin Humanitar, EOD, inspektim të materive të rrezikshme dhe projekte humanitare xheniere.

Operacionet Ndërkombëtare

FSK-ja në bashkëpunim me ODC- Ambasada e SHBA, është në proces të përgatitjes së ekipit për dërgim në operacion ushtarak ndërkombëtar në Lindje të Mesme, si pjesë e kontingjentit të Gardës Kombëtare të IOWA-s.

Është riaktivizuar Plani i Reagimit Kombëtar dhe është ndryshuar edhe përbërja e Grupit Ndërinstitucional për Menaxhimin e Incidenteve (GNMI).

10.2. Sektori i sigurisë publike

Është nënshkruar Marrëveshja e Punës me EUROPOL-in, që do të sigurojë bashkëpunim të drejtpërdrejtë mes Policisë së Kosovës dhe EUROPOL-it, qasje në sistemin e shkëmbimit të të dhënave të EUROPOL-it, si dhe do të mundësojë dërgimin e zyrtarëve ndërlidhës policorë në EUROPOL dhe vendosjen e zyrtarit të njëjtë nga EUROPOL-i në Kosovë;

Janë shkëmbyer letra edhe me Drejtorin e Qendrës Evropiane për Monitorimin e Drogave dhe Varësisë nga Droga (EMCDDA) për nënshkrimin e marrëveshjes së punës në mes të MPB-së, Ministrisë së Shëndetësisë dhe EMCDDA. Marrëveshja do të mundësojë shkëmbim të të dhënave

dhe bashkëpunim në hartimin dhe monitorimin më të mirë të politikave dhe legjislacionit në fushën e drogave.

Ministria ka marrë miratimin e Qeverisë për të filluar negociimin e një marrëveshjeje trepalëshe ndërkombëtare ndërmjet Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për “forcimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë së kufirit”;

Është finalizuar teksti i marrëveshjes dypalëshe ndërkombëtare me Shqipërinë për “bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera”, e cila pritet të nënshkruhet gjatë mbledhjes së përbashkët të dy qeverive në shtator;

Është nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi në mes të MPB-së dhe MI-së për pjesëmarrjen e zyrtarëve të MPB-së në cilësinë e vëzhguesve në provimet për patent-shofer. Me nënshkrimin e këtij memorandumi të dy ministratë janë pajtuar që të dhënat nga pjesëmarrja në teste të jenë konfidenciale, dhe si të tilla, do të përdoren vetëm për qëllime të Memorandumit;

Është nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë;

Gjithashtu, është miratuar Udhëzimi Administrativ për masat dhe procedurat e pranimit dhe përdorimit të të dhënave të Informacioni Paraprak për Udhëtar (IPU) dhe Regjistrin të Emrave të Udhëtarëve (REU), dhe konfigurimi i pajisjeve të sjella nga Ambasada e SHBA për IPU dhe REU. Në kuadër të avancimit dhe zbatimit të Politikave të Riintegritit të Personave të riatdhesuar, gjatë kësaj periudhe është përgatitur plotësim ndryshimi i rregullores për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, ndërsa nga zyra pritëse e riintegritit në Pikat e Kalimit Kufitar janë pritur në mënyrë të organizuar 90 persona të riatdhesuar. Janë mbështetur me skema të riintegritit 639 persona.

Në fushën e sigurisë së aviacionit civil, është përgatitur një Udhëzues për zbatimin e integruar të masave shtesë të sigurimit për rifillim të operimeve në aeroport pas pandemisë (COVID 19), është bërë inspektim në lidhje me implementimin e masave shtesë të sigurimit për ri-fillim të operimeve në aeroport pas pandemisë (COVID 19), si dhe janë ricertifikuar dy operatorë të skenimit në aeroport.

Me vendim të Qeverisë, Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm është bartur në përgjegjësi të MPB-së dhe deri në fund të vitit do të fuzionohet me Strategjinë kundër terrorizmit. Qeveria e ka emëruar ministrin e MPB-së Koordinator nacional dhe ai do ta mbikëqyrë hartimin dhe implementimin e këtij dokumenti të rëndësishëm strategjik;

Me qëllim të racionalizimit dhe koordinimit më të mirë të zbatimit të strategjive të Ministrisë, është marrë vendimi për zvogëlimin e numrit të strategjive dhe bashkimin e tyre nga 12 në 5 strategji. Është hartuar plani i punës së fuzionimit dhe grupet punuese që kanë filluar punën për hartimin dhe bashkimin e strategjive.

Në fushën e Parandalimit dhe riintegritit të personave të radikalizuar, është përmbyllur aktiviteti për shpërndarjen e pakove ushqimore higjienike për 239 familje, janë dorëzuar grantet për familjet e rikthyera nga Siria, si dhe janë mbajtur takime të Këshillave Komunale të

Sigurisë në Bashkësi në këto komuna: Suharekë, Prishtinë, Pejë, Kamenicë, Podujevë, Shtime, Rahovec, Hani Elezit, Dragash, Kaçanik, Gjilan.

Policia e Kosovës ka lëshuar në funksion aplikacionin mobil “Lajmëro Policinë”, në kuadër të projektit “Policia Dixhitale” që u ofron qytetarëve mundësi shtesë për ta lajmëruar policinë rreth shkeljeve dhe krimeve të mundshme, si dhe janë përfunduar investimet për avancimin e sistemeve të policisë, siç janë Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës dhe Sistemi i Menaxhimit të Kufijve.

Është marrë vendimi për ngritjen e nivelit të Stacionit policor në Podujevë nga kategoria B në kategorinë A.

Në zbatimin e UO për Gatishmëri dhe reagim kundër koronavirus COVID-19 janë angazhuar gjithsej 4500 zyrtarë policorë apo 54.87% e personelit të uniformuar të PK-së, të cilët kanë qenë të angazhuar në patrullimin parandalues 24/7 me tri ndërrime në orarin 12 orësh dhe mbajtjen e 18241 pika kontrolli.

Pas Vendimit të Qeverisë Nr. 01/10 të datës 05 korrik 2020 është ngritur bashkëpunimi ndërmjet inspektorëve sanitarë dhe inspektoratet tjera komunale me policinë. Akademia e Kosovës për Siguri Publike ka filluar trajnimin profesional për 416 kadetët e gjeneratës së 55-të të policisë.

Inspektorati Policor i Kosovës ka pranuar 375 ankesa ndaj punonjësve të policisë dhe ka hetuar 130 raste penale. Si rezultat i hetimeve penale gjatë kësaj periudhe janë ngritur 9 kallëzime penale, janë arrestuar 9 zyrtarë policorë dhe 3 qytetarë, si dhe janë suspenduar 13 punonjës të policisë.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë ka ofruar shërbime dhe ekspertizë forenzikë për 556 raste, ku janë kryer mbi 772 ekspertime me 1964 teste të provave materiale. Gjithashtu, janë pranuar disa pajisje nga Projekti i BE-së për mbështetje për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë dhe Policinë e Kosovës në forcimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit; Pajisjet kanë qenë të destinuara për Divizionin e Serologjisë dhe ADN-së dhe Divizionin për Analiza Kimike të Narkotikeve, duke ngritur kështu kapacitetin dhe cilësinë e punës së AKF-së;

Gjithashtu, Policia e Kosovës është furnizuar me: (a) pajisje teknike për fuqizimin e kapaciteteve për hetimin e terrorizmit, në vlerë prej 300,000.00 dollarë; (b) 5 qenë për identifikimin e armëve të paligjshme; (c) 10 mjete motorike të blinduara; (d) 3 donacione të 3 licencave softuerike të MALTEGO XL, RI, 3 licenca për Social Links, përfshirë trajnimin e zyrtarëve hetues për përdorimin e tij në fushën e zhvillimit të hetimeve policore.

Policia ka siguruar nga BE edhe një makinë të specializuar për përdorim në vend të ngjarjes, të projektit të BE-së për mbështetjen e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë dhe të Policinë së Kosovës, në forcimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit;

Pas Vendimit të Qeverisë Nr. 01/10, të datës 05 korrik 2020, është ngritur bashkëpunimi ndërmjet inspektorëve sanitarë dhe inspektorateve tjera komunale me policinë, e që për shkak të numrit të vogël të inspektorëve dhe pamundësisë së mbulimit të çdo pike, është kërkuar

mbështetja e policisë në plotësimin e formave të kundërvajtjes dhe dorëzimi i tyre inspektorit sanitar, që të vazhdojnë me shqiptimin e masave ndëshkuese, me ç' rast policia ka: (a) plotësuar 732,226 forma për personat fizik e juridik, për mos zbatimin e Vendimit të Qeverisë, (b) 3018 asistime inspektorëve; dhe (c) 275 asistime shërbimeve shëndetësore;

Policia e Kosovës ka qenë e angazhuar edhe në fusha të tjera të sigurisë, rendit dhe qetësisë publike, me ç' rast ka evidentuar gjithsej 7,878 raste, prej të cilave 4,059 janë klasifikuar si vepra penale, ndërsa 3,819 raste janë klasifikuar si kundërvajtje dhe raste të natyrave të tjera. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019, numri i rasteve në përgjithësi ka shënuar rënie për 11.47%, derisa numri i veprave penale ka shënuar po ashtu rënie 6.59%;

Rëniet më të dalluara janë vërejtur në numrin e: (a) lëndimeve të rënda trupore 4.16%; (b) vjedhjeve 2.32%; (c) vjedhjeve të rënda 9.62%; dhe (d) grabitjeve 4%. Fatkeqësisht, brenda kësaj periudhe numri i vrasjeve, ka shënuar ngritje nga 2 në 6, ose ngritje 200%, dhe po ashtu numri i rasteve të dhunës në familje me ngritje, nga 352 në 367, ose ngritje 4.26%; Në operacione të ndryshme, policia ka: arrestuar 2049 persona, ndaluar 730 persona për shkak të dyshimeve në përfshirje në akte kriminale; konfiskuar 214 armë zjarri të llojeve të ndryshme, 11,102 sasi të municionit të kalibrave të ndryshme dhe 40kg e 681.51gr substanca të ndryshme narkotike; Brenda kësaj periudhe vërehet një rënie e numrit të: (a) aksidenteve në trafikun rrugor 32.31%; (b) aksidenteve me fatalitet 42.30%; (c) aksidenteve me lëndime, rënie 23.77%; dhe; (e) personave të cilët kanë humbur jetën në trafik rrugor 50%; Gjatë ofrimit të sigurisë së kufijve të Republikës së Kosovës, si rezultat i shkeljeve të ndryshme ligjore, pjesëtarët e Policisë së Kosovës kanë hapur 143 raste të veprave penale, 19 kundërvajtje, kanë shqiptuar 122 gjopa për kundërvajtje në fushën e migrimit dhe të huajve, ka arrestuar 361 persona dhe ka ndaluar 29 persona. Gjithashtu, Policia e Kosovës ka bërë 43 inspektime në fushën e migrimit të të huajve, 470 refuzime të hyrjes, 116 refuzime të daljes. Policia e Kosovës gjatë kësaj periudhe ka realizuar 14 operacione dhe 23 patrullime të përbashkëta me shtetet fqinje (Shqipëri, Maqedoni dhe Mali i Zi). Me datë 15 gusht 2020 policia ka filluar zbatimin e planit operativ 'Mbikëqyrja e vijës kufitare 2020', me ç' rast është rrit numri i zyrtarëve policorë të përfshirë në ofrimin e sigurisë së kufijve. Sa i përket fushës së sigurisë së trafikut rrugor Policia ka shqiptuar 97,707 tiketa me qëllim të ngritjes së sigurisë në trafikun rrugor.

Agjencia e Regjistrimit Civil ka krijuar sistemin elektronik për menaxhimin e termineve online te Vulat Apostile dhe ka zhvilluar sistemin e ri për aplikim, personalizim dhe lëshim te Patente Shoferëve Ndërkombëtar. Po ashtu, gjatë kohës së pandemisë, është marr vendim për lehtësimin e procedurës për pajisje me pasaporta dhe patentë-shofer edhe në mungesë të posedimit të letërnjoftimit, si dhe pajisen me patentë-shofer vetëm me pasaportë valide të Republikës së Kosovës;

Agjencia për Menaxhim të Emergjencave ka bërë furnizimin dhe shpërndarjen e uniformave për mbrojtje nga zjarri për njësitë profesionale të zjarrfikësve dhe shpëtimit;

Agjencia e Shoqërisë së Informacionit ka funksionalizuar Platformën e Ndërveprimit dhe janë vendosur me sukses certifikatat e reja të sigurisë Secure Sockets Layer (SSL) në nivel serveri, për të gjitha ueb-faqet dhe ueb-aplikacionet e institucioneve të Kosovës;

Instituti i Kosovës për administratë publike ka filluar trajnimet online, ku janë trajnuar 276 nëpunës civilë dhe publikë nëpërmjet 4 kurseve/programeve të trajnimit të mbajtura në 118 ditë trajnimi. Trajnimet janë mbajtur në fushat tematike si çështjet e prokurimit publik (15 module), MSA, çështjet e ligjit për ndihmën shtetërore.

Gjatë kësaj periudhe janë përmbyllur katër aktivitete trajnimi për trajnerë, në të cilat janë certifikuar 33 trajnerë të rinj, të cilët kanë fituar titullin trajnerë i IKAP.

11. Mbrojtja sociale dhe integrimi në punësim

Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Pakos Emergjente Fiskale, ndër të tjera ka përkrahur edhe përfituesit e të gjitha skemave sociale dhe pensionale.

Pagesa e asistencës mujore në vlerë prej njëqind e tridhjetë (130 €) euro është realizuar për rreth 27,000 mijë familje, tek qytetarët me kushte të rënda sociale, të lajmëruar si të papunë në institucionin kompetent, që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga buxheti i Kosovës.

Në zbatim të pakos emergjente janë kryer pagesat si në vijim:

- *Pagesa për muajin maj për 27,572 familje me 81,653 anëtarë, në shumë 4,251,390.00 euro,*
- *Pagesa për muajin qershor 26,734 familje me 78,661 anëtarë në shumë 3,577,080.00 euro.*

Është realizuar shuma prej 30 euro shtesë për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuar në bazë të pakos emergjente, të cilat kanë përfituar në total 130 euro.

Sa i përket agjendës legislative, gjatë kësaj periudhe janë përgatitur pesë projektligje:

- *Projektligji për Inspektoratin e Punës,*
- *Projektligji i Punës,*
- *Projektligji për Këshillin Ekonomik-Social,*
- *Projektligji për pushimin e lehonisë dhe prindëror,*
- *Projektligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti,*

Nga këto projektligje, janë miratuar nga Qeveria, Projektligji për Inspektoratin e Punës dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko Social, ndërsa Projektligji i Punës, Projektligji për pushimin e lehonisë dhe prindëror dhe Projektligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti janë dërguar për shqyrtimi dhe miratim në Qeveri. Gjithashtu, qeveria ka miratuar edhe Koncept dokumentin për reformë të Skemës së Ndhmës Sociale.

Në kuadër të zbatimit të ligjit për ndërmarrjet sociale janë miratuar aktet përkatëse nënligjore për procedurat e regjistrimit të ndërmarrjeve sociale, procedurat e raportimit për arritjen e objektivave sociale dhe raportet financiare; procedurat e marrjes, refuzimit dhe humbjes së statusit të ndërmarrjes sociale dhe strukturat përgjegjëse të monitorimit, kontrollit dhe procedurat për gjoba dhe ankesa të ndërmarrjeve sociale.

Nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, janë hartuar projekt rregulloret si në vijim:

- *Projekt-rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punë;*

- *Projekt-Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr.05/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës;*
- *Projekt-rregullore për certifikimin dhe licencimin e personave që kryejnë aktivitete nga siguria dhe shëndeti në punë;*
- *Projekt-rregullore për vlerësimin e riskut.*

Po ashtu, është finalizuar edhe Projekt rregullorja për funksionimin, përbërjen, organizimin, punën dhe procedurat e procesit për kategorizimin e veteranëve luftëtar të UÇK-së.

- *Është finalizuar drafti final i Koncept Dokumentit për përmirësimin dhe avancimin e legjislacionit nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punës, i cili do të përcillet në Qeveri për miratim.*
- *Gjatë kësaj periudhe është rikonstituar Këshilli Ekonomiko- Social, me anëtarët e rinj të Qeverisë dhe janë funksionalizuar komisionet profesionale të KES-it. Janë zhvilluar dy takime të KES-it dhe janë mandatuar dy komisionet profesionale për hartimin e Draft Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës dhe rekomandimi për përcaktimin e Pagës Minimale për vitin 2021.*

Janë hartuar edhe dy projekt rregullore si në vijim:

- *Projekt rregullore për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës,*
- *Projekt rregullore për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës,*

Në fushën e pensioneve janë realizuar të gjitha pensionet dhe beneficionet, gjithashtu janë zbatuar masat në bazë të vendimeve kundër Covid 19.

Gjatë kësaj periudhe Inspektorati i Punës ka realizuar inspektime në bazë të planit të punës, ndërsa mbi 1000 inspektime në bazë të ankesave palëve dhe gjatë kësaj kohe kanë qenë të angazhuar në inspektime të përbashkëta me inspektoratin sanitar për implementimin e masave kundër Covid 19.

Në Agjencinë e Punësimit janë ndërmjetësuar 153 persona në punësim të rregullt. Gjithashtu, janë trajnuar në Qendrat e Aftësimin Profesional 140 persona, ndërsa janë certifikuar 230 kandidatë. Trajnimet janë zhvilluar edhe për trajnerë të disa profileve, si metalpunues. Në fund, janë zhvilluar disa kurrikula dhe paketa mësimore për profilet, si: kuzhinier; banakier dhe produktet e tjera ushqimore.

Aktualisht, kanë filluar përgatitjet për implementimin e masës së tretë të rimëkëmbjes ekonomike, për subvencionim në pagë për personat e papunësuar dhe masat e tjera në bazë të planit të rimëkëmbjes ekonomike.

12. Kultura, rinia dhe sporti

12.1 Kultura

Përkundër vështirësive të paraqitura me COVID-19, institucionet e kulturës kanë zhvilluar një pjesë të aktiviteteve të tyre. Kështu, Baleti Kombëtar i Kosovës ka transmetuar online katër shfaqje, Filharmonia e Kosovës ka realizuar 3 projekte për nevojat e transmetimit në platformë digjitale dhe Teatri Kombëtar ka dhënë premierën e 1 shfaqje, në formë të mbyllur. Për më shumë, Gjatë kësaj kohe janë transmetuar online shfaqjet e repertorit të vitit 2018 dhe 2019. Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë ka mbajtur Konferencën IV Mbarëkombëtare të Arkivistikës.

Në fushën e investimeve kapitale ka përfunduar faza e parë e ndërtimit të Shtëpisë së Kulturës “Ukë Bytyci” në Suharekë. Ka përfunduar funksionalizimi i kinemasë së qytetit në Komunën e Kamenicës. Njëkohësisht, kanë vazhduar punimet në Shtëpinë e Kulturës “Hasan Prishtina” në Vushtri, Shtëpinë e Kulturës “Imri Curri” në Han të Elezit, Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, Arkivin dhe Bibliotekën në Shtime dhe Qendrën e Kulturës në Rogovë të Hasit.

Punët kanë vazhduar edhe në plotësimin e kornizës ligjore, përkatësisht në ndryshimin e Ligjit të Kinematografisë, Ligjit për Teatrot, Ligjit për Filharmoninë, Operën dhe Baletin. Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës ka hartuar projektligjin për Arkivat Shtetërore.

Hartimi dhe miratimi i dokumentit strategjikë për kulturë, si dhe i koncept dokumentit për veprimtarinë botuese dhe librin janë në fazën përfundimtare. Me 2 tetor do të nënshkruhen tri marrëveshje kulturore me Shqipërinë, e këto janë: Kalendari i Përbashkët kulturor, Marrëveshja për bashkëprodhim të filmit, si dhe Memorandumi i Bashkëpunimit për Veprimtarinë Botuese dhe Librin. Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta ka hartuar draftin përfundimtar të Koncept Dokumentit për fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta i cili është dërguar për konsultime publike, si dhe është hartuar drafti i Projekt Rregullores për Ndryshimin e Rregullores për Licencimin e Shoqatave Kolektive. Vazhdon zbatimi i fushatës së vetëdijesimit, ku në vijimësi shpërndahen materiale dhe informate të rëndësishme për publikun.

Ka përfunduar procesi i thirrjes publike për përkrahjen e projekteve kulturore dhe artistike, ku në total janë përkrahur 489 projekte kulturore dhe artistike, në vlerë prej 1,531,580 eurosh, prej të cilave 317 projekte janë të OJQ-ve dhe 172 projekte të individëve. Projektet janë në fazën e procedimit për pagesë. Gjithashtu, ka përfunduar procesi i vlerësimit dhe përkrahjes së revistave letrare, sipas thirrjes publike për përkrahjen e revistave letrare. Janë përkrahur 13 revista letrare, në shumën totale 45,000 euro.

Janë pranuar 376 kërkesa për dokumente arkivore; janë rregulluar dhe përpunuar 28,25 m. gjatësi lineare e lëndës arkivore; janë klasifikuar 6,30 m. gjatësi lineare e lëndës arkivore; janë konservuar 236 fletë A4, prej tyre janë restauruar 104 fletë A4; është bërë lidhja e 4 librave me lidhje të butë; janë digjitalizuar 7564 dokumente, të fondit - Gjykata e Qarkut Prizren (me të gjitha procedurat); është bërë digjitalizimi i fondit Drejtoria e Urbanizmit - Gjakovë, vitet 1995-1996, në sasi prej 600 dokumente; janë mirëmbajtur dhe kontrolluar 200 mikrokuadra

të mikrofilmave- Sig IV/1-1; është bërë katalogimi dhe digjitalizimi i 328 titujve bibliotekarë. Janë pranuar numrat e gazetës ditore “Rilindja”, vitet 1999-2008, në sasi prej 16.4 m. gj. Lineare, si dhe janë realizuar 24 inspektime te fondkrijuesit.

12.2. Trashëgimia

Në kuadër të trashëgimisë kulturore, në fushën e konservimit-restaurimit deri më tani ka përfunduar zbatimin i projekteve në 7 ndërtesa brenda Qendrës Historike të Prizrenit, e këto janë: shtëpitë e familjeve Dukagjini, Muriqi, Hereni, Koci, Kolshi, Skenderi dhe Doda. Janë përmbyllur punimet në Kullën e Reshat Istrefaj në Strelc, si dhe kanë përfunduar punimet në rekonstruimin e Kullës së Nuhi Berishës në Sfirçë. Vijnë punimet në rekonstruimin e kullave si në vijim: të Rexhep Malës në Hogosht, të Basri Canollit në Marec, të Sahit Avdyllit në Dujakë, të Haxhë Mustafë Lajqit në Rugovë, si dhe të Shaban Manxhollit në Mikushnicë. Janë nënshkruar kontratat për fillimin e punimeve në Kompleksin Etnologjik Emin Gjiku në Prishtinë, Muzeun Arkeologjik në Prizren, Kullën e Ibish Osdautaj në Isniq, Kullën e Fazli Buqollit në Raushiq dhe Kullën e Florim Gecit në Pozhar.

Janë realizuar aktivitete me qëllim të përnjohtës dhe parandalimit të dëmtimeve në trashëgiminë kulturore arkeologjike, si dhe në gjetjet e rastit, të cilat janë paraqitur nga palët e treta. Në këtë mënyrë, janë paraqitur dëmtimet në Kalanë e Lipës, vendosja e ujësjellësit në afërsi të Parkut arkeologjik Ulpiana dhe gjetjet në lokalitetin e njohur si “Tjerrtorja”, në Fushë Kosovë. Si pasojë e gjendjes aktuale, planet e punës janë në rishikim nga mekanizmat institucionalë. Aktualisht në procedurë të zbatimit janë 20 projekte të konservim-restaurimit, ndërsa 11 janë në procedurë përfundimtare të publikimit për kontratë në platformë.

Në zbatim të planit të punës respektivisht të plotësimit dhe avancimit të kornizës ligjore në fushën e trashëgimisë kulturore në procedurë të hartimit janë: Projektligji për Trashëgimi Kulturore, Koncept dokumenti për Ekspertizën e të Mirave Kulturore, Koncept dokumenti për kthimin e Objekteve Kulturore të Marra Jashtëligjshëm dhe Rregullores Nr.06/2017 për Mandatet e Institucioneve Vartëse të Trashëgimisë Kulturore derisa pritet të miratohen udhëzimet administrative për: Licencimin e Personave Fizik dhe Juridik në fushën e Trashëgimisë, si dhe për Ruajtjen e Trashëgimisë së Luajtshme.

Në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, Dega e Arkeologjisë, është finalizuar marrëveshja për studime. Aktualisht janë 3 studime nga Instituti Arkeologjik i Kosovës, 2 nga Muzeu Kombëtar i Kosovës dhe 1 nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren. Është nënshkruar Memorandumi me Rektoratin e UP-së për mbështetje të studentëve në fushën e arkeologjisë, antropologjisë dhe etnologjisë përmes bursave të financuara nga MKRS. Gjithashtu është nënshkruar Memorandumi i bashkëpunimit me Institutin Albanologjik të Kosovës me qëllim zbatimin e përbashkët të projekteve të trashëgimisë kulturore me interes kombëtar.

Ka filluar zbatimi i politikës së re të ministrit për pasurimin e Listës së Trashëgimisë Kulturore në mbrojtje të përkohshme, me fokus në ruajtjen dhe promovimin e trashëgiminë shpirtërore. Në kuadër të kësaj nisme është marrë vendimi për shpalljen e Lojërave tradicionale, Opusi i Ansambllit Folklorik të Rugovës, si dhe Flakës së Janarit në Gjilan asete të trashëgimisë shpirtërore. Komisioni i brendshëm i MKRS-së është në proces të shqyrtimit të tetë propozim dosjeve të ardhura nga Qendrat Rajonale të Trashëgimisë Kulturore dhe Instituti Albanologjik për dukuritë shpirtërore të cilat duhet të futen në mbrojtje.

Me qëllim të promovimit të Trashëgimisë Kulturore janë realizuar aktivitetet si në vijim: Shënimi i Ditës Botërore të Monumenteve dhe Lokaliteteve, Dita ndërkombëtare e Muzeve. Viojnë aktivitetet e planifikuara për periudhën 15 shtator – 15 tetor, që shënojnë Ditët e Trashëgimisë Evropiane ku deri sot janë mbajtur aktivitetet si në vijim: ekspozita me veshje tradicionale në Parkun Arkeologjik Ulpiana, kampi për të rinjtë në lokalitetin arkeologjik të Dresnikut i organizuar në bashkëpunim të Ministrisë, Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Institutit Arkeologjik të Kosovës dhe organizatës European Heritage Volunteers, aktiviteti në Rugovë për publikimin e vendimit për shpallje të aseteve të trashëgimisë shpirtërore, si dhe promovimi dhe dokumentimi i përgatitjes së ushqimeve tradicionale të mbajtur për dy ditë në Kalanë e Vushtrrisë.

Në zbatim të dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore është realizuar edhe thirrja publike për projekte, në kuadër të cilës janë mbështetur 42 organizata dhe 15 individ nga të gjitha komunitetet, përfshirë dhe personat me aftësi të veçanta.

12.3. Rinia

Me qëllim të profilizimit dhe hyrjes së të rinjve në tregun e punës, MKRS ka në zbatim skemën e trajnimeve për ndërmarrësi, përmes të cilës janë trajnuar rreth 500 të rinj. Gjithashtu përmes projektit për rritjen e punësimit nëpërmjet ofrimit të trajnimeve profesionale, që synon uljen e jo aktivitetit të të rinjve nëpërmjet rritjes së punësimit dhe zhvillimit të kapaciteteve profesionale në përpunje me nevojat e tregut të punës janë angazhuar 755 të rinj.

Në kuadër të bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë, në zbatim të marrëveshjes në fushën e rinisë, është realizuar kampi rinor për të rinjtë me temë: “Mjete digjitale dhe ato TIK, përgjatë pandemisë COVID-19”, kanë marrë pjesë 20 të rinj nga dy vendet, trajnimi ka zgjatur 3 ditë. Ka vazhduar puna për hartimin e Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë.

Zyra Rajonale për Bashkëpunim të të Rinjve (RYCO) me seli në Tiranë ka vazhduar të jetë prioriteti më i lartë i MKRS-së në mbështetje të proceseve të ndryshme. Kontributit financiar i Kosovës për RYCO është 102,000 €.

Në kuadër të thirrjeve publike për projekt janë mbështetur 218 projekte të OJQ-ve në shumën prej 821,000 € për fushat si në vijim: Mobilizimi i rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive, Edukim Joformal, Edukim dhe Promovim Shëndetësor, Kulturë, Sport dhe Rekreacion, dhe Trajnime për ndërmarrësi për të rinj dhe trajnimeve profesionale që janë të nevojshme për tregun e punës.

12.4. Sporti

Në fushën e sportit, janë zbatuar zotimet e marra përmes memorandumeve të nënshkruara me federatat sportive dhe organizatat e sportit, për në mbulimin e shpenzimeve sipas kategorizimit të sportit.

Zbatimi i planit të aktiviteteve për organizatat sportive ka qenë i kufizuar për shkak të pandemisë COVID -19, megjithatë janë zhvilluar aktivitete sportive të cilat kanë qenë në procesin e pjesëmarrjes në kualifikime të garave ndërkombëtare, siç ishte



Reprezentacioni i Kosovës në Futboll, meshkujt dhe Femrat, tre ekipet e futbollit nga Kosova në Ligën e kampionëve dhe në Europa Ligë, etj.

Gjatë kësaj tremujori, është vazhduar me investime në infrastrukturën sportive në tërë vendin me projektet e filluara kohë më parë. Ka përfunduar në tërësi dhe është lëshuar në përdorim palestra e sporteve në Samadrexhë, Vushtrri, në përfundim e sipër janë palestra e sportit në Deçan dhe palestra e sportit në Istog që priten të përurohen shumë shpejt, ndërsa në vazhdimin e dinamikës së punëve janë palestrat e sporteve në, Skenderaj, Viti, Dragash; Zhegër, Gjilan, Shtime, Loxhë, Pejë, Lipjan. Gjithashtu, janë duke u zhvilluar punimet në renovimin e stadiumit “Adem Jashari” – Mitrovicë, si dhe Stadiumit të qytetit në Prishtinë. Tutje, janë ndërtuar poligonet rekreative, sportive shkollore në Shaptej të komunës së Deçanit, në Kralan të komunës së Gjakovës. Në proces të ndërtimit janë edhe Stadiumi i qytetit në Gjilan si dhe në Suharekë.

Në aspektin legjislativ, është realizuar vendimi për hartimin e rregullores për kategorizimin e sportistëve dhe sporteve, si dhe vendimi për hartimin e Planit Strategjik sektorial për Sportin 2021-2025.

Është mbajtur Java evropiane e Sportit nga data 23 deri me datën 30 shtator 2020, ku është diskutuar për avancimin e sportit si Ligji për Sponsorizimin, kategorizimi i sportit, sportistëve dhe trajnerëve, qeverisja e mirë në sport, barazia gjinore, sfidat dhe prioritetet e sportit etj.

Po ashtu është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Republikën e Shqipërisë për mbështetjen e Ligës së Përbashkët të Basketbollit ‘LIGA UNIKE’ e themeluar rishtas mes Federatave të Basketbollit të Kosovës dhe Shqipërisë.

